

1 E martë, 11 shkurt 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Për procesverbal të katër të akuzuarit janë të pranishëm
13 në sallën e gjyqit.

14 Do të kontrollojmë informacionin që ka të bëjë me provën
15 materiale që ka marrë numër MFI 1D00246. A kemi ndonjë
16 informacion?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Është marrë nga një burim i hapur,
18 të nderuar Gjykatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë nuk e
20 dimë se nga ka ardhur, nga e ka origjinën ky dokument.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk e kam URL ekzakte tani
22 aktualisht në dorë, por është marrë nga interneti.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 Sa i takon dokumentit 1D00246, Trupi Gjykses konstaton se
25 për shkak të mungesës së informacionit dhe origjinës së këtij

1 informacioni, dhe përderisa dëshmitari nuk ishte në gjendje që
2 të komentonte përmbajtjen e këtij dokumenti, nuk përmbushet
3 kërkesa *prima facie* dhe mbështetëshmëria e dokumentit.

4 Dhe, si rezultat, Trupi Gjykses nuk e pranon dokumentin
5 1D00246 pa paragjykim, pra, nuk e pranon në prova gjyqësore.

6 Kjo përfundon urdhrin e parë me gojë të Trupit Gjykses.

7 Dje, dëshmia e Dëshmitarit 4290 sa i takon këtij
8 dëshmitari, Trupi Gjykses përcaktoi një tjetër dokument me
9 numër provizor prove P02034.

10 Pasi shqyrtoi parashtrimet e palëve, Trupi Gjykses
11 konsideron se P02034 nuk i përmbush kërkesat *prima facie* sipas
12 rregullës 138 dhe Dëshmitari 04290 nuk e di se kush e ka
13 shkruar këtë dokument dhe nuk ishte në gjendje dje që të
14 komentonte takimin që përmendet në këtë dokument.

15 Si rezultat, Trupi Gjykses nuk e pranon provën me numër
16 MFI P02034.

17 Dhe këtu përfundon dhe urdhri i dytë i Trupit Gjykses.

18 Do të vazhdojmë tani me dëshminë e Dëshmitarit të
19 Prokurorisë 04290.

20 Znj. Sekretare, sillni dëshmitarin në sallë.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
23 procesverbal, z. Qerkini, Avokati Kujdestar është i pranishëm
24 së bashku me dëshmitarin.

25 Mirëmëngjes, Dëshmitar.

1 DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të
3 vazhdojmë me dëshminë tuaj.

4 Ju kujtoj që t'i përgjigjeni pyetjeve qartë, me fjali të
5 shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje të caktuar, lirisht
6 mund t'i kërkonit avokatit përkatës që t'ju reformulojë
7 pyetjen ose t'i thoni që nuk e kuptoni pyetjen dhe avokati
8 përkatës do bëjë sqarimet e nevojshme. Po ashtu, mundohuni që
9 të thoni se cila është baza e njohurive, fakteve dhe
10 rrethanave lidhur me pyetjet që do t'ju bëhen.

11 Ju kujtoj që jeni ende nën detyrim të tregoni të vërtetën
12 sikurse e deklaruat dje në betimin solemn. Gjithashtu, ju
13 kujtoj se garancitë e dhëna nga Trupi Gjykses dje,
14 përkatësisht se çdo përgjigje që i jepni pyetjeve përkatëse
15 nuk do të përdoren as në mënyrë të drejtpërdrejtë as në mënyrë
16 të tërthortë kundër jush në ndonjë proces tjetër përpara
17 Dhomave të Specializuara në përjashtim të asaj çka parashikohet
18 në nenin 15(2) i Ligjit, rregulla 65 e Rregullores -
19 gjithashtu, dua t'ju kujtoj që refuzimi për t'ju përgjigjur
20 një pyetjeje mund të sanksionohet me një gjobë.

21 Flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej pesë
22 sekondash përpara sesa të jepni përgjigje një pyetjeje të
23 caktuar dhe flisni ngadalë në mënyrë të tillë që t'ju kapin
24 përkthyesit.

25 Gjithashtu, në qoftë se e shikoni të nevojshme që ju

1 nevojitet një pushim, na e thoni këtë gjë dhe ne do bëjmë
2 organizimet përkatëse.

3 Do fillojmë me pyetjet e Prokurorisë.

4 Z. Prokuror, e keni ju fjalën.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

6 DËSHMITARI: SYLEJMAN SELIMI [Vijon]

7 Pyetje nga z. Halling: [Vazhdim]

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

10 PË. Mirëmëngjesi.

11 PY. Dëshiroj të vazhdoj me temën e policisë ushtarake të
12 cilën e diskutuam dhe dje. Dje ju thatë që Sahit Jashari ishte
13 i vendosur në Likovc dhe njësia e policisë ushtarake ishte
14 atje.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Për procesverbal, këtë e keni
16 thënë në transkriptin në kohë reale në faqen 82.

17 PY. A ju kujtohet ta keni thënë këtë dje, Dëshmitar?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. A janë kryer marrje në pyetje të personave të arrestuar
20 në Likoc?

21 PË. Nuk ka pas persona të arrestuar sipas mendimit tim, sipas
22 meje. Ka pas ndoshta ndonjë marrje në pyetje ose diçka të
23 tillë, po të arrestuar nuk di që ka pas.

24 PY. Kur thoni që nuk ka pas persona të arrestuar, sipas
25 mendimit tuaj, a kanë qenë personat e arrestuar -- a janë

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 5

1 marrë në pyetje personat e arrestuar, apo jo?

2 PË. Unë, nuk më kujtohet një gjë e tillë që ka pas.

3 PY. Në rregull. Tani thoni që nuk ju kujtohet. Çfarë po
4 thoni, po thoni që persona të tillë nuk janë marrë në pyetje
5 apo po thoni që nuk ju kujtohet?

6 PË. Mesa di unë nuk kam pas ndonjë informacion që është ndalu
7 ose është arrestu dikush. Po ka pas që janë marrë në pyetje,
8 ka pas edhe prej ushtarëve edhe ndoshta informacione, por të
9 arrestuar nuk e di që ka pasur.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në qoftë se
11 na lejoni, dëshirojmë që të paraqesim një dëshmi që pranuar
12 tanimë në prova gjyqësore të dhënë nga dëshmitari për TPNJ-në.
13 Më konkretisht dëshirojmë që të transmetohet një pjesë e
14 videos që përkon me pyetjen tonë.

15 Në përputhje me vendimin tuaj të mëparshëm për
16 Dëshmitarin 04401 do luteshim që të kalonim në seancë private
17 në mënyrë të tillë që të kishim mundësi që të transmetohet
18 videoja.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
20 Sekretare, na kaloni në seancë private, ju lutem.

21 [Seancë private]

22 [Seancë private teksti i fshirë]

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 6

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 7

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19 [Seancë e hapur]

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
21 jemi në seancë publike.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem paraqisni në ekran tani
23 dokumentin 09815 deri në 098626 në versionin në shqip dhe në
24 anglisht. Do të fillojmë në faqen 098618, megjithëse ka disa
25 faqe në këtë dokument prej 12 faqesh, do ju kërkoja që së pari

1 të paraqisni këtë faqe, pra, 098618.

2 PY. Dëshmitar, këtë fletë e keni parë gjatë seancës
3 përgatitore. A është shkrimi i dorës i juaji ky?

4 PË. Po, mendoj se është i saktë.

5 PY. Në transkriptin në anglisht lexohet si e pashquar ose e
6 padallueshme, e palexueshme, por a mund të na thoni se çfarë
7 është shkruar në rreshtin e dytë të dokumentit që është kështu
8 si në thonjëza?

9 PË. A me lexu krejt tekstin?

10 PY. Nuk e di në qoftë se kjo është e nevojshme për momentin,
11 po aty ku thotë:

12 "Më konkretisht komandant Sylejman Selimi ..."

13 Pastaj në të djathtë të emrit tuaj, kjo që jepet si në
14 kllapa çfarë është, Dëshmitar?

15 PË. Dhe është -- kjo vlen edhe për Dajën, domethënë. A e ki
16 fjalën për Dajën apo ma poshtë?

17 PY. Ngjitur me Sylejman Selimin.

18 PË. Ngjitur me Sylejman? Zëvendëskomandanti Sami Lushtaku.

19 PY. Po. Tani ajo çka po të pyes është kjo, shikoni rreshtin e
20 dytë. Pra, besoj që e shikoni këtë numrin që është me të kuqe
21 që është 098618, ka diçka që është në kllapa që është poshtë
22 atij numri dhe që është ngjitur me emrin tuaj. Çfarë është
23 shkruar aty?

24 PË. Është "101" këtu, shifra ime.

25 PY. Në rregull. Tani vazhdojmë me përmbajtjen e kësaj flete.

1 Pra, këtu përmendeni ju dhe pastaj zëvendëskomandanti Sami
2 Lushtaku dhe thuhet që:

3 "Duhet t'i furnizoni këta persona me armatim sa më
4 modern. Ne jemi shumë keq për ta. Mundësisht mjetet të
5 kalibrit të lartë. Kjo vlen edhe për Dajën."

6 Pastaj lexon:

7 "Komandanti Sylejman Selimi.

8 "Zëvendëskomandanti Sami Lushtaku".

9 Kujt ia kërkonit ju armatimet në këtë dokument, kujt i
10 drejtohej kjo letër?

11 PË. Ne e kemi dërguar disa pjesëtarë prej Zonës Operative të
12 Drenicës në Shqipëri dhe atje iu kemi drejtu Haki, domethënë,
13 Hakiut dhe njëkohësisht që kjo vlen edhe për Dajën, Daja ka
14 qenë Azem Sylja, që me u interesu me i furnizu me armatim
15 grupin të cilin e kemi dërgu atje edhe e kam cek këtu çfarë
16 armatimi na duhet.

17 PY. Ku ishte Hakiu në atë kohë, në qoftë se ju kujtohet?

18 PË. Nuk e di ku ka qenë, është diku në Kukës ose në Tropojë.
19 Nuk e di se nuk kam qenë atje. Por e di që janë furnizu,
20 domethënë, kryesisht në Shqipëri. Po dhe bazën po më duket e
21 ka pas ose ka qëndru në Tropojë. Nuk jam i saktë ku.

22 PY. Ju përmendët Azem Sylën në një prej përgjigjeve të
23 mëhershme. Domethënë, Azem Sylja është Daja në këtë kërkesë?

24 PË. Po, me pseudonim Daja.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë tek një fletë përpara

1 kësaj që është 098617.

2 PY. Dëshmitar, këtë dokument e keni parë gjithashtu gjatë
3 seancës përgatitore me Prokurorinë, mund të shikoni në fillim
4 të kësaj faqeje, thotë 20 maj 1998, më pas thuhet:

5 "Më 16 prill 1998 në orën 17.50, Lulzim Habib Koliqi del
6 nga shtëpia e Rexhep Kurtit me përcjelljen e dy personave.
7 Njëri u ndal tek dera e oborrit, ndërsa tjetri e përcjell 500,
8 600 metra. Ne nga pozicioni ynë vrapuam për të verifikuar se
9 kush ishte. Pas verifikimit doli që ky ishte Lulzim Habit
10 Kuliqi."

11 Deklaron Florim Mustafa, Selim Mustafa dhe Isuf Mustafa.

12 A i njihni ndonjërin prej këtyre emrave nga kjo pjesë që
13 sapo ju lexova?

14 PË. Jo, nuk i njoh.

15 PY. Kush është Rexhep Kurti, në qoftë se e njihni?

16 PË. Rexhep Kurti ka qenë një person i fshatit Obri dhe është
17 vra nga forcat serbe.

18 PY. Ju keni folur për Abrin në deklaratën që keni dhënë dhe
19 që është pranuar si provë gjyqësore tani. A mund të na thoni,
20 Dëshmitar, në qoftë se Abri, Abria janë i njëjti vend dhe a
21 janë vende vrojtimi këtu? Ça janë?

22 PË. Jo, nuk janë vende vrojtimi, janë dy lagje, domethënë, dy
23 fshatra me të njëjtin emër Abri, Abri e Ulët dhe Abri e
24 Epërme.

25 PY. Rexhep Kurti a ka qenë mbështetës i Slobodan

1 Milosheviqit?

2 PË. Ka qenë publikisht me Slobodan Milosheviqin.

3 PY. A ka qenë informacion i ditur ky përpara fillimit të
4 luftës?

5 PË. Nuk e di. Por me fillimin e luftës është ka dit edhe nuk
6 e ka nuk është merr kërrkush me të edhe pse ka qenë.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Tani kërktoj që të kalojmë tek
8 faqja 098620.

9 PY. Dëshmitar, faqet e tjera në këtë grup dokumentesh i keni
10 parë në seancën përgatitore vetëm thjesht sa për t'i
11 identifikuar shkrimin e dorës, megjithatë do t'i shikojmë pak
12 në më tepër hollësi tani.

13 Për shembull, në këtë faqe ju shikoni një listë pyetjes,
14 për shembull:

15 "Kur ke dëgjuar për herë të parë UÇK-në?

16 "Kush ka qenë në UÇK?

17 "Çfarë mendoni për shqiptarët?

18 "Çfarë mendoni lidhur me politikat serbe?

19 "Çfarë mendoni lidhur me S. Milosevic?

20 "Çfarë mendoni lidhur me masakrat e policisë serbe?", e
21 të tjerë.

22 A mund të na shpjegoni se cila është arsyeja që pyetje të
23 kësaj natyre janë gjetur në këtë grup dokumentesh? Domethënë,
24 pse bëheshin pyetje lidhur me Milosheviqin apo të natyrës së
25 ngjashme në zonën tuaj?

1 PË. E para, nuk e di i kujt është ky shkrim dhe as nuk e di
2 me çfarë konteksti janë bërë këto pyetje.

3 PY. Në rregull.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Tani të kalojmë në faqen 098625,
5 që është një provë gjyqësore e pranuar tanimë, që është prova
6 P1644.

7 PY. E shikoni këtë emrin Zarko Spasic dhe a e shikoni që
8 thuhet që është profesor, po, është Zarko Milograd Spasic.

9 "Profesor", shkruhet diku.

10 E shikoni, e njihni këtë person, Dëshmitar?

11 PË. Jo, për herë të parë po e shoh dhe e kam ndëgju për të,
12 po ndëgjoj për të.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja 098623.

14 PY. Këtu shkruhet Miroslav Sulenic nga Peja, a e njihni këtë
15 person, e dini kush është ky person?

16 PË. Jo, nuk e njoh.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër që është
18 098624.

19 PY. Dejan Stojikovic. Po këtë person a e njihni?

20 PË. Jo, nuk e njoh.

21 PY. Në rregull. Le të kalojmë tek faqja 098625 që është pjesë
22 e provës P220, këtu gjenden disa persona për të cilët ju
23 diskutuat dhe më herët, i keni përmendur më herët.

24 Atëherë shumë shkurtimisht dua t'ju the diçka lidhur me
25 përmbajtjen e faqes sa për t'ju orientuar. Në fillim të faqes

1 lexon 18 maj 1998, "Raport Ditor", pastaj shkruhet:
2 "Jahir Demaku".
3 "Muharrem Demaku ka shku te Rexh Kurti.
4 "Feriz Demaku ju ka marrë revolja.
5 "Ismet Demaçi ka kontakt me Rexh Kurtin."
6 Dhe pastaj vazhdohet më tej që:
7 "Pëllumbi në pikën e kontrollit ka sjellë një serb:
8 Vladimir Spasic, më 14 shkurt 1936 ditëlindja, e tjerë. Vendi
9 i banimit Beograd, Novi Beograd ..."
10 Pyetja që kam për juve është kjo: A e keni parë më
11 përpara këtë dokument, Dëshmitar?
12 PË. Jo, nuk e kam pa.
13 PY. A e njihni Muharrem Demakun dhe Ismet Demicin
14 [Përkthyesja: siç e thotë Prokurori], këta dy persona a janë
15 të lidhur sipas jush me Rexhep Kurtin? A i njihni këta
16 persona?
17 PË. Nuk e di. Nuk e di a janë të lidhun. Ky shkrim as nuk
18 është i imi, as nuk drejtohet për mu, as nuk shkrun që është
19 Jahir Demaku, por nuk e di për këtë rast.
20 PY. A jeni në dijeni që Vladimir Spasic është marrë në
21 punktun Pëllumbi dhe i është dërguar Sahit Jasharit?
22 PË. Jo, për herë të parë po e ndëgjoj.
23 PY. Nga përvoja juaj si komandant tone, çfarë masash janë
24 marrë nga komandanti i policisë ushtarake kur serbët janë
25 transferuar nga njësitet e Drenicës?

1 PË. Nuk e di që ka pas një rast të tillë dhe nuk po më
2 kujtohet që ka pas një rast të tillë.

3 PY. Pyetja ime ishte paksa e ndryshme. Nuk kishte të bënte në
4 qoftë se ju kujtohet ndonjë rast apo jo. Por pyetja ime është
5 kjo: Strukturalisht, nga pikëpamja organizative, çfarë ndodhte
6 në qoftë se hipotetakisht mund të kishte ndonjë rast të një
7 transferimi të tillë?

8 PË. Edhe unë po të tregoj se hipotetakisht nuk kam dëgju që
9 ka pas një rast të tillë. Nuk e di çka do të ndodhte, por nuk
10 kam ndonjë rast të tillë që për t'i evidensum ose që kam pas
11 njohuri.

12 PY. Një situatë e tillë nuk parashikohej ose nuk ishte e
13 sanksionuar, nuk ishte e rregulluar nga zona e Drenicës?

14 PË. Sa bre nuk e di që ka pas një sanksionim ose një rast të
15 tillë ose raste të ngjashme.

16 PY. Dëshmitar, ju po përgjigjeni për rastet që kanë ndodhur.
17 Unë po ju them a ka pasur zona e Drenicës ndonjë bazë për t'i
18 trajtuar raste të tilla, si i trajtonit ju raste të tilla?

19 PË. Unë po them që në kët, në kësi raste nuk e di që ka
20 ndodhur.

21 PY. Dua t'ju tregoj pjesë të një materiali filmik.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe për këtë i lutem Sekretarisë
23 të nxjerrë në ekran videon që mban numrin 1499 bashkë me
24 titrat, ju lutem, versioni me titrat është me numër
25 05477401_2.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 16

1 PY. Do t'ju jap kontekstin, Dëshmitar. Informacioni në këtë
2 incizim tregon që kjo video tregon Zarko Spasic, Dejan
3 Stojilkovic, Miroslav nga Peja në këtë video, janë këta
4 personat që shfaqen në këtë video. Do shohim 90 sekonda të
5 videos dhe do t'ju bëj disa pyetje, megjithatë këta persona
6 shfaqen në segmente të ndryshme të videos, kështu që do t'i
7 shohim sipas radhës.

8 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarisë që në vend që
9 ta në nxjerri përkthimin në anglisht të videos të vendosë
10 faqen ku bëhen pyetjet në anglisht në një anë të ekranit,
11 bëhet fjalë për materialin me numër 098620. Pra, të vendoset
12 fillimisht kjo video edhe ndërkohë përbri të vendoset videoja
13 dhe të shikojmë nga sekonda e 00:00:44 deri në sekondën e
14 00:00:48 fillimisht.

15 PY. Dëshmitar, do ta merrni videon përmes përkthimit. Do
16 shohim 90 sekondat që duhet të shohim dhe pastaj do t'ju bëj
17 pyetjet. Ju lutem ndiqeni me vëmendje.

18 [Luhet videoincizimi]

19 "Kur ke ndëgjuar për herë të parë për UÇK-në?"

20 Z. HALLING: [Përkthim] Tani duhet të shikojmë sekondën e
21 00:00:55 deri në sekondën e 00:00:58, ju lutem.

22 [Luhet videoincizimi]

23 "Kush është UÇK-ja për ty?"

24 Z. HALLING: [Përkthim] 00:01:28-00:01:32 tani.

25 [Luhet videoincizimi]

1 "Çka mendon për popullin shqiptar?"

2 Z. HALLING: [Përkthim] 00:02:10 deri në 00:02:15.

3 [Luhet videoincizimi]

4 "Çka mendon për politikën serbe?"

5 Z. HALLING: [Përkthim] 00:02:39 deri në 00:02:41.

6 [Luhet videoincizimi]

7 "Çka mendon për Slobodan Milosevic?"

8 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe tani do shohim pak më gjatë,

9 00:03: 55 deri në 00:04:59.

10 [Luhet videoincizimi]

11 [Zëri 1] "Çka mendon për masakrat e policisë serbe të
12 ushtruara mbi popullin shqiptar?"

13 [Zëri 2] [Nuk ka përkthim]

14 Z. HALLING: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, kjo video ka të njëjtat pyetje që shfaqen në
16 materialet që lidhen drejtpërdrejt me zonën tuaj dhe policinë
17 ushtarake. Ky burrë pretendon se ka qenë i burgosur aty. Dhe
18 ju keni qenë komandant i zonës aty. Ende vazhdoni të thoni që
19 ju nuk keni pasur njohuri që të kenë ndodhur gjëra të kësaj
20 natyre?

21 PË. Përderisa pash unë deri që tash ky burrë nuk kallëzon që
22 është as në Drenicë dhe tregon për -- mirëpo prapë edhe me
23 qenë në Drenicë, unë për këtë rast hera e parë po ndëgjoj.

24 Edhe këto pyetje nuk e di kush i ka shkru në atë fletë që
25 ju ka ba ato pyetje që thashë më herët.

1 PY. Ai tha:

2 "Nga momenti që më ndaloi UÇK-ja ...", thotë personi.

3 PË. Po, e saktë, po.

4 PY. Është pjesë e një video me persona që ju dhanë Sahit
5 Jasharit, komandantit të policisë ushtarake që ju thatë ishte
6 i stacionuar në Likoc dhe ju nuk keni ide që ka ndodhur kjo?

7 PË. Nuk muj të jem i sigurtë që ka ndodh kjo, që ka ndodh ose
8 që u shku i ka marrë Sahit Jashari. Aty po shkrun, po duhet me
9 dit në cilin vend është incizum ky person, nga kush është
10 marrë në pyetje. Ne e pamë vetëm një shkrim.

11 PY. Dëshmitar, ju a jeni dënuar nga EULEX-i për lëndën
12 Drenica II për ndalimin e personave në Likoc?

13 Z. DIXON: [Përkthim] E kundërshtoj këtë pistë pyetjesh.
14 Se tani po më duket sikur ka dalë një avokat mbrojtës këtu. Ky
15 është Prokurori, Prokuroria po i bën pyetjet e një dëshmitari.
16 Edhe ky është dëshmitar për vërtetësinë e përmbajtjes?

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë po
18 kundërshtoni?

19 Z. DIXON: [Përkthim] Kundërshtoj mënyrën se si po bëhen
20 pyetjet.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
22 Ju lutem, vazhdoni.

23 Z. HALLING: [Përkthim]

24 PY. Dëshmitar, ta përsëris edhe një herë pyetjen?

25 PË. Po, e saktë.

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling (Vazhdim)

Faqe 19

1 PY. Dënimi u apelua dhe shkoi më pas në Gjykatën Supreme?

2 PË. E saktë.

3 PY. Dënimi për kryerjen e krimeve të luftës të personave të
4 ndaluar në Likoc a ka tani formë të prerë, a ka marrë formë të
5 prerë?

6 PË. Po, po formën e prerë.

7 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne nuk kemi
9 më pyetje për dëshmitarin. Sidoqoftë do të kërkonim që të
10 pranoheshin faqet e mbetura që nuk janë pranuar nga materiali
11 që mban numrin 098615, 098626. Tri faqe janë pranuar, tri nga
12 12 faqe janë pranuar dhe kanë marrë numrin P220 dhe P1644. Ne
13 kemi diskutuar disa nga faqet e tjera me këtë dëshmitar ku
14 përfshihet një faqe që e ka shkruar ai dhe personat që ai ka
15 dalluar në këto faqe.

16 Sidoqoftë, nuk e di sesi mund t'i lidhim këto faqe me
17 provat e tjera që janë pranuar tashmë me numër 1499, sidoqoftë
18 kërkesa jonë ë që të pranohen faqet e mbetura.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

20 Z. DIXON: [Përkthim] Po. E kundërshtojmë. Ky është një
21 grumbull dokumentesh që ka ardh nga Beogradi. Nuk e dimë çfarë
22 është kronologjia. Janë pranuar disa nga dokumentet,
23 megjithatë dëshmitari nuk lidhet drejtpërdrejt me dokumentet
24 që nuk janë pranuar.

25 Prokuroria duhet të ndjekë procedurën e saktë, të gjejë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 20

1 personin që i ka sjellë dokumentet, të gjejmë prejardhjen e
2 dokumentit. Po ky nuk është dëshmitari që mund të shfrytëzohet
3 për pranimin e këtyre dokumenteve, nuk është mënyra e saktë
4 kjo.

5 Jua thashë edhe më herët, Prokuroria këtu po vepron sikur
6 është avokat mbrojtës, le të sjelli dëshmitarin përkatës për
7 këto materiale.

8 Ky është kundërshtimi im. Faleminderit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i
10 shënojmë aktualisht me një numër provizor dhe do vendosim më
11 vonë.

12 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Gjykatës
13 këshillohen]

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti në tërësinë e
15 vet do të marri numër provizor dhe numri provizor është 2037.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
17 Misetiç, gati për kundërpjetjet tuaja?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, faleminderit.

19 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç:

20 Z. MISETIC: [Përkthim]

21 PY. Mirëmëngjes, z. Selimi. Unë quhem Luca Misetiç dhe jam
22 avokati mbrojtës i z. Hashim Thaçi. Unë do të kem pyetje mbase
23 gjatë gjithë ditës së sotme për ju.

24 Do filloj fillimisht me përfshirjen tuaj të parë në
25 grupin e Prekazit. Fillimisht, a mund të na tregoni çfarë

1 ishte ky grupi i Prekazit?

2 PË. Grupi i Prekazit ka qenë me në krye me një grup i
3 njerëzve të cilët kanë qenë më meritator dhe janë që sot ne jemi
4 të lirë. Ky grup, është në krye të këtij grupi është
5 komandanti legjendar Adem Jashari, Hamëz Jashari dhe disa
6 shokë të këtij grupi të cilët kanë qenë në këtë kohë.

7 PY. Për procesverbal, ju thatë Adem Jashari, e dëgjua mirë?

8 PË. Po.

9 PY. Përveç jush, përveç teje - më falni - dhe Adem Jasharit,
10 a mund të na thoni kush kanë qenë anëtarët e tjerë të grupit
11 të Prekazit?

12 PË. Të grupit të Prekazit, mesa unë i kam njoft në këtë
13 periudhë, ka qenë Sami Lushtaku, Sait Jashari, Fadil Kodra,
14 Nuredin Lushtaku, Zenun Kodra.

15 PY. A është e vërtetë --

16 PË. Dhe Musë Jashari. Më falni.

17 PY. Po, në rregull. A është e vërtetë që grupi i Prekazit më
18 vonë u shndërrua dhe u njoh si zona e Drenicës në UÇK?

19 PË. Po, është e vërtetë.

20 PY. Në këtë moment kohor, para luftës, në 1997, ju e dinit që
21 ekzistonte një Shtab i Përgjithshëm në Prishtinë por nuk
22 kishit asnjë informacion të mëtutjeshëm se kush ishte
23 komandanti as si vepronte ky shtab, saktë?

24 PË. Unë gjithmonë kam dëgju për Shtabin e Përgjithshëm, për
25 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, po as nuk i kam njoft dhe

1 nuk i di ku kanë pas selinë që ka ose ku kanë vepru.

2 PY. Ju u kyçët në UÇK më 30 janar 1997, e saktë?

3 PË. Jo, i kyçun jam kanë shumë më herët. Më 30 janar është --

4 kanë tentu me më arrestu dhe kam dalë publik. Tani i kyçun

5 prej rastit që është rrethu familja Jashari edhe që lufta që

6 është bë. Është plagu axha im Vesel Selimi. Dhe ne e kemi

7 vazhdu kontaktet dhe çdo herë unë i kam pas kontaktet me Adem

8 Jasharin dhe me grupin e tij.

9 PY. Po lexoj nga deklarata jua që është pranuar në fakt dhe

10 ka marrë numrin P02026, faqja 12 në anglisht dhe faqja 14 në

11 shqip. Thuhet:

12 "... por kyçja konkrete e UÇK-së nga ana ime ka ndodhur

13 më 30 janar 1997."

14 Nuk është e saktë kjo?

15 PË. Jo, është e saktë. Më 30 janar ka ndodhë, jam dalë

16 publikisht.

17 PY. Ju jeni kyçur në UÇK vullnetarisht?

18 PË. Vullnetarisht.

19 PY. A është e vërtetë që fillimisht keni qenë pjesë e

20 njësitit lokal të UÇK-së në fshatra me bashkëfshatarët që u

21 mbledhën me njëri-tjetrin dhe vetorganizuan, saktë?

22 PË. Po, e saktë.

23 PY. A është e vërtetë që gjatë kësaj periudhe kohore, pra,

24 nga 1997 deri në mars të 1998-s ju keni pasur vetëm një

25 autoritet mbi veten tuaj dhe ky person ka qenë komandant Adem

1 Jashari?

2 PË. Është e saktë.

3 PY. Edhe një herë, ju nuk dinit asgjë përtej Adem Jasharit,
4 saktë? Nuk njihnit askënd me thënë, pra, nuk njihnit askënd
5 përveç Adem Jasharit, nuk njihnit asnjë person më të lartë në
6 hierarki sesa Adem Jashari, saktë?

7 PË. Unë kam njof shumë njerëz, por Adem Jashari ka qenë
8 gjithmonë prijësi dhe komandanti kryesor i Ushtrisë Çlirimtare
9 të Kosovës, për sa i përket meje.

10 PY. Ju nuk keni ndonjë njohuri të drejtpërdrejtë të
11 kontakteve që mund të kenë pasur Adem Jashari me ndonjë person
12 në Shtabin e Përgjithshëm, saktë?

13 PË. Jo, nuk kam njohuri.

14 PY. Ju personalisht nuk keni pasur ndonjë kontakt me persona
15 që ju mendonit se ishin anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm
16 asokohe, e saktë?

17 PË. Ka mundësi që jam taku me shumë persona, me disa persona
18 ose shumë persona por nuk e kam dit asnjëherë çfarë pozicioni
19 kanë edhe nuk i kam pyet. Ma vonë i kam dit që kanë qenë
20 pjesëtarë ose anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm. Por deri në
21 1998 nuk i kam dit kërrkën me çfarë pozicionesh a çka detyrash
22 kanë.

23 PY. Në deklaratën tuaj me numër P02026, faqja 17, ju thoni:

24 "... nuk ka pasur ndonjë strukturë të mirëfilltë të UÇK-
25 së në këtë kohë nuk ka pasur zona të mirëfillta, nuk ka pasur

1 grupe besoj ..."

2 A është ky një përshkrim i saktë i UÇK-së në fillimet e
3 vitit 1998?

4 PË. Po, është i saktë.

5 PY. Në deklaratën tuaj keni thënë që në fillim të 1998, ju
6 kishit 10 deri në 15 ushtarë dhe keni qenë përgjegjës për një
7 fshat në territorin e Drenicës, a është kjo e saktë?

8 PË. E saktë.

9 PY. Fshati për të cilin keni qenë ju përgjegjës ka qenë
10 fshati i lindjes suaj, Aqarevë, kështu?

11 PË. Po, e saktë.

12 PY. Dhe ju caktuar që ta drejtonit këtë fshat me 10 dhe 15
13 ushtarë nga vetë Adem Jashari, saktë?

14 PË. Është e saktë.

15 PY. Keni deklaruar në deklaratën tuaj me numër P02026, faqja
16 22, 23, se në atë kohë nuk kishte nivele komanduese. Flasim në
17 pranverën e 1998-s, nuk ka pasur nivele komanduese mes
18 ushtarëve në terren dhe Shtabit të Përgjithshëm, saktë?

19 PË. Po, është e saktë. Domethënë, në fillimet e 1998-s është
20 e saktë.

21 PY. Mund të themi që në atë kohë struktura ishin kryesisht,
22 pra, struktura e UÇK-së në atë kohë ishte thjesht disa njerëz
23 bashkëfshatarë që mblidheshin bashkë dhe përpiqeshin që të
24 krijonin një strukturë, saktë?

25 PË. E saktë.

1 PY. Pra, ky grup personash, mes të cilëve dhe ju, i bënit
2 vetë propozimet se kush do të jetë përgjegjës për çfarë detyre
3 dhe kush do të jetë komandanti i zonës, saktë?

4 PË. Në këtë aspekt duhet një përgjigje më e gjanë. Ne e kemi
5 -- nivelit tim ka pas edhe disa në zonën e Drenicës disa grupe
6 ose disa shokë të tjerë të cilët kanë pas edhe ata ushtarë të
7 vet edhe pi gjithë këtyne grupeve ose pi këtyne individëve ne
8 kemi -- është ardh deri tek një propozim për komandant
9 Drenicën. Në atë kohë janë qujt pika ose dhe me shifra të
10 ndryshme, si Sandokan ose Shkoza unë kur kam qenë ose kështu
11 me radhë. Po është e saktë kjo.

12 PY. Po. Të shohim deklaratën tuaj lidhur me këtë temë,
13 deklarata që ka numrin P1745.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë që ta vendosë
15 në ekran deklaratën. Anglishtja është 6D00076, në faqen 14.
16 Ndërsa shqipja SPOE00360459 deri në 00360498 në faqen
17 SPOE00360477, që është faqja 19 në PDF.

18 PY. Është intervista që keni dhënë për gazetën Zëri në vitin
19 2000.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Është paragrafi që thotë: "Pas
21 luftës ...". Në shqip duhet të jetë më poshtë "Pas një pune të
22 gjatë ..."

23 PY. Ju keni thënë kështu, kështu e keni thënë ju se jeni bërë
24 komandant i Drenicës. Ju thoni:

25 "Pasi u bë shumë punë për një periudhë të gjatë kohore,

1 të gjithë personat përgjegjës për pikat apo komandantët e
2 njësisë u mblodhën bashkë në Plluzhinë në verën e 1998-s për
3 të zgjedhur komandantin e Zonës Operative të Drenicës. Rexhep
4 Selimi, përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Bekim
5 Berisha, Sami Lushtaku, Fadil Kodra, Ilaz Kodra, Zenë Prokshi,
6 Rasim Kicina, Jahir Demaku, Gani Thaçi, Xhavit Nuraku e tjerë,
7 ishin të pranishëm.”

8 Ndalojmë këtu fillimisht. Është e saktë, është përshkruar
9 saktë a kanë qenë këta personat e pranishëm kur jeni zgjedhur
10 ju komandant i zonës së Drenicës?

11 PË. Besoj që po.

12 PY. Vazhdojmë:

13 “Disa komandantë mungonin, por kishin të drejtë që të
14 propozoheshin dhe natyrisht edhe të zgjidheshin. Propozimet u
15 bënë publikisht. Rexhep Selimi tha që shtabi i UÇK-së ...”

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem kalojmë tek shqipja në
17 faqen tjetër.

18 PY. “Rexhep Selimi tha që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së do
19 të miratonte kush do të zgjidhej komandant nga ky takim.”

20 Mesa kuptoj unë nga ato që keni thënë ju është që
21 personat nga pikat ishin ata që do të bënin zgjedhjen tuaj apo
22 të kujt do që do të ishte komandant i zonës dhe se z. Selimi ka
23 thënë që Shtabi i Përgjithshëm thjesht do ta aprovojë cilindo
24 që doni ju të zgjidhni, saktë?

25 PË. Po, po, është e saktë.

1 PY. Më pas vijon:

2 "Unë kam propozuar që komandant të zgjidhet Fehmi
3 Lladrovci. Propozimin tim e mbështeti dhe Sami Lushtaku dhe
4 Ilaz Kodra. Ndërkohë Zenë Prokshi më ka propozuar mua dhe të
5 gjithë të pranishmit e aprovuan propozimin e tij. Të drejtë
6 zgjedhjeje kishte dhe personi që kishte merita, por në atë
7 moment mungonte. Shokët më zgjodhën mua për të aprovuar më pas
8 nga Shtabi i Përgjithshëm dhe për t'u emëruar edhe
9 formalisht."

10 Pra, ju keni thënë që shokët ishin ata që ju zgjodhën ju
11 si komandant zone i Drenicës dhe se më pas emërimi nga Shtabi
12 i Përgjithshëm ka qenë thjesht një formalitet, saktë?

13 PË. Po, është e saktë.

14 PY. Në rregull. Tani dua t'ju tregoj përmbledhjen që i ka
15 bërë Prokuroria dëshmisë suaj lidhur me këtë aspekt.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë qëllim do i lutesha të
17 shfaqej në ekran materiali që mban numrin F02833/A01, Shtojca
18 1, ju lutem ta vendosim këtë në ekran. Jo nuk është për të --
19 vetëm që nuk është publike, nuk është publik.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Çfarë relevance ka ky dokument për
21 dëshmitarin?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Thjesht do ta pyes çfarë mendimi
23 ka ai me për mendimin e Prokurorisë apo pozicionin e
24 Prokurorisë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet

1 kundërshtimi i Prokurorisë.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Faqja 3. Shkojmë më poshtë.

3 Paragrafi 4.

4 PY. Thotë kështu:

5 "Jeni ju ky dëshmitar, do të flisni për zgjedhjen tuaj si
6 komandant i Zonës Operative të Drenicës ku mori pjesë dhe
7 Rexhep Selimi dhe miratoi këtë zgjedhje tuajën në cilësinë e
8 tij si përfaqësues i Shtabit të Përgjithshëm."

9 A kanë të drejtë ata kur thonë që ju u zgjodhët si
10 komandant zone, siç keni thënë në intervistën për Zërin nga
11 shokët tuaj, nga ata u zgjodhët, apo jo?

12 PË. Po, fakt. Unë jam zgjedhur nga ata edhe propozimi ka shku
13 për Shtabin e Përgjithshëm. Këtë e kam sqaru disa herë.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

15 PY. Dëshmitar, a është e drejtë të themi që edhe nga vera
16 1998 - më falni - nga pranvera e 1998-s ju nuk i keni njohur
17 të gjithë anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm?

18 PË. Po, është e vërtetë.

19 PY. Një nga personat që njihnit ama në atë kohë ishte Hashim
20 Thaçi, apo jo, në pranverën e 1998?

21 PË. Po, e saktë.

22 PY. Por sipas asaj që i keni thënë Prokurorisë javën e kaluar
23 - është paragrafi 80 i Shënimit Përgatitor 2 - ju nuk e keni
24 ditur se çfarë roli ka pasur ai pranë Shtabit të Përgjithshëm,
25 saktë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 29

1 PË. Është e saktë. Në fillim të 1998-s nuk e kam ditë çfarë
2 roli ka pas.

3 PY. Po. Dhe më pas në një deklaratë tjetër - që ka numrin
4 P02026, në faqen 30 - ju keni thënë se nuk e keni ditur me
5 siguri çfarë roli ka pasur në Shtabin e Përgjithshëm por se
6 mendonit se në atë kohë ka qenë përfaqësues politik pranë
7 Shtabit të Përgjithshëm, saktë?

8 PË. Po, besoj se po.

9 PY. Në rregull.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, po shoh
11 orën. Besoj që është momenti më i përshtatshëm për pushimin.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse gjykoni
13 që është momenti i përshtatshëm, atëherë bëjmë pushimin.

14 Dëshmitar, do bëjmë dhjetë minuta pushim.

15 DËSHMITARI: Okej.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 Z. HALLING: [Përkthim] Shkurtimisht përpara pushimit.

18 Kemi marrë materialet nga tri Ekipet e Mbrojtjes por s'kemi
19 marrë materialet e Mbrojtjes së Veselit.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Po e përgatisim tani, për pak
21 sekonda do ta merrni.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
23 Bëjmë dhjetë minuta pushim.

24 --- Seanca ndërpritet në orën 10.00

25 --- Seanca rifillon në orën 10.10

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

2 Sekretare ju lutem, sillni dëshmitarin në sallë.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës thjesht dua t'ju
4 informoj që po eci goxha më shpejt se sa e kisha planifikuar,
5 kështu që koha ime do të jetë shumë më e shkurtër se ç'kisha
6 planifikuar.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
8 që na e bëtë me dije këtë gjë.

9 [Dëshmitari vijon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Selimi do
11 të vazhdojmë më tej me pyetjet e avokatit të z. Thaçi.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

13 PY. Z. Selimi, kam disa pyetje të tjera. Në intervistën me
14 Zërin, ju keni diskutuar se z. Thaçi ka qenë i pranishëm në
15 zonën e Drenicës në fund të shtatorit të vitit 1998. Dua t'ju
16 bëj disa pyetje, a mund të na shpjegoni se cilat kanë qenë
17 rrethanat në atë kohë në zonën e Drenicës?

18 Atëherë ka qenë periudha e ofensivës serbe, apo jo,
19 Dëshmitar?

20 PË. Po, e saktë.

21 PY. Sipas jush, me fjalët tuaja, a mund të na shpjegoni
22 situatën në të cilën ishin njerëzit e Drenicës, pra në çfarë
23 shtate gjendesh populli i Drenicës në atë periudhë, pra në
24 shtator të 1998, si rezultat i ofensivës serbe?

25 PË. Po, në shtator të 1998-s ka qenë ofensiva ma e fuqishme

1 dhe ma e madhe e forcave serbe në tërë territorin e Drenicës.
2 Në veçanti fokusi ka qenë rreth fshatrave, rreth Likovcit, dhe
3 rreth fshatrave përreth. Populli ose qytetarët, fshatarët,
4 kanë qenë nëpër male. Ne, unë bashkë me ushtarët, jemi mundu
5 që këto forca t'i ndalim, dhe ka qenë e pamundshme. Kanë qenë
6 aq shumë forca, aq shumë mjete të blindume, aq shumë ushtarë,
7 aq shumë, dhe kjo ka qenë situata.

8 Ne, unë rastësisht jam taku me diku në mbramje, sa më
9 kujtohet mu, me Hashim Thaçin edhe me Rexhep Selimin.
10 PY. Po, ju thatë që u takuat rastësisht. Kjo është e ngjashme
11 me atë çfarë keni thënë edhe në intervistën me Zërin, në
12 provën P1745, në faqen 22. Më konkretisht ju thoni që:

13 "Në një ditë ku kemi qenë të rrethuar dhe ishim në
14 presion të lartë nga të gjitha drejtimet, nga ofensiva serbe,
15 Hashim Thaçi, Rexhep Selimi, Jahir Demaku, Hysen Thaçi, dhe
16 persona të tjerë rastisën që të ishin në atë zonë".

17 A është e saktë kjo, Dëshmitar --

18 PË. E saktë.

19 PY. -- në Abrinë e Epërme. Pra, në intervistën e Zërit ju
20 thoni që këta persona rastisën që të ishin në Abrinë e Epërme.
21 Ndërkohë që tani ju thoni që i takuat rastësisht, domethënë,
22 rastisën që ishin aty dhe i takuat rastësisht. A mund të na e
23 shpjegoni pak si rastisën ata që të ishin aty, si i takuat
24 rastësisht?

25 PË. Luftimet duke u zgjeru ne rreth Abrisë, domethënë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 32

1 Likovciç, atëherë kanë fillu të hyjnë forcat serbe edhe me
2 Abrinë e ulët, në disa shtëpi. Njëkohësisht edhe duke, kanë
3 tentu me hy edhe në Abrinë e Epërme, edhe forca të tjera kanë,
4 nga Kieva edhe nga Drenasi, kanë hy në, kanë fillu me hy në
5 Baicë edhe me fshatra të tjera rreth Kievës. Kështu që, por
6 rastësisht jemi taku në Abri. Bashkë me këta persona më duket
7 ka qenë edhe Tahir Desku, edhe disa të tjerë, përpos këtyne,
8 sa më kujtohet.

9 PY. Po. Rajoni i Drenicës është rajoni i z. Thaçi, apo jo?
10 Është vendi nga ku vjen z. Thaçi, apo jo, Dëshmitar?

11 PË. Po, është e saktë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të
13 pyesim lidhur me datën se kur ka ndodhur ky takim?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

15 PY. Dëshmitar, mund të na thoni se kur ka ndodhur kjo pak a
16 shumë, sa i takon kohës? Megjithatë, përpara se t'ju bëj këtë
17 pyetje, dua që t'ju pyes lidhur me diçka tjetër. Ju thoni në
18 intervistën e Zërit, që:

19 "... ata ndodhën që të ishin në Abri e Epërme. Unë
20 ditëlindjen e kam më datë 25 shtator dhe Tahir Desku ndodhi që
21 të kishte një shishe pije dhe ne -- një shishe raki -- dhe
22 neve pimë një gotë për sa i përket ditëlindjes time."

23 Pra, a ju kujtohet kjo data 25 shtator, a është
24 ditëlindja juaj më datë 25 shtator dhe a ju kujtohet në qoftë
25 se ju e keni takuar atë në këtë periudhë?

1 PË. Po.

2 PY. Pra, juve thatë dhe më përpara që zona ose regjioni i
3 Drenicës është regjioni i vetë z. Thaçi, kështu që ka pasur
4 arsye që ai të ketë qenë aty, për shkak të kontakteve
5 personale. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

6 PË. Edhe është e saktë. Ai është i zonës së Drenicës dhe
7 lëvizjet edhe të familjes apo të, shoqëria i ka pas, me siguri
8 ka pas në këtë kohë me Drenicën.

9 PY. A është e saktë që z. Thaçi nuk ka qenë aty për të
10 inspektuar trupat, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

11 PË. Po, është e saktë.

12 PY. Do t'ju bëj disa pyetje të tjera lidhur me zonën e
13 Drenicës. A ka pasur një brigadë në zonën e Drenicës që njihej
14 si Brigada Hasan Prishtina?

15 PË. Jo, në Drenicë nuk ka pas.

16 PY. Po FARK-u a ka qenë i pranishëm në zonën e Drenicës?

17 PË. Jo.

18 PY. A jeni në dijeni të ndonjë problemi që mund të ketë pasur
19 LDK-ja në zonën e Drenicës me UÇK-në ose ndonjë problem që
20 mund të ketë pasur UÇK-ja me LDK-në në zonën e Drenicës?

21 PË. Nuk më kujtohet.

22 PY. Tani do të kaloj tek një temë tjetër. z. Selimi -- jo
23 përpara se t'ju bëj pyetjen do kërkoj që të paraqitet
24 intervista që i keni dhënë Zërit, në ekran.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretares të paraqesë

1 provën P1745 në faqen 25, në të dyja versionet, në shqip dhe
2 në anglisht. Në shqip është 6D00-0792. Atëherë, është
3 paragrafi në fund në versionin në anglisht.

4 Më thonë kolegët që në versionin në shqip faqja është 33,
5 pra te dokumenti që keni në ekran në PDF duhet të paraqisni
6 faqen 33. Tek kolona e tretë në mes. Ju lutem, vazhdoni pak më
7 poshtë. Po, pak edhe më sipër në faqe. Këtu.

8 PY. Nuk e di në qoftë se e lexoni dot apo jo, z. Selimi?

9 Është paragrafi ku fillon që, që fillon me: "Komuniteti
10 ndërkombëtar filloi që të organizonte ..."

11 Pra, domethënë ju flisni tek kjo pjesa për konferencën e
12 Rambujesë. Dhe ju thoni si më poshtë:

13 "Komuniteti ndërkombëtar vendosi që të organizonte një
14 konferencë ndërkombëtare për Kosovën. Ata kërkuan një zgjidhje
15 politike për Kosovën dhe ne supozohej që të merrnim pjesë në
16 atë konferencë. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së u konsultua me
17 komandantët e zonës të cilët ishin vërtet shumë të
18 rëndësishëm, si sa i takon strukturës së përgjithshme të UÇK-
19 së, edhe veprimtarive konkrete në terren. Në fund lufta,
20 operacionet, lufta vetë, sulmet, mbrojtjet dhe veprimtaritë
21 janë kryer në terren, ku zonat operative, në veçanti
22 komandantët e tyre, kanë pasur një rol kryesor dhe dominues.
23 Unë, si komandant i zonës operative të Drenicës, ashtu si
24 gjithë të tjerët, kemi mbështetur pjesëmarrjen e delegacionit
25 të UÇK-së në konferencë, por, me një qëndrim të qartë. Në këtë

1 mënyrë Hashim Thaçi si shef i Drejtorisë Politike të UÇK-së
2 kishte mbështetjen tonë të plotë.”

3 A pasqyron kjo saktë situatën sa i takon marrëdhënies
4 midis komandantëve të zonave dhe pikëpamjeve të tyre lidhur me
5 negociatat në Rambuje?

6 PË. Mendoj që po, ka pas mossqarime rreth takimit të parë të
7 Rambujesë, domethënë [E padëgjueshme]. Mirëpo, kryesisht e
8 pasqyron realitetin.

9 PY. Po. Dhe, realiteti i UÇK-së në atë kohë, ashtu siç thoni
10 ju te kjo pjesë e intervistës, ishte që komandantët e zonave
11 ishin ata që ishin në vijën e frontit, ata që bënë luftën,
12 dhe me sa mendonit ju, ata ishin persona që duhet të merrnin
13 vendimin përfundimtar lidhur me atë që UÇK-ja do thoshte ose
14 me çfarë do binte dakord ose me çfarë nuk do binte dakord UÇK-
15 ja në Rambuje. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Po, e saktë.

17 PY. Qëndrimi i komandantëve të zonave, ose ky qëndrim që ju e
18 keni theksuar edhe në intervistën me Zërin, por edhe sot, i
19 është komunikuar apo i është përcjellë delegacionit që ka
20 shkuar në emër të UÇK-së në Rambuje, a është e saktë kjo,
21 Dëshmitar?

22 PË. Nuk e di a e ka përcjell, por në zgjedhjen time si
23 komandant i përgjithshëm kanë qenë edhe anëtarë të Shtabit të
24 Përgjithshëm, dhe komandantët e zonave.

25 PY. Tek ky fragment që ju lexova, ju thoni që:

1 "Si komandant i Zonës Operative të Drenicës, siç edhe të
2 tjerët, mbështetëm pjesëmarrjen e delegacionit të UÇK-së në
3 konferencë, por thamë një qëndrim të qartë."

4 Pra, ju thoni që ju si komandant i Zonës Operative të
5 Drenicë dhe komandantët e tjerë i keni dhënë qëndrimin tuaj të
6 vendosur dhe të qartë, delegacionit të UÇK-së. A mund të na
7 thoni cili ka qenë ky qëndrimi juaj i qartë dhe i vendosur?
8 PË. S'më kujtohet në përgjithësi çka. Dhe mendoj se e kuartë
9 ka qenë që pa u tërhjek forcat serbe prej Kosove, lufta nuk do
10 të ndalet. Ne nuk do t'i dorëzojmë armët. Këto kanë qenë ma
11 shumë temat që ne mendoj në atë kohë por s'më kujtohet ma
12 shumë se çka. Nji mbështetje e ka, e di që e ka pas edhe
13 delegacioni i Rambujesë nga komandantët e zonave.

14 PY. Do mundohem që t'ju rifreskoj memorien. Ka dy gjëra që
15 komandantët e zonës donin. Së pari, qëndrimi juaj ishte që
16 procesi i bisedimeve duhet të çonte në një proces për
17 pavarësimin e Kosovës. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

18 PË. Po, e saktë.

19 PY. Pika e dytë që ju keni përcjellë ishte që pasi kishit
20 ndërtuar UÇK-në, pra, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovë, ju nuk
21 donit që të nënshkruhej një dokument që të demobilizohej një
22 strukturë që ju e kishit ndërtuar, domethënë të shpërbehej
23 UÇK-ja. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

24 PË. Nuk e di një dokument që e kam nënshkru, por në fakt kemi
25 qenë kundër që UÇK-ja të -- demobilizohet, ose të, po flas për

1 periudhën 1998-1999, pa përfundu lufta.

2 PY. Do t'ju lexoj një tjetër pjesë të intervistës suaj me
3 Zërin.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares
5 që të kalojmë në faqen 26 në anglisht, dhe në të njëjtin
6 dokument në PDF që kemi në ekran, në faqen 23 [Sipas
7 përkthimit]. Në faqen 33. Kjo është pjesa ku fillon me "Pas
8 konferencës së Rambujesë ..." në fund, në versionin anglisht.

9 PY. Ju thoni si më poshtë:

10 "Pas konferencës së Rambujesë, ku nuk u nënshkrua
11 marrëveshja, Thaçi kërkoj një periudhë prej 2 javësh në mënyrë
12 të tillë që të konsultohesh dhe një herë tjetër me bazën e UÇK-
13 së. Ai erdhi në Kosovë dhe u konsultua me komandantët e zonave
14 operative. Ne të gjithë i dhamë atij pëlqimin tonë për të
15 nënshkruar dokumentin në konferencë që do të mbahej në Paris.
16 Ndërkohë, kur unë jam caktuar gjeneral komandues i UÇK-së dhe
17 midis dy takimeve, ne kemi organizuar një takim me Wolfgang
18 Petritsch, ku Rexhep Selimi, Fatmir Limaj, Jakup Krasniqi,
19 Ramë Buja, dhe unë vetë si komandant, morëm pjesë. Takimi
20 është zhvilluar në Tësternik, në regjionin e Drenicës, dhe ne
21 theksuam dhe një herë tjetër qëndrimet tona lidhur me
22 konferencën dhe nënshkrimin e marrëveshjes."

23 Është e saktë, apo jo, Dëshmitar, që z. Thaçi u desh që
24 të kthehej në Kosovë në mënyrë të tillë që të merrte pëlqimin
25 apo mbështetjen e komandantëve të zonave për të nënshkruar

1 dokumentet, marrëveshjen, pra? A është e saktë kjo?

2 PË. Po, është e saktë.

3 PY. Të kalojmë tek një temë tjetër tani. Ka të bëjë me
4 operacionin Shigjeta.

5 Drejtoria e operacioneve e Shtabit të Përgjithshëm
6 mbërriti në një plan që kishte të bënte me operacionin
7 Shigjeta. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

8 PË. Po, e saktë.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] I kërkoj Sekretares tani të
10 kalojmë te përkthimi i rishikuar i intervistës së Zërit -- po.
11 Mund të kalojmë një faqe përpara te versioni në PDF që kemi në
12 ekran. Tek rreshti i dytë në fund fare. Domethënë, te kolona e
13 dytë, dhe pastaj vazhdon te kolona e tretë, në fund të kolonës
14 së dytë dhe në fillim të kolonës së tretë.

15 PY. Ju thoni si më poshtë në intervistën me zërin, lidhur me
16 operacionin Shigjeta. Ju thoni që:

17 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Shtabi i Përgjithshëm,
18 e përballur me shumë ofensiva të ndërmarra nga armiku dhe
19 sfida të ndryshme politike, si dhe vështirësi të shumta sa i
20 takon furnizimit me municione, vështirësi të tjera", dhe thoni
21 gjithashtu që, "ata janë hasur me vështirësi të shumta,
22 popullata civile, vështirësi të cilat kanë të bëjnë me
23 furnizime me municione me armë, vështirësi për furnizim me
24 ushqim, dhe në veçanti për njerëzit dhe ishte, kishte
25 vështirësi të shumta edhe sa i takon detyrave të luftës.

1 Lidhur me planet e luftës, ishte e nevojshme që të ndërmerrej
2 operacioni Shigjeta, të cilin ne e kemi përgatitur dhe e kemi
3 kryer në mënyrë profesionale dhe efektive. Mbështetur në punën
4 dhe besimin që kishim në drejtorinë operative të Shtabit të
5 Përgjithshëm të UÇK-së, unë nxora ose lëshova urdhrin dhe
6 nënshkrova planin operativ për operacionin Shigjeta, duke
7 pasur besim të plotë që ky operacion do të ishte i suksesshëm.
8 Zona operative e Pashtrikut u ngarkua me detyrën e zbatimit të
9 këtij operacioni. Qëllimi i këtij operacioni ishte që të
10 shkëputej, pengimi midis kufirit Shqipëri Kosovë dhe
11 gjithashtu që të mund të sillnin në Kosovë shumë vullnetarë të
12 tjerë. Pra, të cilët donin të vinin në Kosovë për të luftuar,
13 për jetë apo vdekje.”

14 Pra, a është ky procesi sipas të cilit është miratuar
15 Operacioni Shigjeta dhe qëllimi kryesor ishte thyerja e
16 kufirit Shqipëri-Kosovë dhe sigurimi i futjes së vullnetarëve
17 në Kosovë për të luftuar për jetë apo vdekje?

18 PË. Po, qëllimi kryesor është, ka qenë që të krijohet një
19 korridor dhe që edhe popullata civile, por edhe ne si Ushtri
20 Çlirimtare e Kosovës, të riorganizohemi dhe të pajisemi me
21 armë dhe me municione. Njëkohësisht unë e kam shpjegu se në
22 këtë operacionin Shigjeta kam nënshkru unë, dhe është përgatit
23 prej disa oficerëve të cilët unë i kam cek sa m’u kanë kujtu
24 në atë kohë. Dhe kjo është përshkrimi të cilin unë e kam ba
25 edhe me këtë gazetë.

1 PY. Dhe një person që e ka planifikuar këtë operacion ka qenë
2 Bislum Zyrapi, apo jo, Dëshmitar?

3 PË. Fillimisht, po normal që ka qenë Bislumi ma, kishte qenë,
4 ka qenë plan i paramendum edhe paraprakisht, nga qendra
5 operative nga salla operative, mirëpo ne përfundimin e këtij
6 projekti, këtij plani, është ba edhe është nënshkru me anën e
7 takimit ku unë kam pas në Norvegji me Agim Çekun dhe të
8 tjerët. Është detajizu edhe disa nga Agimi dhe nga oficerët
9 dhe unë e kam nënshkru këtë urdhër, këtë plan.

10 PY. Në rregull. Pas nënshkrimit, të nesërmen u diskutuan
11 emërimet lidhur me zbatimin e këtij plani. A është e saktë
12 kjo, Dëshmitar?

13 PË. Të nesërmen, nuk e di, ose të pasnesërmen, unë ia kam
14 dorëzu detyrën Agim Çekut. Edhe me planin e matutjeshëm është
15 marrë Agimi bashkë me Bislum Zyrapi dhe me ekipin tjetër.

16 PY. Ju thoni që nuk ju kujtohen hollësitë e asaj çfarë janë
17 diskutuar në takim me Bislum Zyrapi, lidhur me operacionin
18 Shigjeta. Këtë po thoni, apo jo? Këtë e thoni në provën P2028
19 ën faqen 3, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

20 PË. Nuk më kujtohet saktë, mund të ma përsërit dhe një herë
21 pyetjen, se u përqendrova diku tjetër?

22 PY. Po. Ju është bërë pyetje në deklaratën tuaj, deklaratën
23 tuaj si Dëshmitar, që ka numër 02028, është pyetja 15. Pyetja
24 ka qenë:

25 "A ka pasur ndonjë rol Bislum Zyrapi në operacionin

1 Shigjeta?"

2 Ju jeni përgjigjur:

3 "Nuk më kujtohet me saktësi. Nuk më kujtohet ndonjë
4 diskutim i tillë gjatë takimit, të paktën në praninë time.
5 Takimi zgjati dy a tri ditë, dhe unë më pas u ktheva në zonën
6 e Drenicës pasi u emërova komandanti i gardës kombëtare."

7 PË. Po, e saktë.

8 PY. Tani pyetja ime është kjo -- Unë po ju them, do t'ju
9 tregoj, më falni, çfarë ka thënë z. Zyrapi këtu, vitin e
10 kaluar, dhe ai tha kështu, kjo është e pasqyruar në transkript
11 në faqen 17767, rreshtat 22 dhe 24. Pyetje që i është bërë z.
12 Zyrapi:

13 "PY. Sa i takon Operacionit Shigjeta, ju keni qenë
14 përgjegjës për operacionet dhe Operacionin Shigjeta, saktë?"

15 Ai u përgjigj:

16 "Po, saktë. Kishte operacione."

17 Keni ndonjë arsye ta kundërshtoni këtë?

18 PË. Jo, nuk kam arsye. Unë e kam sqaru, nuk e di ma si u
19 zhvillu operacioni Shigjeta, edhe si janë marrë vendimet se
20 nuk kam qenë prezent.

21 PY. Nuk keni ndonjë arsye ta kontestoni dëshminë e tij kur ka
22 thënë në transkript 17768, pra ai ka thënë se planet për
23 operacionin Shigjeta kishin filluar të përgatiteshin qysh në
24 fillimet e janarit 1999, a është kjo e saktë?

25 PË. Kjo mund të jetë e saktë për arsye se Bislimi ka punu si

1 shef i shtabit dhe ka punu me qendrën operative. Unë vetëm jam
2 njoftu me detajet kur kam shku edhe në cilën fazë ka qenë
3 zhvillimi, përgatitja e këtij plani operacional.

4 PY. Do t'ju lexoj diçka tjetër që ka thënë po ashtu Bisl
5 Zyrapi në këtë sallë gjyqi. Kjo që do t'ju lexoj tani është e
6 pasqyruar në transkript në faqet 17768, në rreshtat 14 deri
7 24:

8 "PY. Ka pasur tri komanda operative të Shigjetës",
9 "Komandantë -- ", më falni, "sa prej këtyre komandantëve keni
10 emëruar ju?"

11 Z. Zyrapi është përgjigjur:

12 "PË. Komandat operative? Por s'kam qenë vetëm unë i
13 përfshirë në emërimet. Ka qenë edhe shtabi i përfshirë.
14 Komandantët e Drejtimit 1 dhe Drejtimit 2 janë emëruar me
15 propozimin tim dhe janë aprovuar nga Shtabi i Përgjithshëm.
16 Janë emëruar. Por sikurse jua thashë, emërimet e tyre u bënë
17 në bazë të propozimeve të mia dhe të komandantit të
18 përgjithshëm.

19 "PY. Komandant Çeku ishte ky?"

20 "PË. Jo. Ka ndodhur më shpejt kjo. Kur ka qenë Sylejman
21 Selimi."

22 A është e saktë kjo, pra?

23 PË. Kjo nuk më kujtohet që ka ndodh. Unë e kam sqaru edhe për
24 zhvillim ndoshta është punu në këtë drejtim, por mu nuk më
25 kujtohet një gjë e tillë. Megjithatë, unë jam kanë i

1 shkëputun, se jam kanë që në Drenicë, Bislimi në Shtabin e
2 Përgjithshëm edhe në këtë pjesë ndoshta është parapërgatit ky,
3 po mu nuk më kujtohet. Për arsye se këtë, mu më ka zëvendësu
4 Gjeneral Çeku në këtë periudhë. Po flas mbasi kam nënshkru
5 operacionin Shigjeta, sa është bo parapërgatitja, dhe
6 emërimet, nuk më kujtohet një gjë e tillë.

7 PY. Në rregull. E mora përgjigjen tuaj, e kuptova përgjigjen
8 tuaj. Ju i keni thënë javën e kaluar Prokurorit se vetëm pasi
9 keni miratuar planin për Operacionin Shigjeta jeni takuar me
10 Agim Çekun, Hashim Thaçin, Kadri Veselin. Kjo është pasqyruar
11 në Shënimin Përgatitor numër 2, paragrafin 89. A është kjo e
12 saktë?

13 PË. Po, është e saktë që jam taku me Agim Çekun, me Hashim
14 Thaçi dhe me Kadri Veselin.

15 PY. Po. Dhe keni thënë, pasi keni miratuar planin për
16 operacionin, saktë?

17 PË. Jo. Nuk e di a ka qenë po ajo ditë, por mbasi e kam
18 miratu planin , unë kam kërku që të zëvendësohena me Agim
19 Çekun ose të lë detyrën si komandant i përgjithshëm.

20 PY. Në rregull. Në Shënimin Përgatitor numër 2, paragrafi 89
21 thuhet:

22 "Pasi ka miratuar planin për operacionin, Dëshmitari
23 W04290 u takua me Agim Çekun, Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin.
24 Në të njëjtin shënim -- në paragrafin 98 [Sipas përkthimit] ju
25 keni thënë, "Pasi miratova planin për operacionin Shigjeta,

1 nuk u përfshiva në diskutimet e përgjithshme për përgatitjen
2 më konkrete të operacionit Shigjeta", dhe u larguat. A është
3 kjo e saktë?

4 PË. Po, e saktë. Kjo ka ndodh mbas dy ditë ose tre ditë, nuk
5 e di, s'më kujtohet saktë.

6 PY. Në paragrafin 90 ju thoni se ju e dini që të pranishëm në
7 atë takim ka qenë edhe Spiro Butka, Bardhi, Shpëtim Golemi,
8 Bislrim Zyrapi, Agim Çeku, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Fatmir
9 Limaj dhe të tjerë. Saktë?

10 PË. Personat të cilët, oficerët të cilët kanë qenë Spiro
11 Butka, Bardhi, më fal që nuk po, nuk më kujtohen emrat e tyre
12 saktë tash, edhe Agim Çeku, kanë punu me definimin e
13 operacionit Shigjeta. Domethënë, plani i cili ka qenë i
14 parapërgatitun, në këtë takim e parë këta kanë punu me këtë
15 planifikimi të detajizum, ku unë e kam nënshkru. Të nesërmen
16 unë jam taku me persona dhe me të tjerë.

17 PY. Po. Ju keni thënë "dhe të tjerë" kanë qenë të pranishëm.
18 Keni dashur të thoni që e dini që ka pasur dhe persona të
19 tjerë dhe nuk ju kujtohen emrat?

20 PË. Faktikisht, duhet të bëhen dy dallimet. Këta persona kanë
21 qenë në planifikimin edhe operacionin Shigjeta bashkë me
22 Agimin. Të nesërmen ka pas edhe njerëz të tjerë në objekt që
23 kanë ardh dhe kanë hy. Kjo është fjala. Unë personalisht jam
24 taku me Gjeneral Çekun, me Kadri Veselin dhe me Hashim Thaçin.
25 A ka qenë e nesërme kjo.

1 PY. Në rregull. Ju keni thënë se nuk keni qenë i pranishëm
2 kur u zgjodh Agim Çeku për të qenë shef i Shtabit të
3 Përgjithshëm të UÇK-së, dhe keni dëgjuar për emërimin e tij
4 përmes televizionit gjatë kohës që ishit në Berishë, saktë?

5 PË. Po, vetëm unë kam qenë, propozim, sugjerim i imi në këtë
6 takim kur ne jemi taku. Unë pas dy dite jam kthyer prapë për
7 Berishë për me shku për Drenicë. Edhe ma vonë është dalë me
8 komunikatë dhe që është emëru Agim Çeku. Kjo është e saktë. Sa
9 më kujtohet mu, kjo është periudha e takimit.

10 PY. Po, por unë dua të theksoja këtë: Ju e keni bërë
11 propozimin që t'ju zëvendësonte dhe ju u larguat pastaj,
12 saktë?

13 PË. Nuk e di a kam qenë edhe një ditë, por, po prapë jam
14 largu, jam shku, jam kthyer për Berishë. Për Drenicë.

15 PY. Ju nuk e dini se si u zhvillua më pas procesi i emërimit
16 të tij, pasi u larguat, saktë?

17 PË. Jo, nuk e di. Nuk e di.

18 PY. Mirë. E vërtetohet tashmë që ju nuk e dini
19 drejtpërsëdrejti se si u përgatit operacioni Shigjeta pasi ju
20 thjesht nënshkruat urdhrin për miratimin e këtij plani, pra më
21 tej ju nuk e dini çfarë ndodhi, saktë?

22 PË. Saktë.

23 PY. Ju nuk keni njohuri të drejtpërdrejta se si u zgjodh z.
24 Çeku si shef i Shtabit të Përgjithshëm pasi u larguat ju,
25 saktë?

1 PË. Është e saktë.

2 PY. Duke qenë se nuk ishit i pranishëm në përgatitjen e
3 Operacionit Shigjeta, dhe nuk keni qenë as i pranishëm kur u
4 zgjodh Gjeneral Çeku si shef i Shtabit të Përgjithshëm, ju nuk
5 keni ndonjë njohuri personale që Hashim Thaçi të ketë caktuar
6 role personave të caktuar për të kryer operacionin për të
7 realizuar operacionin Shigjeta, saktë?

8 PË. Është e saktë, unë asnjëherë s'kam thanë që kam pas
9 dijeni që Hashim Thaçi ose dikush tjetër ka pas rol në këtë,
10 në operacionin Shigjeta. Ose në emrin e të tyre. Nuk e di kush
11 edhe si ka shku procesi i emërimit ma tutje.

12 PY. Ju nuk keni thënë që të ketë qenë Jakup Krasniqi, më
13 falni, z. Jakup Krasniqi në ndonjë nga këto diskutime, apo jo?

14 PË. Nuk besoj, nuk më kujtohet që ka qenë.

15 PY. Pra, nëse z. Jakup Krasniqi më vonë shkroi se si u
16 zhvillua operacioni Shigjeta dhe si u morën vendimet, me sa
17 keni ju dijeni, ai s'ka nga ta ketë ditur këtë
18 drejtpërsëdrejti se si janë vendimet lidhur me operacionin
19 Shigjeta.

20 Z. HALLING: [Përkthim] E kundërshtoj, është spekuluese.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

22 Reformulojeni, ju lutem, pyetjen. Sepse në fakt është
23 spekuluese mënyra se si u bë.

24 Z. MISETIC: [Përkthim]

25 PY. Ju keni qenë i pranishëm deri në momentin që u aprovua

1 Pperacioni Shigjeta, saktë?

2 PË. Po, saktë.

3 PY. Keni pak dijeni, e dini kush ka qenë i pranishëm gjatë
4 kohës që ju ishit në largim e sipër? Ju thatë erdhi Agim Çeku,
5 erdhën disa oficerë prej Shqipërisë, saktë?

6 PË. Po, e saktë.

7 PY. Por ama ju nuk keni ndonjë dijeni, nuk dini gjë të ketë
8 qenë i pranishëm z. Jakup Krasniqi, saktë?

9 PË. Nuk ka qenë i pranishëm z. Krasniqi.

10 PY. Nëse më vonë, pra kur më vonë z. Krasniqi shkroi për
11 mënyrën se si ishin marrë vendimet, pra, për operacionin
12 Shigjeta, sipas jush, nga mund ta ketë ditur ai se si janë
13 marrë vendimet për operacionin Shigjeta?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Është spekuluese.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

16 Dëshmitar, mund t'i përgjigjeni.

17 DËSHMITARI: Nuk e di.

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Dua t'ju tregoj një intervistë të z. Çeku lidhur me
20 emërimin e tij.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Fillimisht shohim provën 1d00243-
22 ET, është një pjesë që duhet të jetë dhe në anglisht edhe në
23 shqip.

24 PY. Në paragrafin që fillon: "Gjatë kontakteve që kemi pasur
25 ..."

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Mbase në faqen tjetër duhet të
2 jetë. Majtas, është majtas. Është kolona majtas. Po,
3 faleminderit.

4 PY. Ai ka thënë kështu në këtë paragraf. Fillojmë në mes të
5 paragrafit:

6 "Por unë nuk e kam pranuar këtë vlerësim. Edhe aktiviteti
7 im nuk ka qenë kurrë publik. Për të dinte vetëm një rreth
8 shumë i ngushtë. Nuk doja të bëhej publike se jam në kontakt
9 me UÇK-në edhe të qëndroja jashtë Kosovës. Kam insistuar që
10 vendimet për angazhimin tim konkret të merren në Kosovë.
11 Pastaj, disa ditë kemi qëndruar në Shtabin e Përgjithshëm dhe
12 është diskutuar puna ime gjerë e gjatë dhe vendimi që unë të
13 emërohesha shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, u mor nga
14 i gjithë Shtabi i Përgjithshëm, jo nga një person i vetëm."

15 Ju nuk keni ndonjë arsye ta kontestoni përshkrimin që i
16 ka bërë z. Çeku emërimit të tij kur ka thënë që mua nuk më
17 emëroi një person, por më emëroi gjithë Shtabi i Përgjithshëm?
18 PË. Po mendoj që është e saktë ajo që ka thënë. Ai e din ma
19 mirë se kush ka qenë prezent.

20 PY. Dua t'ju tregoj një pjesë tjetër të së njëjtës
21 intervistë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
23 ekran materialin DHT04009 deri në DHT04017-ET në faqen 4.
24 Shqipja është SPOE0005360 [Sipas përkthimit] deri në 00053071
25 në faqen SPOE00053067. Kolona e -- [Mikrofoni çaktivizuar]. Në

1 mes të kolonës.

2 PY. Pyetja që i është bërë z. Çeku ka qenë kështu:

3 "Si u mor vendimi për ardhjen tuaj në Kosovë?"

4 Dikund në mes ai thotë:

5 "Në Kosovë nuk hyra për t'u bërë komandant, por të shtoja
6 një pushkë, të jepja kontributin tim në ditët më të vështira.
7 Në një mënyrë nuk doja t'i jepja vetes përparësi për t'u
8 ngarkuar detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-
9 së. Sidomos në ato momente të vështira. Ta marrësh një
10 përgjegjësi të tillë vërtet ishte një gjë e madhe. Por, me
11 insistimin e Shtabit të Përgjithshëm, me konsultimin e
12 komandantëve të zonave, më është ngarkuar ajo detyrë, të cilën
13 unë e mora përsipër. Këtë e bëra meqë në Kosovë kisha ardhur
14 për ta kryer çdo detyrë që kërkohet nga unë."

15 Ndalojmë këtu. Pra, z. Çeku thotë që një nga detyrat që
16 ka bërë ai përpara se të pranonte emërimin, është të
17 konsultohet me komandantët e zonës, me komandantin e zonës. E
18 shihni atë?

19 PË. Po, e shoh.

20 PY. Keni thënë që ai e ka diskutuar këtë me ju, apo jo?

21 PË. Sa i përket kësaj nuk më kujtohet që ai ka diskutu me ne.
22 Mbasi është emëru, mendoj që, po, e ka diskutu, edhe ka pas
23 biseda rreth kësaj. Por jo para se me u emëru. Me komandantët
24 e zonave unë nuk e di si ka bisedu me dikënd, përpara se me u
25 emëru.

- 1 PY. Nga do ta dinit ju, për shembull, nëse ai ka pasur
2 konsultime me z. Ramush Haradinaj, komandant Remin? Ju nga do
3 ta mësonit këtë gjë?
- 4 PË. Për atë arsye nuk mund me spekulu as muj me thanë që ai
5 ka, të paktën që ka bisedu me, ndoshta ka bisedu me komandantë
6 të tjerë, por me mu jo. Unë e kam propozu atë ditë që e kam pa
7 atë ditë kur, Gjeneral Çekun, kam propozu që ai të jetë
8 komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në vendin tim.
- 9 PY. Ju keni thënë që ka pasur një bashkëbisedim apo një
10 diskutim ku janë përpjekur t'ju shkurajojnë, të hiqni dorë nga
11 vendimi juaj, apo jo?
- 12 PË. Po. Mendoj që po. Tash nuk po më kujtohet, por më ka
13 thënë që mos me u tërhjek. Por nuk më kujtohet. Besoj. Tash
14 nuk e di, kanë kalu shumë kohë e gjatë dhe detajet nuk i, nuk
15 më kujtohen.
- 16 PY. Ju me sa kuptoj unë dëshminë tuaj, ju i keni thënë atij
17 që ai kishte përkrahjen tuaj për t'u bërë shefi i Shtabit të
18 Përgjithshëm të UÇK-së, apo jo?
- 19 PË. Po.
- 20 PY. Vazhdojmë tek pyetja e radhës. Thuhet:
- 21 "A mund të përshkruani procedurën e ardhjes suaj në
22 Kosovë?
- 23 "Nga Sllovenia kam udhëtuar me aeroplan për në Shqipëri.
24 Pasdite jam takuar në Tiranë me disa veprimtarë të UÇK-së. Të
25 nesërmen mbrëma kemi qenë në kufi. Kur hyra në Kosovë, ende

1 nuk kishin filluar bombardimet e NATO-s. Në Kosovë kam hyrë me
2 Hashim Thaçin. Kaluam natën nëpër bjeshkë të larta me borë,
3 dhe vazhdimisht ishim të rrezikuar e sidomos gjatë kalimit të
4 kufirit. Por s'na ndalonte gjë sepse ishim të përcaktuar për
5 të hyrë në Kosovë."

6 A ju kujtohet nga takimi më pas që të jetë diskutuar që
7 z. Çeku të ketë hyrë në Kosovë nga Shqipëria bashkë me z.
8 Thaçi?

9 PË. Nuk më kujtohet diçka e tillë. E di që kanë ardh bashkë
10 me Hashim Thaçin, por këtu e ka përshekrua ai si ka ardh. Nuk e
11 di.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, do kërkoja
13 që kjo faqe konkrete t'i bashkëngjitej provës 1D00243.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm faqja
15 4?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

18 Z. HALLING: [Përkthim] S'kemi kundërshtim për këtë. Dhe
19 nuk kemi kundërshtim që të pranohen të gjitha faqet e
20 intervistës. Ne vazhdimisht mendojmë që dokumentet duhet të
21 pranohen në tërësinë e tyre për kontekst. Por për këtë faqe,
22 sigurisht që s'kemi asnjë kundërshtim.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Doni që ta
24 pranojmë të gjithë dokumentin?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Po më lini ta shoh një herë gjatë

1 pushimit dhe do t'ju them pasi të rifillojmë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po vendos
5 atëherë lidhur me këtë.

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, ju nuk keni ndonjë njohuri të drejtpërdrejtë
8 se kujt i raportonte Gjeneral Çeku pasi u bë shefi i Shtabit
9 të Përgjithshëm, saktë?

10 PË. Jo, nuk kam njohuri. E saktë.

11 PY. Ju personalisht nuk e dini a i raportonte ndokujt, saktë?

12 PË. Nuk e di.

13 PY. Ju personalisht nuk e dini se kujt duhet t'i kishte
14 raportuar z. Çeku, saktë?

15 PË. Mendoj që është dasht si shef i shtabit, është dasht t'i
16 raportojë ministrit të mbrojtjes. Ose dhe në rrethana të
17 caktume, shefit të qeverisë, në një vend normal. Por është i
18 varur direkt nga shtabi -- nga ministri i mbrojtjes. Por në
19 këtë kohë, nuk e di si ka shku dhe kujt i ka raportu.

20 PY. Po. Dhe ju thatë në rrethana normale, e theksuat këtë,
21 por këto nuk ishin rrethana normale, apo jo?

22 PË. Jo.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, po shoh që
24 ka vajtur ora për pushimin.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë,

1 Faleminderit.

2 Dëshmitar do bëjmë gjysmë ore pushim. Mos flisni me
3 askënd, ju lutem, për dëshminë tuaj jashtë ambienteve të
4 Gjykatës. Do rikthehemi në orën 11.30. Tani mund të largoheni.

5 [Dëshmitar përfundon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
7 deri në orën 11.30.

8 --- Pauza fillon në orën 11.00

9 --- Seanca rifillon në orën 11.30

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A patët
11 mundësi që ta shikonit të gjithë dokumentin z. Misetic?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo. Në qoftë se më lejoni pushim e
13 ardhshëm ose gjatë pushimit të drekës, ndoshta më mirë, se kam
14 qenë i ngarkuar me çështje të tjera.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

16 Ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Selimi, do
19 të vazhdojmë më tej me pyetjet e avokatit të z. Thaçi.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës.

21 PY. Z. Selimi, dëshiroj t'i kthehemi përsëri një përgjigjeje
22 që dhatë sot paradite, dhe do ju kërkoj të jepni sqarime të
23 mëtejshme lidhur me të.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni vetëm një minutë, ju
25 lutem.

1 PY. Në faqen e transkriptit 39, unë ju pyeta, pra ju kërkoja
2 që të konfirmoni që ju nuk keni njohuri personale që Hashim
3 Thaçi ka caktuar role individëve për të kryer Operacionin
4 Shigjeta. A është e saktë?

5 Dhe ju thoni:

6 "Po. Është e saktë. Unë asnjëherë nuk kam thënë" -- ju
7 kërkoj ndjesë se po më lëviz fleta -- faqja e transkriptit.

8 Pra, ju thoni që:

9 "Nuk kam thënë asnjëherë që kam njohuri që Hashim Thaçi
10 ose dikush tjetër ka luajtur ndonjë rol për Operacionin
11 Shigjeta dhe sa i takon këtyre emërimeve."

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Do dëshiroja që të paraqitet në
13 ekran prova P02028. Të shkojmë në faqen 3 në anglisht dhe
14 faqen 8 në shqip.

15 PY. Është përgjigja që keni dhënë për pyetjen 13, në
16 versionin në shqip. Është intervista e 2011-s për Specialen e
17 Kosovës. Pyetja që ju bëhet është kjo. Pra, ju bëhet një
18 pyetje lidhur me një mbledhje. Juve ju bëhet pyetja:

19 "A ju kujtohet se çfarë teme kishte takimi, kishte
20 mbledhja?"

21 Dhe ju thoni që:

22 "Tema e mbledhjes ishte se si të krijohet Operacioni
23 Shigjeta, si të krijohet një korridor për kalimin e armatimeve
24 dhe të personave.

25 "Gjatë mbledhjes u caktuan role nga Hashim Thaçi për Agim

1 Çekun dhe persona të tjerë në mënyrë të tillë që të kryhej
2 operacioni.”

3 A e shikoni këtë pjesë, Dëshmitar?

4 PË. Po, e shikoj.

5 PY. Më herët diskutuam bashkë lidhur me kohën se kur janë
6 diskutuar plane të tilla operative, dhe me sa e kuptova unë ju
7 thatë që plani operativ është hartuar prej Bislum Zyrapit dhe
8 është nënshkruar prej jush. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

9 PË. Po, është e saktë.

10 PY. Pastaj, mënyra se si e kuptova dëshminë tuaj është që ju
11 keni marrë pjesë në këtë mbledhje, është mbledhje operative,
12 të paktën kështu siç i keni thënë Prokurorisë përpara një
13 jave, dhe ju thoni në fakt, që në këtë takim nuk keni qenë se
14 ishit larguar dhe në shënimin përgatitor, juve thoni që:

15 “Pasi u miratua plani jeni takuar Agim Çekun dhe Hashim
16 Thaçin dhe Kadri Veselin.”

17 Dhe pastaj në paragrafin 90 ju thoni që:

18 “Nuk keni qenë pjesë e bisedave më të gjera për të
19 përgatitur Operacionin Shigjeta ...”

20 Për këtë arsye ju kërkova që të konfirmoni që a keni
21 pasur dijeni personale, keni pasur njohuri personale, se ju
22 këtu thoni që më pas sa i takon shtjellimit ose përgatitjeve
23 për Operacionin Shigjeta, nuk keni qenë fare i pranishëm vetë.

24 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

25 PË. Po, është e saktë. Unë mund ta sqaroj edhe pak ma tepër.

1 Kur unë kam qenë aty kanë ardh edhe njerëz të tjerë, si e kam
2 përshkru, dhe ndoshta në këtë formë, domethënë është përmend
3 edhe takimi me z. Thaçi edhe të tjerët. Por, unë në takim e
4 kam sqaru që nuk kam marrë pjesë. Dhe kjo është e saktë.

5 PY. Në 2011-n, pra në qoftë se ju nuk keni pas -- nuk keni
6 qenë vetë fizikisht në këtë mbledhje, ku e keni mbështetur
7 juve këtë që keni thënë që -- ose cila ka qenë baza e asaj që
8 keni thënë që rolet janë caktuar nga Hashim Thaçi për Agim
9 Çekun.

10 PË. Jam bazu në atë të cilën shumë njerëz, domethënë, kanë
11 ardh edhe pas meje, domethënë të nesërmen edhe më duket edhe
12 disa të tjerë, por këto kam mendu për arsyet të vetë
13 pozicionit i cili ka qenë atëherë, por jo në formimin e
14 qeverisë z. Thaçi. Po jo në caktimin e roleve të pjesës
15 ushtarake, po në rolin e zgjedhjeve të ministrave të Qeverisë
16 së Përkohshme, ndoshta është bë një gabim. Domethënë, në këtë
17 aspekt në atë kohë e kam mendu ndoshta në këtë formë.

18 PY. Kur thoni "që e kam pas parasysh vetë pozicionin", por
19 për çfarë pozicioni e keni fjalë, Dëshmitar?

20 PË. Si i komandant i përgjithshëm dhe pastaj ku unë kam
21 qëndru dhe dy ditë ose një ditë, dy netë, në atë pjesë që kanë
22 ardh dhe të nesrit të tjerë rreth takimeve, por prezent nuk
23 kam qenë.

24 PY. Po në përgjigjen që na dhatë përpara një minuti, ju thatë
25 që:

1 "E mbështes ose e bazoj këtë në faktin që shumë persona
2 kanë ardhur pas meje. Kam përshtypjen që ka qenë të nesërmen.
3 Kam pasur parasysh pozicionin vetë në atë kohë, por jo në
4 kuptimin e caktimit të roleve ushtarake."

5 Për çfarë pozicioni e keni fjalën, Dëshmitar, kur e dhatë
6 këtë përgjigje?

7 PË. Në këtë kohë jam kon pa pozicion, po s'jam kon i
8 pozicionum në ato, është fjala, domethënë, që kam qenë prezent
9 vetë që kam qenë prezent vetë në atë lokacion.

10 PY. Do vazhdoj më tej.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Misetiç, ju kërkoj
12 ndjesë. Trupi Gjykues e ka të vështirë që të kuptojë se ç'a po
13 thonë dëshmitari në këtë pjesë të dëshmisë së tij. Domethënë,
14 cila është dëshmia e tij sa i takon këtij aspekti. Dua të
15 përfitoj nga rasti, t'ju bëj këtë pyetje ju, Dëshmitar.

16 Z. Selimi, sikurse e thatë, dhe sikurse e kemi ende në
17 ekran, si në versionin në anglisht dhe në shqip, të paktën
18 sipas transkriptit, ju i keni thënë Speciales -- SITF-së,
19 TFHS-së, i keni thënë si më poshtë:

20 "Gjatë mbledhjes janë caktuar role nga Hashim Thaçi për
21 Agim Çekun, Bislir Zyrabin dhe të tjerët për kryerjen e
22 operacionit".

23 Dhe një fjali përpara e ka fjalën për Operacionin
24 Shigjeta, pra flet për Operacionin Shigjeta. Pyetje që kam për
25 juve është kjo: TFHS-së a i keni thënë që z. Thaçi i ka

1 caktuar role Agim Çekut, Bislrim Zyrapit dhe të tjerëve për të
2 kryer apo për të realizuar Operacionin Shigjeta? A i keni
3 thënë këtë gjë TFHS-së, Dëshmitar, apo jo?

4 DËSHMITARI: Po shihet që e kam thënë edhe nuk -- prapë unë nuk
5 kam qenë në takim. Unë kam supozu ose kam mendu që -- edhe e
6 kam thon këtë [E pakuptueshme] e z. Thaçi. Por, nuk kam --
7 tash, tash po i shoh, nuk më kujtohet ma tutje, por prezent
8 nuk kam qenë në takim.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A i keni thënë TFH-së që
10 thjesht e supozoni këtë, apo i keni thënë kështu siç thuhet
11 në transkript që në fakt z. Thaçi ka caktuar role në atë
12 mbledhje?

13 DËSHMITARI: Në mbledhje unë kam mendu që si përfaqësues i
14 Qeverisë së Përkohshme ose si mandatar i kryeministrit, kam
15 mendu që z. Thaçi, e kam thon atëherë pra -- ku shihet që e
16 kam thonë, dhe unë kështu kam mendu në atë kohë, por nuk kam
17 qenë në takim dhe nuk e di.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të sqaroj
20 për procesverbal, në qoftë se ju vij në ndihmë. Kjo është një
21 pjesë e cila është sqaruar në paragrafin P2229 [Sipas
22 përkthimit] në paragrafin 7.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
24 vazhdoni, Misetic.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani që më ndërpretë pyetjen dua

1 që t'i hedh një sy se çfarë -- për çfarë bëhet fjalë domethënë
2 në këtë pjesë. Më lejoni një çast, ju lutem.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Është Shënimi Përgatitor numër 1,
4 në qoftë se mund t'ju ndihmoj.

5 Z. MISETIC: [Përkthim]

6 PY. Po. Është një çështje që dua ta ngre me ju. Ju i keni
7 thënë Prokurorit përpara një jave, Dëshmitar, që ju e dinit që
8 Hashim Thaçi i ka caktuar role këtyre individëve për
9 realizimin e Operacionit Shigjeta, por nuk e dinit konkretisht
10 se cilat ishin këto detyre. Do t'ju lexoj paragrafin e plotë,
11 Dëshmitar. Ju thoni që:

12 "Ju keni qenë pjesë e përgatitjeve për Operacionin
13 Shigjeta, por pastaj jeni larguar të nesërmen. Operacioni vetë
14 është prezantuar nga Agim Çeku, Çeku, Bislum Zyraku [Sipas
15 përkthimit] dhe të tjerë që kanë qenë personat që kanë
16 përgatitur planin. Dëshmitari 04290", domethënë ju, "e dinte
17 që Hashim Thaçi ka caktuar role për këta individë për të kryer
18 operacionin, por nuk e dini konkretisht se cilat kanë qenë
19 këto role."

20 Me sa kuptoj unë, ju i keni thënë përpara një jave
21 Prokurorisë që Agim Çeku, ju -- pra, i keni thënë që Agim Çeku
22 nuk u bë komandant i përgjithshëm derisa u largove t'i dhe ju
23 e keni mësuar këtë mbasi -- e kemi mësuar nëpërmjet
24 televizionit kur keni qenë në regjionin e Drenicës ndërkohë.
25 PË. Po, e saktë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 60

1 PY. Nuk mund të keni qenë i pranishëm ju në një mbledhje ku
2 z. Hashim Thaçi i ka caktuar rol Agim Çekut sepse ai nuk ka
3 qenë në asnjë pozicion në UÇK në atë kohë ku ju keni qenë i
4 pranishëm në takime. Pra, është e pamundur që ju të keni qenë
5 pjesë e takimeve në atë kohë. A është e saktë kjo, Dëshmitar?
6 PË. Të njëjtën gjë e kam thënë edhe unë, nuk kam qenë në
7 takime dhe nuk kam qenë prezent kur është caktu.

8 PY. Po. Çfarëdolloj informacioni që mund të keni pasur ju
9 lidhur me mënyrën se si janë bërë planet pasi u larguat, mbi
10 çfarë e keni bazuar këtë informacion? Ku e keni mbështetur një
11 informacion të tillë përderisa s'keni qenë vetë aty?

12 PË. Thashë edhe ma herët, jam mbështet në atë që z. Thaçi ka
13 prit njerëz dhe delegacione, delegacione për formimin e
14 Qeverisë së Përkohshme, dhe në këtë aspekt për konsultimin e
15 Qeverisë së Përkohshme ose për njerëz, me anëtarë të cilët
16 janë zgjedh pastaj. Domethënë, në këtë aspekt kam thënë që z.
17 Thaçi është -- është merr emërime ose është merr me -- të
18 ministrave ose të qeverisë së tij.

19 PY. Në rregull.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të vazhdojmë më tej?

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

23 PY. Dëshmitar, tani do flasim lidhur me rolin tuaj në UÇK.

24 Ju keni qenë komandant i zonës së Drenicës nga maji i
25 vitit 1998 deri në shkurt të '99-s. A është e saktë kjo?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 61

1 PË. E saktë.

2 PY. Ju u bëtë komandant i përgjithshëm i UÇK-së në shkurt të
3 '99-s. A është e saktë kjo?

4 PË. E saktë.

5 PY. Dua t'ju tregoj provën 1D000205.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] A mund të më jepni një
7 çast, ju lutem.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 duket sikur ka probleme teknike. Nuk e di në qoftë se mund të
11 më lejoni një moment.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Po, edhe ne nga ZPS-ja kemi
13 vështirësi për ngarkimin e dokumenteve dhe për parjen e
14 dokumenteve në sistemin *Legal Workflow*.

15 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
16 këshillohen]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do dalim për
18 pak minuta në mënyrë të tillë që të zgjidhet problemi teknik.
19 Sapo të na thonë që është zgjidhur problemi, do mblidhemi
20 përsëri këtu në sallë.

21 E mbyllim seancën për momentin këtu.

22 --- Seanca ndërpritet në orën 11.50

23 --- Seanca fillon në orën 12.10

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
25 sillni dëshmitarin.

1 [Dëshmitari vijon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkojmë
3 ndjesë, z. Selimi, për këtë vonesë. Do të vazhdojmë tani me
4 pyetjet. Z. Misetic ka ende pyetje për ju.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

6 I lutem Sekretarisë tani të vendosë në ekran provën
7 1D00205.

8 PY. Z. Selimi, për kontekst. Ky është një artikull që ka dalë
9 në gazetë britanike, *The Independent* është gazeta, është një
10 artikull që ka dalë më 6 shkurt 1999 gjatë kohës që po bëhej
11 konferenca e Rambujesë. E kuptoni kontekstin?

12 PË. Po.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen 3 në të dyja
14 versionet e dokumentit.

15 PY. Paragrafi në krye thotë kështu:

16 "Ekipi shqiptar përfshinë Ibrahim Rugovën, liderin
17 politik të shqiptarëve etnikë, si dhe Azem Sylën, i cili
18 thuhet të jetë komandanti kryesor i UÇK-së dhe Jakup
19 Krasniqin, një zëdhënës dhe ish-mbështetës i rrugës jo të
20 dhunshme për pavarësi të z. Rugova i cili ka kaluar
21 mbështetjen e tij tek krahu ushtarak i lëvizjes."

22 Pra, këtu shohim në këtë artikull anglez, *The*
23 *Independent*, ka thënë që Azem Syla ka qenë komandanti kryesor
24 i UÇK-së më së paku nga 6 shkurti 1999. E pranoni ju këtë?

25 PË. Po. Si shkrim e pranoj dhe e shoh. Por për mu, e kam

1 sqaru se nuk e kam dit që Azem Syla ka qenë komandant i
2 përgjithshëm.

3 PY. A mund të na e shpjegoni atëherë si ka mundësi që nga
4 pikëpamja ndërkombëtare dihej, pra, ndërkombëtarët e dinin që
5 Azem Syla ishte komandanti kryesor i UÇK-së, por nuk e dinit
6 ju si komandant i zonës së Drenicës, dihej në arenën
7 ndërkombëtare kjo dhe jo nga ju?

8 PË. Unë nuk kam koment. Nuk e di. Jo vetëm unë, po dhe shumë
9 komandantë të zonave nuk e kanë dit, në takimin ne kur e kemi
10 pas, që është Azem Syla komandant i Shtabit të Përgjithshëm.

11 PY. Shohim një dokument tjetër që besoj se ua ka treguar
12 Prokuroria gjatë seancës përgatitore, lidhet me një takim të
13 mbajtur më 6 shkurt 1999.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
15 ekran provën P00182 dhe faqen 29 në të dyja versionet.

16 PY. Tani do t'ju tregoj, z. Selimi, procesverbalin e atij
17 takimi, që sipas ZPS-së është një procesverbal i sekuestruar
18 nga shtëpia e z. Rexhep Selimi. E kuptoni këtë?

19 PË. Po.

20 PY. Këto shënime në këtë faqe kanë datën në krye, mund ta
21 shihni besoj, tek anglishtja nuk po e shohim.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Pak më lart ju lutem. Në rregull.

23 PY. Data është 6 shkurt 1999. Dhe sipas këtyre shënimeve
24 personat që kanë qenë të pranishëm janë si në vijim: Janë
25 komandantët e zonave operative të UÇK-së, Ramush Haradinaj,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 64

1 Rrustem Mustafa, Ekrem Rexha, Sylejman Selimi dhe më poshtë
2 thotë përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm, Rexhep Selimi
3 dhe Bislime Zyrapit.

4 A ju kujtohet të keni marrë pjesë në një mbledhje të
5 tillë më 6 shkurt ose afër kësaj date?

6 PË. Në datën nuk e di saktë, por nuk më kujtohet një takim i
7 tillë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim faqen 34 të dokumentit në
9 të dyja versionet. Janë shënimi nga i njëjti takim.

10 PY. Personi që këtu përmendet si Sylja, tek pika 2, ka thënë:

11 "Emërimet që janë bërë në Shtabin e Përgjithshëm janë
12 shqetësuese. (Sokol Bashota dhe Jakup Krasniqi). Mendoj se
13 Sokol Bashota nuk është për këtë punë si zëvendëskomandant,
14 nuk është i përshtatshëm pra. Dhe Shtabi i Përgjithshëm i ka
15 shpërfillur kërkesat që kemi bërë ne ose nuk i ka marrë
16 parasysh kërkesat që kemi bërë ne për këtë çështje."

17 Shkojmë në faqen tjetër, personi si Sylja në këtë tekst ka
18 thënë:

19 "Jakup Krasniqi me gjithë respektin që ka, nuk është
20 personi i duhur për postin e zëvendëskomandantit, nuk e
21 meriton postin e zëvendëskomandantit.

22 "Për emërimet të Shtabit të Përgjithshëm duhet të
23 konsultohemi edhe ne. Ata që kanë marrë armët për të luftuar
24 nuk po merren parasysh."

25 Ju tregova listën e pjesëmarrësve siç është në këtë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 65

1 shënim dhe ka qenë: Ramush Haradinaj, Rrustem Mustafa, Ekrem
2 Rexha, Sylejman Selimi, Rexhep Selimi dhe Bislim Zyrapit kanë
3 qenë personat e pranishëm. Kush mund të jetë Sylja përveç se
4 jush, nëse marrim parasysh këtë gjashtë emra këtu?

5 PË. E para, nuk kam pas edhe emrin edhe pseudonimin dhe të
6 gjitha. Po megjithatë, unë këtë shkrim, as këtë takim nuk e di
7 që kur është mbajtur dhe si u mbajtur. Nuk po më kujtohet.

8 PY. Në rregull. Tek pjesa që u lexova unë, personi që
9 identifikohet si Sylja thotë që Sokol Bashota dhe Jakup
10 Krasniqi nuk e meritojnë punën për rolin e
11 zëvendëskomandantit. Pjesëmarrës në këtë takim, pra, të gjithë
12 pjesëmarrësit në këtë takim kanë qenë në dijeni se UÇK-ja ka
13 pasur zëvendëskomandantë dhe se këta zëvendëskomandantë ishin
14 Jakup Krasniqi dhe Sokol Bashota, saktë?

15 PË. Po, është e saktë. Se për Jakupin edhe për Sokolin e kemi
16 dit që janë dy zëvendëskomandantë.

17 PY. Tani ju e dinit që ishin dy persona që po kryenin rolin e
18 zëvendëskomandantit, po për të qenë zëvendëskomandant duhet të
19 ketë pasur një komandant, apo jo?

20 PË. Po.

21 PY. Pra, ju e dinit që kishte një komandant kryesor edhe ka
22 një komandant prandaj dhe ekzistojnë dy zëvendëskomandantë?

23 PË. Por asnjëherë nuk është thënë kush është.

24 PY. Pra, siç po e kuptoj unë dëshminë tuaj, ju po thoni që si
25 pjesëmarrës në këtë takim, ju e dinit që ekzistonte një

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 66

1 komandant kryesor, por nuk e dinit nëse ky person ishte Azem
2 Sylja?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj, ka shtrembërim të
4 dëshmisë. Ai nuk ka thënë këtë gjë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, këtë gjë
6 po thotë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë me përgjigjet e dëshmitarit po
8 bazohem. Ai po thotë, pra, dëshmitari thotë që ai e dinte që
9 kishte një, ekzistonte një komandant kryesor, po emri i tij
10 nuk ka qenë publik, apo jo?

11 DËSHMITARI: Jo. Jo, asnjëherë nuk e kam dit që ka. Po e
12 kam bërë pyetje edhe nuk është tha asnjëherë që është tha, të
13 paktën mu, nuk është thënë që është komandant. Kemi një
14 komandant. I kemi dy zëvendësues dhe ata s'është zgjedhë
15 komandanti.

16 Por këtë takim as nuk kam dhënë, as nuk e di kur ka
17 ndodhë, që pas shkrimit as nuk është një procesverbal i
18 mbajtur, që është mbajtur. Është një shkrim të cilin e ka --
19 s'po di kush e ka bërë Rexha ose kush.

20 Por unë, e para, s'më kujtohet ky takim dhe e dyta,
21 asnjëherë nuk është thënë që ka komandant të përgjithshëm dhe
22 është Azem Sylja.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Që t'i kundërpërgjigjem
24 Kryeprokurorit.

25 PY. Në faqen 55, rreshti 3, pasi ju pyeta unë ju:

1 "... a ju kujtohet të keni marrë pjesë në këtë mbledhje
2 rreth datës 6 shkurt 1999?"

3 Ju thatë:

4 "Nuk më kujtohet data e saktë, po e mbaj mend këtë
5 takim."

6 Kështu thatë?

7 PË. Unë e mbaj mend që kemi mbajtur takime. Nuk e di datën edhe
8 nuk e di a flitet ky shkrim për takimet që ne kemi pas.

9 PY. Ju e dini, pra, që është mbajtur një mbledhje ku kanë
10 marrë pjesë gjashtë persona, se i pamë shënimet dhe në këtë
11 grup keni qenë edhe ju personalisht, saktë?

12 PË. Sipas shkrimit këtu thuhet që kam qenë edhe unë, por nuk
13 më kujtohet ky takim që është mbajtur.

14 PY. Po ju bëj dhe njëherë pyetjen. Sepse unë e kuptova kështu
15 përgjigjen tuaj, kur ju pyeta unë dhe ju thashë kur ka dy
16 zëvendëskomandantë, ju e dini që ka pasur dhe një komandant
17 kryesor dhe unë përgjigjen tuaj e kuptova kështu, që ju thatë:
18 Po, e dinim që kishte një komandant kryesor, thjesht nuk e di
19 emrin e këtij komandant kryesor?

20 PË. Jo, jo. Unë thashë që e di që kanë qenë dy
21 zëvendëskomandantë dhe nuk e kam ditur që ka komandant të
22 përgjithshëm. Unë Azem Sylën e kam njoftuar si person, e kam
23 ndëgjuar si personin Daja, po gjithmonë kam menduar që ka qenë në
24 logjistikë.

25 PY. Mirë. Na e shpjegoni pak nga pikëpamja organizative si

1 mundet që një organizatë të ketë dy zëvendëskomandantë dhe
2 këta dy zëvendëskomandantë nuk janë në varësinë e një
3 komandanti? Kërkoj zëvendësojnë këta, si ka kjo kuptim nga
4 pikëpamja organizative?

5 PË. Nga pikëpamja organizative ka shumë pa kuptime edhe vetë
6 organizimi i Shtabit të Përgjithshëm, për arsye se s'janë dit
7 shumë funksione dhe cilat detyra i kanë. Edhe në këtë aspekt
8 edhe Jakup Krasniqi edhe Sokol Bashota dihet që kanë qenë dy
9 zëvendëskomandanta po asnjëherë asnjë urdhnesë, asnjë detyrë,
10 asnjë prej komandantit në këtë kohë nuk ka pas. Edhe nuk është
11 dit kush është, për sa i përket unë si komandant i zonës së
12 Drenicës.

13 PY. Meqë e kemi ende faqen këtu, ky Syla ka thënë që:

14 "Duhet të na konsultojnë dhe ne për emërimet në Shtabin e
15 Përgjithshëm."

16 Tani ju besoni se duhej të konsultohesh Shtabi i
17 Përgjithshëm për emërimet me komandantët e zonave?

18 PË. Po, mendoj se është dashtë me u konsultu. Por ky Syla që
19 thotë, në qoftë se mendon që është thirr në emër tem, atëherë
20 unë mendoj u është dashtë me u konsultu që për një organizim
21 më të mirë dhe më të suksesshëm.

22 PY. Pse mendoni ju që duhet të konsultoheshin edhe
23 komandantët e zonave emërimet në Shtabin e Përgjithshëm?

24 PË. Sepse të gjithë komandantët e zonave kanë pas përgjegjësi
25 në terren.

1 PY. Çfarë relevance kishte kjo me personat që do të
2 emëroheshin në Shtabin e Përgjithshëm, pse ishte kjo e
3 rëndësishme për personat që do emëroheshin pranë Shtabit të
4 Përgjithshëm?

5 PË. Mendoj që ka qenë e rëndësishme për zhvillimin dhe
6 organizimin e mëtutjeshëm të vet strukturës së Ushtrisë
7 Çlirimtare të Kosovës dhe Shtabit të Përgjithshëm në veçanti.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër. Më falni,
9 shohim faqen 37.

10 PY. Këtu sipas tekstit ka folur Sami, Samia. A ju kujtohet që
11 të ketë qenë dhe Sami Lushtaku i pranishëm në një mbledhje të
12 kësaj natyre?

13 PË. Nuk e di, në qoftë se unë jam kanë komandant i zonës,
14 atëherë pse dhe zëvendëskomandanti të merr pjesë. Po në qoftë
15 se ka qenë nuk e di. S'jam i saktë.

16 PY. Sipas shënimit, Samia ka thënë:

17 "Rexhep Selimi, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli janë
18 përgjegjës për këtë gjendje që jemi ne aktualisht."

19 Nga shënimet duket qartë Sami Lushtaku s'e kishte problem
20 ta kritikonte Rexhep Selimin, Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin,
21 saktë?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj, kush është
23 themelësia, është bërë pyetja, është marrë përgjigja.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

25 Mund t'i përgjigjeni, Dëshmitar, nëse e dini?

1 DËSHMITARI: Jo, nuk e di. Ky ka qenë një mendim i Samisë.

2 Z. MISETIC: [Përkthim]

3 PY. Po. Sipas shënimit, ai nuk e kishte problem ta kritikonte
4 Rexhep Selimin në praninë tuaj edhe pse ju keni lidhje gjaku
5 me Rexhep Selimin, ai s'e kishte problem këtë gjë, saktë?

6 PË. Edhe besoj që është mendimi i tij dhe pse ta kritikonte
7 dhe Rexhep Selimin edhe të tjerët, prapë nuk është ndonjë
8 problem të jep mendimin e vet. Secili ka mund të jap mendimin
9 për secilin.

10 PY. Po. Në fakt, Rexhep Selimi është dhe i pranishëm vetë në
11 këtë takim kur Sami Lushtaku po shpreh kritika ndaj tij vetë,
12 ndaj Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit, të paktën sipas
13 shënimeve, saktë?

14 PË. Sipas shënimeve është saktë.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani shohim faqen 39 në PDF.

16 PY. Nëse dëshironi mund të kalojmë dhe në një faqe më përpara
17 sa për t'ju treguar se kush ka qenë personi që po fliste. Të
18 paktën sipas asaj çfarë kemi të regjistruar këtu, personi që
19 flet është Sylja. Vazhdojmë tek faqja tjetër, Sylja thotë që:

20 "Pa u bërë emërimet e reja, unë nuk përgjigjem për asnjë
21 referim dhe as nuk do t'ju informoj për asgjë.

22 "Vetëm pasi të jenë bërë emërimet, unë do të kryej
23 detyrat që na caktohen nga Shtabi i Përgjithshëm dhe nuk do të
24 kontestoj asnjë urdhër."

25 Pra, sipas këtyre shënimeve, i takon që ju e besoni që

- 1 kishit të drejtë që të vendosnit ose të kishit autoritetin të
2 vendosnit në qoftë se do të realizonit detyrat e caktuara nga
3 Shtabi i Përgjithshëm apo në qoftë se do vendosnit t'i
4 refuzonit ato, a është e saktë kjo?
- 5 PË. Prapë është një shkrim të cilin as nuk e di kush e ka
6 shkrua. Por a kemi pas kundërthënie si komandant zone ose
7 vërejtje? Është e saktë që kemi pas. Gjithmonë në frymën e një
8 riorganizimit më të mirë dhe ne i kemi jep vërejtje, unë
9 personalisht, kam jep vërejtjet e mia ose edhe komandantët e
10 tjerë në zhvillimin e mëtutjeshëm të luftës.
- 11 PY. Dje Prokuroria ju bëri një pyetje:
- 12 "A i keni respektuar të gjitha urdhrat që ishin të
13 mundura që të respektoheshin?"
- 14 A ju kujtohet t'ua ketë bërë Prokurori dje këtë pyetje,
15 Dëshmitar?
- 16 PË. Po.
- 17 PY. A ju kujtohet ndonjë urdhër konkret që ju është dhënë?
- 18 PË. Jo, nuk më kujtohet.
- 19 PY. A ju kujtohet ndonjë person konkret me emër mbiemër, pra,
20 ndonjë person nga Shtabi i Përgjithshëm që ju ka dhënë juve
21 urdhra?
- 22 PË. Përveç Bislime Zyrapi asnjë person tjetër nuk ka, nuk më
23 kujtohet që ka lëshu urdhra.
- 24 PY. Në rregull. Bislime Zyrapi, sipas shënimeve, ka qenë i
25 pranishëm në këtë takim. A ju kujtohet që Bislime Zyrapi të

1 ketë qenë i pranishëm në një mbledhje të kësaj natyre?

2 PË. Kam pas me Bislím Zyrápin takime, po nuk, s'më kujtohet.

3 PY. Në rregull. Do t'ju bëj një pyetje, Dëshmitar. Ai është
4 personi i vetëm në Shtabin e Përgjithshëm që ju kujtoni që
5 t'ju ketë dhënë juve urdhra, por ju jeni në një takim ku ai
6 është i pranishëm, ndërkohë që ai diskuton - ose juve dhe
7 komandantë të tjerë të zonave - ju po diskutoni çështjen e
8 caktimit të komandantit të përgjithshëm. A e kuptoni deri
9 këtu, Dëshmitar?

10 PË. Po, e kuptoj.

11 PY. Në qoftë se ju kujtohet, a mund të na thoni çfarë roli ka
12 pasur Bislím Zyrápi në ato diskutime, e keni konsideruar si
13 koleg, si epror? Pse ishte aty në atë takim Bislím Zyrápi?

14 PË. Bislím Zyrápi ishte si përfaqësues i Shtabit të
15 Përgjithshëm, në qoftë se i aludohem kësaj ose takimeve ku ka
16 qenë kur unë i kam mbajtur, se ky takim nuk po më kujtohet. Në
17 takimet me Bislím Zyrápin ka qenë si shef i shtabit i Ushtrisë
18 Çlirimtare të Kosovës dhe në organizimin dhe mirëmbajtjen e
19 kurseve të ndryshme dhe kohës të cilës kemi qenë në luftime të
20 cilën ne disa herë e kemi diskutu me Bislím Zyrápin dhe disa
21 herë ka çu shkresa me emër të riorganizimit dhe formimit të
22 njësive të ndryshme.

23 PY. Po. Megjithatë dua që të përqendrohemi vetëm tek kjo
24 pikë: Ai është personi që ju ka dhënë urdhra nga Shtabi i
25 Përgjithshëm, megjithatë në këtë takim është shumë e qartë që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 73

1 ju, pra, komandantët e zonave do ishin personat që do
2 vendosnin se kush do ishte eprori i tij dhe pastaj rezultoi që
3 ky person të ishit ju, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

4 PË. Po.

5 PY. Në rregull. Tani do të kalojmë tek shënimet e një tjetër
6 takimi. Janë takime -- janë shënime të cilat ZPS-ja thotë që i
7 ka sekuestruar nga shtëpia e Rexhep Selimit, pra, bëhet fjalë
8 për një takim në Drenicë më datë 13 shkurt 1999.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares
10 të kalojmë tek prova 1D00033 në të dyja versionet në anglisht
11 dhe në shqip në faqen SPOE00226353.

12 PY. Këto shënime i keni parë gjatë seancës përgatitore, në
13 paragrafin 82 të Shënimit Përgatitor me ZPS-në ju keni thënë
14 që keni qenë i pranishëm në këtë takim më 17 shkurt 1999, a
15 është e saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Nuk e di datën prapë a është e saktë, po në cilin takim?
17 Nuk e di cilit takim i referohet. Është --

18 Z. HALLING: [Përkthim] Për të qenë i qartë ky është një
19 dokument të cilin dëshmitari nuk e ka parë gjatë seancës
20 përgatitore.

21 DËSHMITARI: Unë s'e kam pa këtë dokument, këtë shkrim, se
22 as dokument nuk është.

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Vetëkorrigjohem.

24 PY. Megjithatë, ka pasur një takim ku ju jeni përzgjedhur si
25 komandant i përgjithshëm, apo jo, Dëshmitar?

1 PË. Po, është e saktë.

2 PY. A ju kujtohet që ju jeni përzgjedhur, pak a shumë, rreth
3 datës 13 shkurt 1999 ose më 13 shkurt ose rreth kësaj date?

4 PË. Besoj që po. Besoj që është e saktë.

5 PY. Të shohim rendin e ditës të dokumentit që kemi përpara,
6 pika e parë tek rendi i ditës sipas këtyre shënimeve është:

7 "Qëndrimet rreh kërkesave të komandantëve të zonave për
8 emërimin e komandantit të UÇK-së."

9 E shikoni këtë pikën, Dëshmitar?

10 PË. Jo, jo, nuk ka dalë në ekran.

11 PY. Tek rendi i ditës pika një.

12 PË. Ah, okej. Po e shoh.

13 PY. A pajtohet kjo me atë çfarë ju kujtohet ju, domethënë, që
14 ka pasur një takim dhe pika 1 në rendin e ditës ka qenë
15 kërkesa e komandantëve të zonave për emërimin e komandantit të
16 përgjithshëm të UÇK-së?

17 PË. Nuk e di kush ka mbajtur procesverbal, por është diskutu
18 rreth, po di që e kem mbajtur takim dhe është diskutu në këtë
19 takim.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 6353.

21 PY. Sipas shënimeve, takimi fillon me një person që e merr
22 fjalën dhe thotë si më poshtë, pika 1, paragrafi i fundit,
23 pra ky person ju ka thënë juve që:

24 "Shërbimet sekrete të shumë vendeve si CIA, SHIK-u ... e
25 të tjerë dhe UDB-ja /Shërbimi Sekret Jugosllav/ janë në dijeni

1 sot për këtë takim, sonte për këtë takim ...”

2 Sipas këtyre shënimeve, folësi thotë që:

3 “Ka fjalë që qarkullojnë dhe interpretime se do ketë një
4 grusht kundër UÇK-së, do bëhet një puç në UÇK sot dhe këto
5 janë shumë shqetësuese për të gjithë ne.”

6 “Këto janë shqetësuese sidomos për qeverinë shqiptare
7 ...”

8 Pra, kjo supozohet që të jetë thënë në fillim fare të
9 kësaj mbledhjeje. Pra, kur ky folësi ka thënë që ka fjalë dhe
10 qarkullojnë, pra, thashetheme që do ketë një “puç” në UÇK, si
11 e keni kuptuar ju këtë që ka thënë folësi, për kë e ka pasur
12 fjalë ky folës? Domethënë, kur fliste që do të bëhet një “puç”
13 në UÇK për kë e ka pasur fjalën, a mund të na e shpjegoni?

14 PË. Asnjëherë nuk është parë, nuk po më kujtohet dhe nuk ka
15 pas kësi interpretimi me këtë takim ku unë kam marrë pjesë. E
16 para, nuk e di kush e ka shkru. E dyta është që asnjëherë s’më
17 kujtohet një gjë e tillë.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Sapo e pamë atë faqen që kishe të
19 bënte me rendin e ditës.

20 PY. Le të kalojmë shënimet këtu për të parë në qoftë se mund
21 të rifreskojmë kujtesën dëshmitarit.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 6358. Një faqe
23 më përpara nëse mundeni.

24 PY. Folësit këtu sipas këtij dokumenti janë Ramush Haradinaj
25 i pari, Ramushi në përgjigje të kësaj thotë, pra, sa i takon

1 qeverive të huaja që janë të shqetësuara për puçin ato thonë
2 që:

3 "Jemi ushtri dhe nuk jemi të shqetësuar, nuk na
4 interesojnë shqetësimet e qeverive të tjera, qoftë këtu edhe
5 shteti amë."

6 Ai thotë që:

7 "Këta janë manipulime dhe lojëra.

8 "Edhe UDB-ja e di që ne jemi të fortë.

9 "Delegacioni në Rambuje duhet të dijë që ata kanë besimin
10 tonë.

11 "UDB-ja ka qenë e kënaqur me zhvillimet siç janë
12 shpalosur ata.

13 "... dhe për mua komandanti është Sylejman Selimi."

14 A ju kujtohet që Ramush Haradinaj ta ketë marrë në fillim
15 fare të takimit fjalën dhe të ketë thënë që për të komandant i
16 përgjithshëm i UÇK-së ishit ju, Dëshmitar?

17 PË. Sa i përket tri shkrimeve janë të ndryshme. Edhe
18 procesverbalet edhe shkrimet siç kenë edhe më herët edhe tash.

19 Por unë ta shpjegoj komplet kronologjinë e takimit. Po, ka
20 qenë prezent Ramush Haradinaj dhe ai ka propozu që unë të jem
21 komandant, s'e di ai apo Samia, që të jem komandant i
22 përgjithshëm.

23 PY. Kalojmë tek faqja tjetër. Këtu shohim si më poshtë,
24 Shukri Buja merr fjalën dhe pastaj komandant Remi, të paktën
25 sipas shënimeve. Komandant Remi thotë:

1 "Shtabi i Përgjithshëm nuk i është kontestuar në tërësinë
2 e vet. Vetëm disa persona brenda tij janë kontestuar."

3 Fjalialia e fundit thotë:

4 "Për mua, prej sotit personi ose komandanti i zgjedhur
5 është ai."

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë tek faqja 6361.

7 PY. Këtu Fatmir Limaj thotë si më poshtë:

8 "Ne mund të biem dakord ose të kemi pajtueshmëri sa i
9 takon komandantit të radhës."

10 A e lexoni këtë në shënime, Dëshmitar?

11 PË. Po.

12 PY. Pra, komandanti i "radhës" nënkupton që Fatmir Limaj e di
13 se kush është komandanti aktual, apo jo?

14 PË. Sipas përshkrimit dhe mendimit tij, po.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër 6362,
16 drejt fundit të faqes.

17 PY. Këtu jepet një shënim nën titullin Sylja. Këtu thuhet që:

18 "Nuk mund të punoj me persona që janë në shtab
19 aktualisht."

20 Të paktën sipas shënimeve, a është e drejtë të thuhet që
21 ju nuk ishit i kënaqur me të paktën disa prej anëtarëve të
22 Shtabit të Përgjithshëm në këtë periudhë?

23 PË. Kam mujt me pas pakënaqësi ndaj shumë individëve, por nuk
24 më kujtohet një gjë e tillë që kam pas pakënaqësi në takimin
25 ne kur e kemi mbajtur.

1 PY. Në provën P02026, në faqen 56, ju thoni si më poshtë,
2 Dëshmitar, në transkript është biseda që keni pasur me TPNJ-në
3 në vitin 2003. Ju thoni:

4 "Më pas gjatë bisedave, bisedimeve ... në Rambuje, Azem
5 Sylja, që kishte qenë komandanti edhe ai ... ka qenë i
6 pranishëm atje ... kështu që ata vendosën ... që unë të
7 bëhesha komandant ... edhe megjithëse unë nuk doja që të
8 bëhesha komandant në fillim, megjithatë u vendosë që unë ta
9 merrja këtë post."

10 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

11 PË. Po, e saktë.

12 PY. Në këtë takim kanë qenë komandantët e zonave që ju
13 zgjodhën juve që të bëheshit komandant i përgjithshëm i UÇK-
14 së, a është e saktë kjo?

15 PË. E saktë.

16 PY. Një prej arsyeve sepse komandantët e zonave dëshironin që
17 t'ju emëronin ju si komandantin e përgjithshëm ishte që t'i
18 dërgonin një mesazh delegacionit shqiptar në Rambuje që ju,
19 domethënë, komandantët e zonave, ishit autoriteti fundor për
20 të vendosur në qoftë se UÇK-ja do çarmatoset e në qoftë se
21 UÇK-ja do pajtohej me një marrëveshje që do të përfshinte
22 pavarësinë e Kosovës, pra, donit t'i jepnit një sinjal, një
23 mesazh përmes kësaj, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

24 PË. Besoj që po.

25 PY. A ju kujtohet që në këtë periudhë, ndërkohë që ju u

1 emëruat komandant i përgjithshëm i UÇK-së, keni punuar me Adem
2 Demaçin për t'u siguruar që delegacioni shqiptar në Rambuje të
3 mos binte dakord për një marrëveshje pa marrë paraprakisht
4 autorizimin e komandantëve të zonave, a është e saktë kjo?

5 PË. Jo, nuk -- unë kontakte me Adem Demaçin i kemi pasur të
6 mëhershme. Dhe me draftin e parë kur është propozu ose kur
7 është na u ka dhënë ose në Rambuje, ka qenë një draft shumë jo
8 i përshtatshëm edhe ne e kemi bisedu këtë çështje.

9 PY. Por kjo nuk ishte e përshtatshme për Adem Demaçin dhe
10 komandantët e zonave, a është e saktë kjo?

11 PË. Mund të them që është e saktë.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua t'ju tregoj një dokument, për
13 procesverbal është 1D00049.

14 PY. Tani do ju paraqes në ekran një artikull gazete i datës
15 23 shkurt 1999, këtu diskutohet një takim që keni pasur ju dhe
16 Adem Demaçi në atë datë ose rreth asaj date. Do besoj që ju
17 kujtohet që z. Kurti ka qenë zëdhënësi i Adem Demaçit në atë
18 kohë dhe pas takimit tuaj me Adem Demaçin, ai ka dhënë një
19 konferencë për shtyp menjëherë duke bërë të ditur
20 informacionin që do keni përpara në ekran.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem zmadhoheni kolonën e parë
22 të artikullit.

23 PY. Albin Kurti thotë si më poshtë në konferencë për shtyp
24 lidhur me takimin që keni ju me Adem Demaçin. Fillon artikulli
25 si më poshtë:

1 “\Asnjë vendim politik nuk mund të merret pa pëlqimin dhe
2 aprovimin e përfaqësuesit të përgjithshëm politik të UÇK-së,
3 Adem Demaçi,’ tha sot Albin Kurti duke folur për rezultatet e
4 takimit të mbrëmshëm të Adem Demaçit me komandantin e
5 përgjithshëm të UÇK-së, Sylejman Selimi dhe me Shtabin e
6 Përgjithshëm të saj dhe tregoi se Demaçi ka marrë kompetencat
7 për udhëheqjen politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.”

8 “\Z. Adem Demaçi ka marrë leje prej tyre të gjitha
9 autorizimet dhe kompetencat të plota për udhëheqjen politike
10 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës’, theksoi ai.

11 “Albin Kurti në konferencën e sotme të shtypit tregoi se
12 Adem Demaçi sot ka udhëtuar urgjentisht për në Lubjanë për të
13 realizuar takime të rëndësishme me përfaqësues të nivelit më
14 të lartë të diplomacisë dhe të politikës ndërkombëtare.

15 Qëllimi i këtyre takimeve është gjetja e një zgjidhjeje të
16 mirëfilltë dhe të drejtë të çështjes së Kosovës konformë
17 parimeve bazë të UÇK-së dhe luftë së saj çlirimtare.

18 “\Pra, konformë vullnetit të popullit të Kosovës për
19 lirinë dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës’, nënvijëzoi
20 Kurti.

21 “\UÇK-ja nuk është krijuar dhe nuk ekziston për të shkuar
22 në Rambuje dhe për t’u çarmatosur atje. Kurrfarë çarmatimi apo
23 transformimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovë nuk merret
24 parasysh’, nënvijëzoi Kurti dhe shtoi se UÇK-ja është garanci
25 e sigurisë së popullit shqiptar në Kosovë dhe e fitores së tij

1 dhe se populli shqiptar në Kosovë nuk ndihet i sigurtë pa
2 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.'"

3 Së pari, a ju kujtohet që të keni pasur një mbledhje ose
4 një takim më 22 shkurt 1999 ose rreth kësaj date pak kohë pas
5 caktimit tuaj si komandant i përgjithshëm, a ju kujtohet ky
6 takim me --

7 PË. Jo.

8 PY. -- me z. Demaçi?

9 PË. Me z. Demaçi jemi taku disa herë por ky -- koha me kur
10 nuk e di saktë.

11 PY. A ju kujtohet të keni pasur një takim me z. Demaçi, sepse
12 thatë që kujtohen disa takime me të. Por a ju kujtohet një
13 takim specifik me z. Demaçi ku ju ose ku z. Demaçi më saktë ka
14 marrë kompetencën për lidërshtipin politik të UÇK-së?

15 PË. Për këtë kompetencë nuk e di, por unë kam bisedu disa
16 herë me z. Demaçi. Edhe për çështjen kam bisedu edhe
17 paraprakisht rreth Rambujesë. Edhe me telefon kur ka qenë në
18 Lubjanë, më duket, unë kam bisedu me z. Demaçi.

19 PY. Po. Në bisedat tuaja me z. Demaçi përsëri theksohet që
20 komandantët e zonave e kundërshtonin një marrëveshje që nuk
21 përfshinte pavarësinë e Kosovë, a është e saktë kjo?

22 PË. Kjo kështu shkruan, por nuk sa është e saktë.

23 PY. Ju keni konfirmuar që ky ka qenë qëndrimi i komandantëve
24 të zonës të paktën si fillim, apo jo, ku ju nuk donit që të
25 aprovohej një marrëveshje në Rambuje ku të përjashtohej

1 pavarësia e Kosovës, apo jo, Dëshmitar?

2 PË. Po, e saktë. Po nuk e di a ka qenë Demaçi. Nuk më
3 kujtohet që z. Demaçi ka qenë në takim me komandantët e
4 zonave. Kur sa i përket meje, unë kam pas disa herë takime me
5 z. Demaçi. Edhe ai ka qenë kundër nënshkrimit të Rambujesë, do
6 të thotë, të draftit të parë.

7 PY. A e dini arsyen pse e ka kundërshtuar ai nënshkrimin e
8 draftit të parë të marrëveshjes?

9 PË. Nuk e di arsyen. Arsyja ka qenë që me draft që forcat
10 serbe nuk do të largohen nga territori, që UÇK-ja të
11 çarmatoset. Unë sa e kam parë një draft propozim ose nuk e di
12 sa. Ky ka qenë që vetëm UÇK-ja të dorëzojë armët dhe forcat
13 serbe të qëndrojnë prapë në Kosovë.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares tani të
15 paraqesë në ekran provën P645, duke filluar në faqen 671, jo,
16 672.

17 PY. Atëherë këto janë shënime të një takimi që mendohet të
18 ketë ndodhur më datë 26 shkurt 1999 në Shtabin e Përgjithshëm
19 në Divjakë. Ju kujtohet juve nëse keni qenë i pranishëm në një
20 takim të tillë në Shtabin e Përgjithshëm, Dëshmitar?

21 PË. S'e di. Nuk më kujtohet.

22 PY. A ju kujtohet ndonjëherë të keni qenë i pranishëm në
23 ndonjë takim në Divjakë kur është bërë vlerësimi i konferencës
24 së Rambujesë? Si dhe ku është diskutuar për formimin e
25 Qeverisë së Përkohshme të Kosovës?

1 PË. Besoj që po.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë tek faqja tjetër.

3 PY. Sipas këtij dokumenti, personi i parë që ka marrë fjalën
4 është Rexha. A mund të na thoni sipas mendimit tuaj kush mund
5 të ketë qenë ky Rexha?

6 PË. Rexha është Rexhep Selimi besoj.

7 PY. Në rregull. Të kalojmë tek komentet që ka bërë Sokol
8 Bashota. Në këtë takim ai thotë që:

9 "Uroj e dëshiroj që ky puç të mos jetë planifikuar nga
10 UDB-ja ... Burimet, informacionet që kemi neve janë ogurzeza."

11 A ju kujtohet që të keni qenë i pranishëm në një takim ku
12 Sokol Bashota ka thënë që është shprehur që kishte një puç
13 edhe shpresonte që ky puç të mos ishte bërë nga UDB-ja?

14 PË. Në takim kur kam qenë unë, këtë shprehje ose këtë mendim
15 nuk e kam dëgju asnjëherë edhe nuk e di a ka qenë Sokol
16 Bashota kur unë kam marrë pjesë.

17 PY. Në rregull.

18 PË. Ndoshta është një takim tjetër. Ose është përshkru
19 ndryshe.

20 PY. Do ju bëj një pyetje lidhur me një temë tjetër,
21 Dëshmitar. Komandant Drini pse u zëvendësua si komandant i
22 zonës së Pashtrikut?

23 PË. Nuk e di. Besoj që është avancu në Shtabin e Përgjithshëm
24 për detyra mëtutjeshme.

25 PY. Në atë kohë që është promovuar, është ngritur në detyrë

1 ai, ju keni qenë komandant i përgjithshëm i UÇK-së, apo jo,
2 Dëshmitar?

3 PË. Besoj që po. Kujtoj në një takim kur unë e kam mbajtur ka
4 qenë Bislir Zyrapi, Fatmir Limaj si anëtarë të Shtabit të
5 Përgjithshëm, Rexhep Selimi edhe ka qenë komandant Drini edhe
6 disa të tjerë. Nuk e di, s'më kujtohen.

7 PY. A do keni qenë ju personi që do këtë nënshkruar
8 promovimin e tij, rritjen e tij në detyrë, Dëshmitar?

9 PË. Nuk e di. Besoj që po, por nuk jam i sigurtë, a kam marrë
10 një vendim të tillë dhe me nënshkruar s'e kam. Se vetëm e kam
11 mbajtur takimin edhe jam kthyer prapë në Drenicë. Nuk e di a ka
12 qenë e mundur apo është e nënshkrime.

13 PY. A ju kujtohet në qoftë se komandant Drini ka votuar për
14 ju për t'u bërë komandant i përgjithshëm apo ka qenë kundër
15 emërimit tuaj si komandant i përgjithshëm? A ka votuar për
16 dikënd tjetër, për juve, ju kujtohet ndonjë gjë lidhur me
17 këtë, Dëshmitar?

18 PË. Nuk më kujtohet. Po e di se në fund të gjithë kanë qenë
19 për. Ka pas diskutime për ndoshta dhe për emra të tjerë, po të
20 gjithë kanë qenë për në fund të takimit.

21 PY. Kur thoni "ky takim" e keni fjalën për takimin e 13
22 shkurtit?

23 PË. E kam fjalën kur jam zgjedhur komandant i përgjithshëm i
24 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

25 Z. MISETIÇ: [Përkthim] Z. Gjykatës, do kalojmë në një

1 temë të re, kështu që mendoj që është momenti i përshtatshëm
2 për të bërë pushimin e drekës.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
4 pushimin e drekës tani, Dëshmitar. Pushimi është nga ora 1.00
5 deri në orën 2.30. Do kthehemi përsëri në 2.30. Faleminderit.
6 Tani mund të largoheni nga salla.

7 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Do përfundoj sot pas pushimit të
9 drekës për arsye planifikimi sa për ta ditur, i nderuar
10 Gjykatës. Do përfundoj sot.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

13 --- Seanca rifillon në orën 14.30

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Sa i takon intervistës së z. Çeku,
15 dakord jemi që të pranohet e gjithë intervista si provë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ja, një çast.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund t'jua jap unë numrin, sepse e
18 kam gati.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti në
20 tërësinë e vet do zëvendësojë dokumentin e pjesshëm.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Është pranuar një pjesë, dhe
22 ka marrë numrin 1D00243. Unë kërkoj tani të pranohet dokumenti
23 në tërësinë e vet, që ka numrin DHT04009, DHT04017, dhe në
24 shqip është SPOE0053060 deri në 0053071.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 86

1 Pranohet dokumenti në tërësinë e vet, dhe do t'i japim numrin
2 përkatës.

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Numri i kërkuar do të
4 marrë numrin e provës 1D243.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
6 dëshmitarin në sallë.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita, z.
9 Selimi. Do vazhdoj me pyetjet nga Mbrojtja e z. Thaçi.

10 Z. Misetiç, fjala është për ju.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Mirëdita, z. Selimi.

13 PË. Mirëdita.

14 PY. Tani dua të flasim për një temë të re. Kur u bëtë
15 komandanti i përgjithshëm i UÇK-së, çfarë marrëdhënieje kishit
16 ju me shefin e gjykatës ushtarake, z. Sokol Bashota --
17 Dobruna, më falni -- z. Sokol Dobruna?

18 PË. Z. Dobruna as që e kam njoft.

19 PY. Pra, unë po ju them që kemi një dokument që është pranuar
20 si provë gjyqësore që ka numër P01175, ky është një vendim i
21 19 nëntorit 1998, ku emërohet z. Dobruna të jetë shefi i
22 shërbimeve juridike në kabinetin e komandantit të Shtabit të
23 Përgjithshëm të UÇK-së.

24 Po thoni ju në dëshminë tuaj që pasi u bëtë komandanti i
25 përgjithshëm i UÇK-së nuk e keni takuar asnjëherë z. Dobruna?

- 1 PË. Nuk më kujtohet që e kam taku asnjëherë z. Dobruna.
- 2 PY. A e keni ditur ju në atë kohë se ka ekzistuar një gjykatë
3 ushtarake e UÇK-së?
- 4 PË. Ka qenë një komunikatë e Shtabit të Përgjithshëm, sa më
5 kujtohet mu, që ka fol diçka të tillë.
- 6 PY. A e dinit ju, ose edhe pse nuk e keni takuar ndonjëherë,
7 a e dinit ju kush e drejtonte këtë gjykatë ushtarake?
- 8 PË. Jo, nuk e, nuk e dija. E dija që emrin, domethënë, emrin
9 e, si thatë ma herët, por nuk e kam taku asnjëherë.
- 10 PY. Në rregull. Do vazhdoj pak më tej bazuar në përgjigjen
11 tuaj. Thatë që e kishit dëgjuar emrin e tij, Sokol Dobrunës?
- 12 PË. Po. Kjo përmes komunikatës së Shtabit të Përgjithshëm.
- 13 PY. Pra, ju e dinit që ekzistonte një person me emrin Sokol
14 Dobruna që drejtonte gjykatën ushtarake, saktë?
- 15 PË. Po, kisha dëgju për këtë.
- 16 PY. A e dinit ju si komandant i përgjithshëm i UÇK-së, kujt i
17 raportonte z. Dobruna?
- 18 PË. Unë në këtë periudhë as nuk jam merre, domethënë, unë
19 prapë kam qëndru në Drenicë edhe nuk i kam kry ato detyrat e
20 komandantit të Shtabit të Përgjithshëm, domethënë, në Berishë,
21 por prapë kam qëndru në Drenicë dhe nuk jam merrë me çështjet
22 organizative të Shtabit të Përgjithshëm.
- 23 PY. Nga momenti që u emëruat ju komandant i përgjithshëm, me
24 për afërsi 13 shkurt 1999, e deri kur u larguat, pra, që kur
25 emëruat e deri kur u larguar, ju jeni larguar dikund nga

1 fillimi i prillit 1999, saktë?

2 PË. Pas Rambujesë, domethënë, mbasi kanë ardh delegacioni
3 prej Rambuje, dhe jemi taku me të.

4 PY. Pra, po flasim për fundin e marsit?

5 PË. Flasim --

6 PY. Ose më saktë, kur nuk ishit më, në ç'moment ndaluar si
7 komandant i përgjithshëm, u tërhoqët si komandant i
8 përgjithshëm?

9 PË. Nuk e di datën saktë, por kur është kthy prej Rambujeje
10 delegacioni i Rambujesë. Aty është kanë diku fillimi i
11 bombardimeve, dita e dytë, a dita e parë, nuk e di, ose e
12 treta. Domethënë, më 24 mars kanë fillu bombardimet, atëherë i
13 bi si me thanë mbas 2-3 ditëve, apo mbas nji dite.

14 PY. Pra, në këtë periudhë kohore, që nga 13 shkurti e deri në
15 fillim të bombardimeve të NATO-s, fizikisht ku ishit ju, ku
16 qëndronit?

17 PË. Në Drenicë, konkretisht në Abri.

18 PY. Ju në këtë periudhë gjashtëjavore nuk e dinit kush e
19 mbikëqyrte punën e gjykatës ushtarake, saktë?

20 PË. Jo.

21 PY. Flasim për emërimin tuaj në gardën kombëtare. Hetuesve u
22 keni thënë që jeni emëruar komandant i gardës kombëtare me
23 vendim të qeverisë së përkohshme të Kosovës, saktë?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. I keni thënë ZPS-së javën e kaluar -- një çast, ju lutem.

1 Ta korrigjoj këtë që thashë. A keni marrë ndonjëherë vendim me
2 shkrim ku emëroheshit ju si drejtues, apo komandant i gardës
3 kombëtare?

4 PË. Jo. Jo.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim në ekran, atëherë, provën
6 P113.

7 PY. Atëherë, nga e mësuat ju që ishit emëruar në këtë pozitë?

8 PË. Unë kam qenë në Berishë duke u kthyer për Drenicë, edhe
9 është, përmes është dalë, domethënë, dhe emri im dhe i Agim
10 Çekut në atë kohë përmes mediave, konkretisht televizionit të
11 Shqipërisë në atë kohë.

12 PY. Mendoj se është faqja e saktë.

13 Gjatë seancën përgatitore, a ua tregoi Prokuroria këtë
14 dokument?

15 PË. Jo.

16 PY. A ju kujtohet që patë pjesën, e patë pjesën e biografisë
17 së Sylejman Selimit dhe ju pyeti Prokurori nëse ishte e saktë
18 biografia, ju kujtohet?

19 PË. Po, biografia e saktë ka qenë.

20 PY. Mbi biografinë, është një paragraf tjetër. Paragrafin që
21 është mbi pjesën e biografisë, a e kishit parë ndonjëherë më
22 përpara?

23 PË. Jo.

24 PY. Në seancën përgatitore me Prokurorinë javën e kaluar, në
25 paragrafin 91 të Shënimit Përgatitor numër 2, ju keni thënë

1 sipas këtij paragrafi, se asnjëherë nuk i keni raportuar
2 qeverisë së përkohshme gjatë kohës që keni qenë komandant i
3 përgjithshëm. A është kjo e saktë?

4 PË. Po, e saktë.

5 PY. A keni marrë ndonjëherë ju urdhër prej z. Thaçi?

6 PË. Unë s'më kujtohet asnjëherë që kam marrë urdhër prej z.
7 Thaçi.

8 PY. Tani po flasim për periudhën kohore mars 1998, shtator
9 1999. Në këtë periudhë, a keni marrë ndonjëherë ju urdhër prej
10 z. Thaçi?

11 PË. Jo, asnjëherë.

12 PY. Garda kombëtare, kjo gardë kombëtare.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Fillimisht më lejoni të tregoj
14 provën 2028. Anglishtja është faqja 3, dhe shqipja është faqja
15 7 në të njëjtën PDF.

16 PY. Kjo është intervista që i keni dhënë Speciales së Kosovës
17 në 2011. Duhet të shohim pikën 14, përgjigjen tek pyetja 14.
18 Paragrafi i dytë, ju keni thënë, në përgjigjen tuaj:

19 "Çeku u emërua shef shtabi dhe unë u emërova komandant i
20 gardës kombëtare, që ishte një pjesë elitë në Ushtrinë e
21 qeverisë së përkohshme, që kishte për detyrë që të shfaqej në
22 ceremoni, në festime, edhe kështu me radhë. Po për shkak të
23 periudhës së shkurtër kohore, nuk arritëm ta krijonim këtë
24 njësi apo sektor, apo këtë organizatë."

25 A është e vërtetë që në këtë kohë të shkurtër ju nuk

1 arritët ta krijonit gardën kombëtare?

2 PË. Po, është e vërtetë.

3 PY. Në Shënimin Përgatitor numër 2, në paragrafin 20, ju keni
4 thënë diçka të ngjashme në të njëjtën linjë, por nuk është
5 përfshirë fjalia e fundit. Ju keni thënë:

6 "Nga qershori deri në shtator 1999, garda kombëtare
7 kishte vetëm rol ceremonial. Merrej vetëm me ceremoni ose
8 shoqëronte personalitetet e larta."

9 Por këtu është hequr kjo fjalia që është tek 2011, pra në
10 2011 ju keni thënë që:

11 "Nuk mundëm ta krijonim për shkak të periudhës, në këtë
12 periudhë kaq të shkurtër."

13 A mos ka qenë e nënkuptuar kjo në paragrafin 20?

14 PË. Unë e kam, garda nuk ka mujt, nuk ka pas mundësi se gjatë
15 luftës të formohet për arsye se përfundoi lufta. Dhe pas
16 luftës në këtë aspekt e kam thanë, e kemi fillu të
17 riorganizojmë dhe të merremi me detyra të cilat janë
18 përcaktume këtu.

19 PY. Po, por pyetja ime është kjo, në 2011 ju keni thënë që
20 nuk mund ta krijonit këtë organizatë. Tani pyetja ime është, a
21 u themelua dhe bënte vetëm detyra, kryente vetëm detyra
22 ceremoniale, apo nuk u krijua asnjëherë, u krijua thjesht një
23 gjë e pjesshme që kryente disa detyra ceremoniale?

24 PË. Jo, kjo, ka qenë në transformim e sipër vetë UÇK-ja edhe
25 ne është, ne jemi marrë me transformimin e UÇK-së. Në atë kohë

1 ish in edhe bisedimet me komandantin e KFOR-it -- Gjeneralin
2 Jackson edhe me admiralin, me Gjeneralin Wesley Clark. Edhe
3 kjo njësi ende është kanë e paformume. Se krejt ideja është
4 kanë se si, çfarë roli të ketë vetë UÇK-ja dhe në kuadër të
5 sajna garda, çfarë roli do të ketë pas transformimit.
6 PY. Po, që ta sqarojmë. Mbase nuk u kuptuam nga përkthimi. Do
7 ta përsëris dhe një herë pyetjen.

8 Si duhet ta kuptojmë ne dëshminë tuaj, pra? Që garda
9 kombëtare do ta kishte dhe rolin ceremonial të përfshirë, por
10 që nuk u krijua asnjëherë, apo që garda kombëtare u krijua dhe
11 garda kombëtare kishte vetëm rol ceremonial? Pra, u krijua dhe
12 duhet të kishte vetëm rol ceremonial, apo s'u krijua
13 asnjëherë?

14 PË. Pas lufte, asnjëherë nuk i ka marrë kompetencat, ka qenë
15 në formim e sipër dhe mund ta kuptojmë që po, ka, si gardë,
16 unë me disa pjesëtarë kemi, kam fillu ta bëj strukturën, këtë
17 organizimin, mirëpo nuk ka qenë e kompletume për arsyen, nuk e
18 kemi dit çfarë është, çka do të jetë, çfarë strukture do të
19 jetë vetë transformimi. Në kuadër, krejt strukturës ku do të
20 gjindet garda kombëtare.

21 Edhe këtu janë specifiku disa detyra të cilat mund t'i
22 kryejë garda kombëtare, garda e Kosovës. Nuk ka qenë e
23 formume, nuk ka qenë e kompletume. Domethënë, ka qenë një
24 pjesë deri në transformim. Ma shumë jemi merrë me -- detyrat e
25 ceremonisë, ose të personaliteteve.

1 PY. Pra, detyrat ceremoniale a janë ushtru gjatë luftës apo
2 pas luftës?

3 PË. Pas luftës. Gjatë luftës as që është formu.

4 PY. Në rregull.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Që ta sqarojmë, ju lutem me
6 dëshmitarin, "pas luftës", për cilën periudhë bëhet fjalë në
7 këtë kontekst?

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Dëshmitar, "pas luftës", kur?

10 PË. Mbasi kanë hy forcat e NATO-s.

11 PY. Pra, rreth 12 qershorit?

12 PË. Pas 12 qershorit.

13 PY. Unë do ju bëj një pyetje tjetër.

14 Fillimisht, kur jeni larguar nga Kosova për të shkuar në
15 Shqipëri?

16 PË. Herën e parë ka qenë në vitin 1997 me, kam udhëtu bashkë
17 me disa të tjerë. Herën e dytë, pak para se përfundimi i
18 luftës, domethënë, si unë si komandant garde, mbasi jam emëru,
19 e kemi dizajnu, do të thotë, këtë emblemen çfarë do të duket,
20 bashkë me këta oficerë të operatives kanë qenë, dhe mendoj
21 dikund dy javë para përfundimit, domethënë, para kam udhëtu
22 bashkë me një grup për me shku për me u pajis me uniforma dhe
23 me armatim përkatës për gardën e Kosovës.

24 PY. Pra, i takon që herën e dytë jeni larguar diku nga prilli
25 i 1999, apo jo?

1 PË. Mbasi jam emëru komandant garde, domethënë, mbasi Agim
2 Çeku është emëru shef i shtabit, nuk e di periudhën, dikund
3 dyjavore. Dy ose trijavore, nuk e di saktë. Por e di që
4 përfundimi, domethënë, i luftës më ka nxanë në Shqipëri dhe të
5 nesërmen kam ardh këndej.

6 PY. Pra, u kthyet rreth datës 11 ose 12 qershor?

7 PË. Me sa më kujtohet, 12 qershor ose 13 qershor, nuk e di.
8 Ose 14, dikund me përafërsisht.

9 PY. Tani, do t'ju bëj disa pyetje për situatën ku u gjendët
10 ju në qershor të 1999.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këtë do doja që të vendosej në
12 ekran materiali SITF00016024 deri në SITF00016042 në faqen --
13 [Mikrofoni çaktivizuar].

14 PY. Ky është një dokument nga prokuroria e Republikës së
15 Shqipërisë. Data 28 korrik 1999. Shikoni, ju lutem, paragrafin
16 poshtë ku thotë, ku thotë "Konstatova", thotë:

17 "Më 3 qershor 1999 rreth orës 14.00 në rrugën Tiranë-Dajt
18 në një kthesë prej 300 metra mbi Hotel Linza, mjeti me targë
19 GH0126, që drejtohej nga shtetasi kosovar Sylejman Idrizi,
20 duke qarkulluar në drejtimin Dajt-Tiranë ka dalë jashtë rrugës
21 ku si pasojë e së cilës janë dëmtuar të tre personat që
22 ndodheshin në këtë mjet.

23 Shkojmë në poshtë. Thotë:

24 "Në bazë të aktekspertimit mjekoligjor ka rezultuar se
25 tek i dëmtuari Sylejman Selimi hyn në dëmtime në kategorinë e

1 tyre që kanë shkaktuar mbi 9 ditë paaftësi të përkohshme. Se
2 këto dëmtime janë shkaktuar me mjet të fortë prerës.
3 Gjithashtu në bazë të aktekspertimit mjekoligjor dëmtimet e
4 Zabit Gercit", thotë këtu, duhet të kishte qenë mbase Sabit
5 Geci, "dëmtimet e marra hyjnë në kategorinë e atyre si të
6 rënda dhe të rrezikshme në çastin e shkaktimit të dëmit."

7 A ju kujtohet që më 3 qershor të keni qenë i përfshirë në
8 një aksident rrugor në Shqipëri dhe jeni lënduar rëndë për
9 shkak të këtij aksidenti?

10 PË. Po, e di që porsa kam shku në Tiranë, të nesërmen kam
11 taku Adem Grabovcin e kam taku edhe disa të tjerë, edhe më
12 kanë thanë që disa mjete duhet, kam kërku, domethënë, edhe
13 rreth emblemës edhe rreth përgatitjes dhe disa uniforma, t'i
14 marr për gardën. Është fjala për gardën. Kanë thanë që, "Disa
15 armë duhet me shku me i marrë në Dajt". As e kam dit se ku
16 është Dajti, as ku. Edhe ma kanë dhanë me vete një makinë, unë
17 kam qenë bashkë me Ferit Berishën, edhe ma kanë dhënë me vete
18 edhe Sabit Gecin për me tregu ku është ky destinim, ku është
19 ky vend. Dhe si pasojë e sajna kah kthehemi kemi pas aksident
20 edhe ky ka qenë një aksident shumë i dyshimtë për arsye se m'u
21 kanë, m'u ka dëmtu makina dhe kemi pas një aksident.

22 PY. A është e vërtetë, është e saktë që keni qenë për 9 ditë
23 me paaftësi të përkohshme që prej 3 qershorit 1999?

24 PË. Jo. Nuk është, unë, po atë ditë që kam shku, më kanë çu
25 në spital, prej spitalit kam ndejt një ditë, në të dytën ditë

1 unë kam, jam largu prej spitalit.

2 PY. Kam një pyetje për Sabit Gecin. Sabit Geci, a
3 konsiderohej si pjesë e grupit të Prekazit?

4 PË. Jo. Sabit Geci në fillimet e tijna nuk konsiderohej si i
5 grupit të Prekazit. Grupi i Prekazit është grupi i Prekazit,
6 kurse anëtarët e tjerë të rretheve të tjera mund të kenë qenë
7 mbështetës, por grupi i Prekazit ka qenë grupi i Prekazit, ata
8 që i thashë.

9 PY. Me sa dini ju, Sabit Geci ka punuar me Adem Jasharin?

10 PË. Besoj që po.

11 PY. A e dini ju mbase për shkak të lidhjeve që kishte Sabit
12 Geci me Adem Jasharin, kishte një pozicion më të favorizuar në
13 UÇK apo një lloj prestigji në UÇK?

14 PË. Ka mundësi, por nuk e di.

15 PY. Folët për shndërrimin e gardës kombëtare. Garda kombëtare
16 nuk është përfshirë dhe as nuk gjendet e renditur si një nga
17 organizatat që do të shndërrohej, saktë? Subjekt që do të
18 shndërrohej, saktë?

19 PË. Po, është e saktë.

20 PY. Sidoqoftë, ju u emëruat si i dyti në drejtim, keni qenë i
21 dyti, domethënë, drejtuesi i dytë i Trupave të Mbrojtjes së
22 Kosovës, apo jo? TMK-së?

23 PË. Po, kam qenë zëvendëskomandant i Trupave Mbrojtëse të
24 Kosovës, deri në transformimin të UÇK-së në TMK.

25 PY. Keni qenë zëvendëskomandant edhe më pas, apo jo?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetić

Faqe 97

1 PË. Kam qenë zëvendëskomandant derisa është -- unë jam emëru
2 komandant i Trupave Mbrojtëse të Kosovës derisa është bo
3 transformimi i Trupave të Mbrojtjes së Kosovës në forcën e
4 Sigurisë së Kosovës. Agim Çeku ka qenë komandant, unë kam qenë
5 zëvendëskomandant i Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Me shkuarjen
6 e tij në qeveri unë kam kalu si komandant i Trupave dhe mbas
7 transformimit të TMK-së në FSK kam qenë komandant i parë i
8 Forcës së Sigurisë së Kosovës, me gradën gjeneral-lietnant.
9 PY. Në provën P02026 në faqen 76 [Sipas përkthimit] -- 57 të
10 PDF-së, është diçka që keni thënë në deklaratën tuaj, se të
11 paktën për anglishten është pak e paqartë, por mbase është e
12 qartë shqipja. Ju është bërë pyetje:

13 "... si e keni marrë pozicionin ju si zëvendëskomandant i
14 TMK-së?

15 Ju keni thënë:

16 "... kjo ndodhi ... kur u bë Çeku ... komandant dhe u
17 bëra zëvendëskomandant dhe kjo është vendosur në këshill kur
18 po kryheshin, kur po kryhej shndërrimi me miratimin e tij ...
19 me miratimin e grupit, dhe komandantëve të KFOR-it."

20 Me sa di unë, në shqip është ndryshe, thotë që emërimi
21 juaj si zëvendëskomandant është vendosur bazuar në konsultimet
22 në atë kohë kur ishte administrata Kouchner, pra ka qenë
23 vendimi i tij dhe ka qenë një konsultim i brendshëm mes
24 komandës së KFOR-it, dhe brenda KFOR-it është bërë konsultimi,
25 dhe më pas jeni emëruar ju si zëvendëskomandant. A është kjo e

1 saktë?

2 PË. Kjo është e saktë. Domethënë, unë kur u emërova atëherë
3 ka qenë UNMIK-u dhe unë jam emëru edhe unë edhe z. Çeku nga
4 administrata e cila ka qenë atëherë, UNMIK-u.

5 PY. Qeveria e përkohshme e Kosovës nuk kishte ndonjë rol apo
6 jo, nuk kishte, nuk kishte peshë sa i takon emërimit tuaj si
7 zëvendëskomandant, apo jo?

8 PË. Jo, jo.

9 PY. Tani të kalojmë një temë tjetër. Në paragrafin 93 të
10 Shënimit Përgatitor numër 2, ju thoni që ka pasur raste kur
11 urdhrat janë lëshuar në emrin tuaj, por nga një person tjetër.
12 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po, e saktë.

14 PY. Gjithashtu, në Shënimin Përgatitor numër 2, në paragrafin
15 15, ju thoni, dhe do jua lexoj të plotë. Ju thoni:

16 "Përpara formimit të brigadave, kishte probleme në
17 punktet e kontrollit ku njerëzit i drejtoheshin vetes me
18 nofka, dhe kishte vagullësi sa i takon faktit që ato duheshin
19 arrestuar apo jo. Ju kujtohet që ka pasur një diskutim të
20 tillë ndërmjet komandantëve lidhur me këta tre persona",
21 përkatësisht Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi,
22 "megjithatë, ky ishte një problem që u zgjodh brenda ditëve
23 dhe nuk kishte asnjë nevojë që të lëshohej një urdhër për
24 arrestim, për të zbardhur këtë problem."

25 A ju kujtohet që t'ia keni thënë Prokurorisë këtë para

1 një jave, Dëshmitar?

2 PË. Po, e saktë.

3 PY. Më korrigjoni në qoftë se e kam kuptuar gabim, por mënyra
4 se si e lexoj unë këtë paragraf, është që juve ju kujtohet që
5 ka pasur një bisedë midis komandantëve të zonës së Drenicës
6 lidhur me arrestimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep
7 Selimit, por ky ishte një problem që u zgjidh për disa ditë
8 edhe si rezultat nuk u lëshua një urdhër për arrestimin e
9 tyre. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

10 PË. Ka pas një diskutim brendapërbrenda, domethënë me
11 komandantët e pikave, ose të brigadës në atë kohë, rreth mos,
12 disa, për disa çështje dhe më kujtohet që na kemi debatuar dhe
13 kemi, por nuk më kujtohet që ka pas një urdhër-arrest ndaj
14 tij. Ndaj tyre.

15 PY. Dua që ta diskutojmë pak në më tepër hollësi këtë takim,
16 dhe do ju kërkoj ju që të konfirmoni emrat e personave që
17 sipas jush ishin të pranishëm në këtë takim. Ju vetë,
18 personalisht, keni qenë i pranishëm, Dëshmitar?

19 PË. Besoj që po. Unë kam qenë por edhe kanë qenë edhe të
20 tjerët, domethënë.

21 PY. Po Fehmi Lladrovci?

22 PË. Nuk jam i sigurt.

23 PY. Sami Lushtaku?

24 PË. Besoj që po.

25 PY. Fadil Kodra?

- 1 PË. Besoj që po.
- 2 PY. Iliaz Kodra?
- 3 PË. Besoj që po, nuk e di. S'jam i sigurt. Por në takim kanë
4 enë të gjithë --
- 5 PY. Zene Trokshi [Sipas përkthimit]?
- 6 PË. Nuk e di, nuk besoj.
- 7 PY. Rasim Kiqina?
- 8 PË. Nuk e -- faktikisht nuk e di a ka qenë. Por nuk besoj që
9 ka qenë Rasimi.
- 10 PY. Jahir Demaku?
- 11 PË. Jahiri ka mundësi ka qenë, për arsye se ka qenë në,
12 përgjegjës i pikës ose i brigadës në këtë kohë.
- 13 PY. Abedin Rexha, Sandokani?
- 14 PË. Po, besoj që ka qenë.
- 15 PY. Xhavit Nuraku?
- 16 PË. Nuk e di.
- 17 PY. Dhe Gani Thaçi?
- 18 PË. Edhe Ganiu ka qenë.
- 19 PY. Me sa kuptoj unë, akuzat që ngriheshin ndaj Hashim
20 Thaçit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit ishin që ata nuk i
21 kishin dhënë armët Adem Jasharit, por në fakt ia kishin dhënë
22 të tjerëve dhe kjo pretendohet se kishte çuar në vdekjen e
23 Adem Jashari. Domethënë, pak a shumë ky ka qenë diskutimi, apo
24 jo?
- 25 PË. Jo, s'është e vërtetë. Diskutimi ka qenë për ndalimin e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 101

1 pjesëtarëve të zonës së Drenicës dhe mosjapjen e armatimit në
2 Shqipëri. Jo për këtë çështje. Disa herë janë ndalu pjesëtarë
3 të Zonës Operative të Drenicës pse nuk kanë pas një letër me
4 vete ose një lejkalim ose një, edhe nuk janë furnizu në
5 Shqipëri pa intervenu dhe pa u konsultu.

6 PY. Do t'ju tregoj tani një dokument.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Që për procesverbal është DHT04399
8 deri në DHT04400 në anglisht, ndërkohë që versionin në shqip ka
9 numrin e identifikimit SITF00263239 deri në 00263325, në faqen
10 SITF00263291.

11 PY. Nga përgjigja që na dhatë tani në fund, e kuptoj që
12 problemi ishte, kishte të bënte me armët dhe që ata
13 akuzoheshin se po blloktonin furnizimin me armë të zonës së
14 Drenicës. A ju kuptova saktë, është e saktë kjo, Dëshmitar?

15 PË. Të gjitha konsultimet kanë qenë në formën që na të
16 organizohemi edhe të mos pengohemi. Ka pas shumë pjesëtarë që
17 kanë shku edhe janë furnizu, mirëpo disa pjesëtarë, ose prej
18 zonës operative të Drenicës, iu ka kërku një lejkalimi ose
19 një leje për, edhe pse kanë pas prej meje ose prej dikujt, nuk
20 iu kanë jep armë, dhe kjo ka qenë një mosqarim mes neve të
21 treve bashkë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Mbase kam dhënë numrin e gabuar të
23 faqes për referencë. Atëherë në versionin në shqip është 3291.
24 Dokumenti ishte i sakti, por faqja ishte e gabuar.

25 PY. Ky është një fragment i librit të një libri, pra është

1 një faqe e librit të Gani Gecit. Në qoftë se do të lexoni këtë
2 paragrafin që fillon "të njëjtën ditë ..." që është paragrafi
3 i pestë, duke numëruar nga fillimi, në versionin në shqip. Në
4 këtë libër ai shkruan:

5 "Të njëjtën ditë kam parë Mehdiun me dy persona. Asnjë
6 njeri tjetër nuk i afrohej. E pashë ndryshimin, ata e kishin
7 përgatitur terrenin e izolimit. Pastaj shkuan punët ashtu siç
8 shkuan. Dhe mbroheshim gjithmonë në Llaushë. Armatim kishim
9 pak, na u kishte ndalur ashtu si në Prekaz. Sami Lushtaku
10 kërkonte armatim, ata nuk i jepnin.

11 "Sami Lushtaku, Sylejman Selimi, Avni Hoxha dhe një grup
12 tjetër që bënë pjesë në shtabin e Jetullah Gecit, e kanë
13 nënshkruar fletë-arrestin për Hashim Thaçi dhe Rexhep
14 Selimin."

15 Dhe këtu citoj:

16 "Në qoftë se kapen në zonën e Drenicës, të sillen në
17 shtabin e Likovcit për shkak të ndarjes së armatimit, për
18 shkak të malvlerësimit që janë bërë lidhur me armatim!

19 "Armatimi po mbahej në rrafshin e Dukagjinit. Të gjithë
20 luftëtarët e Drenicës që shkonin për të tërhequr armatim, nga
21 tri pushkë automatike që u takonin vinin vetëm me nga një
22 pushkë dhe me dy karikatorë. Të tjerat ndaleshin atje."

23 A lidhet kjo me arsyet e arrestimit të Hashim Thaçit,
24 Rexhep Selimit dhe Kadri Veselit?

25 PËRKTHYESJA: Edhe një herë, domethënë, se avokati e tha

1 gabim. Domethënë, a janë këto arsytet të cilat kanë të bëjnë me
2 arrestimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, dhe Selimit, Rexhep
3 Selimit?

4 DËSHMITARI: Kjo që ka përshkru këtu është gabim. Është
5 përshkrimi i tijna. Dhe unë ta shpjegova, se ky ka qenë, kjo
6 ka qenë biseda e përbashkët me komandantët e pikave ose të
7 brigadave në këtë kohë, dhe ne, ne kemi taku të nesërmen ose
8 në mbrëmje menjëherë, se aty ka qenë prezent edhe vëllau i
9 Hashimit, Ganija, dhe ne jemi njoftu që është në Drenicë dhe
10 ne jemi taku bashkërisht më duket edhe me Saminë edhe me të
11 tjerët, dhe e kemi sqaru këtë problem.

12 PY. Po përpiqem që të sqaroj atë çfarë ka thënë Gani Geci.
13 Dhe ju shpjeguat në qoftë se kjo është e vërtetë apo jo.
14 Atëherë, dua t'ju lexoj një tjetër pjesë që ka thënë Gani Geci
15 në deklaratën e tij. Do t'jua lexoj këtë pjesë, Dëshmitar. Ai
16 thotë:

17 "Kur Sami Lushtaku erdhi nga Gjermania, u bë publik një
18 fletë-arrest për Hashim Thaçin dhe Rexhep Selimin. Arsyeja për
19 këtë ishte që nuk i kishin dërguar armë dhe municione Adem
20 Jasharit dhe Drenicës. Unë këtë e kam shkruar në librin tim,
21 por nuk e di ekzaktësisht se ku është kjo. Është hartuar një
22 fletë-arresti dhe ky fletë-arresti ndaj këtyre personave është
23 nënshkruar nga Sylejman Selimi, Sami Lushtaku dhe Bashkim
24 Jashari. Mendoj që ishte dhe një person tjetër, Abedin Rexha,
25 i cili e nënshkroi fillimisht, por pastaj u tërhoq. Avni Hoxha

1 dhe Sylejman Selimi më treguan këtë gjë, që edhe Avni Hoxha e
2 kishte nënshkruar këtë fletë-arresti dhe pastaj u tërhoq.”

3 Pyetja që i bëhet më pas është:

4 “A e kuptoj saktë që ju e kuptuat që situata ose reagimi
5 kishte ardhur si rezultat i faktit që Hashim Thaçi dhe Rexhep
6 Selimi nuk po i jepnin armë Adem Jasharit, por po u jepnin
7 armë të tjerëve?”

8 Dhe ai thotë:

9 “Po, kjo ka qenë arsyeja. Në rregull? Kjo është arsyeja
10 se pse u lëshua urdhër-arresti pas vrasjes së komandant Adem
11 Jasharit, por më vonë fletët e arrestit u tërhoqën dhe u
12 tërhoqën nga personat që i kishin hartuar ato.”

13 Tani do t’ju jap mundësinë që të komentoni lidhur me këtë
14 çfarë është thënë prej Gani Gecit.

15 PË. E gjitha kjo është gabim, nuk është e vërtetë, dhe unë ta
16 tregova të vërtetën.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares të
18 paraqesë në ekran një dokument me numër identifikimi DHT01458
19 deri në DHT01458.

20 PY. Këtë dokument jua kanë treguar dhe gjatë seancës
21 përgatitore nga Prokuroria. Bëhet fjalë për një dokument që
22 është në përputhje me dëshminë tuaj që ka pasur një diskutim
23 lidhur me arrestimin e këtyre tre personave. A është e saktë
24 kjo?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë. Keqinterpretton

1 faktet.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
3 kundërshtimi.

4 Mund të vazhdoni, Dëshmitar.

5 DËSHMITARI: Kjo është një urdhër që nuk është lëshu as
6 nuk është i nënshkruar, as nuk është i, kushdo ka mujt me e
7 shkru. Por unë thashë edhe ma herët, është diskutu të gjitha
8 këto probleme. Dhe shumë jemi taku shumë shpejt bashkërisht
9 dhe e kemi sqaru këtë problem.

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. Sikurse e thashë dhe më herët dhe sikurse e theksoi dhe
12 Prokurori, ju keni thënë që ka pasur raste kur urdhrat janë
13 lëshuar prej një personi tjetër, por në emrin tuaj. Kjo është
14 e saktë, apo jo, Dëshmitar?

15 PË. Është e saktë.

16 PY. Ju jo domosdoshmërisht e dini plotësisht, për shembull,
17 se çfarë mund të ketë hartuar Sami Lushtaku?

18 PË. Jo. Nuk e di domosdoshmërisht, por e di që na jemi taku
19 shumë shpejt.

20 PY. Po. A ju kujtohet që unë sot më herët ju tregova një
21 pjesë të shënimeve të mbledhjeve të 6 shkurtit dhe 13 shkurtit
22 1999 ku Sami Lushtaku s'e kishte problem që të ishte kritik,
23 që të shprehte kritikën ndaj këtyre personave, si në praninë
24 tuaj ashtu dhe në praninë e Rexhep Selimit. Kështu që
25 sugjerimi im për ju është që, për shembull, Sami Lushtaku nuk

1 është se kishte ndonjë pengesë që të shprehte ndjesitë e veta
2 karshi këtyre tre personave, pavarësisht faktit që ju kishit
3 lidhje gjaku me Rexhep Selimin. Kjo është e saktë, besoj,
4 Dëshmitar, apo jo?

5 PË. Po, është e saktë. Është, Gjithashtu as unë s'e kam pas
6 problem në qoftë se kritikoje direkt dhe dikënd tjetër ose --
7 është e saktë.

8 PY. Është e saktë, apo jo, që ky rast tregon që komandanti i
9 zonës së Drenicës mendonte që kishte autoritetin ose
10 kompetencën e këtyre tre personave, në qoftë se do të
11 vlerësonin që këto tre persona duhet që të arrestoheshin? A
12 është e saktë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Jo ndaj këtyre tre personave, ose ndaj -- por komandanti
14 i zonës operative ka pas përgjegjësinë e plotë me veprimet e
15 tij në zonë. Dhe unë si komandant i përgjithshëm i zonës e
16 marr përgjegjësinë dhe e kam mbajtur përgjegjësinë si komandant
17 i zonës, edhe me komandantët e brigadave në këtë kohë.

18 Por që a ka mujt komandanti i zonës operative të ndikohet
19 ose diçka tjetër, është disi [E pakuptueshme], megjithatë
20 kompetencat dhe përgjegjësitë në zonë i ka pas komandanti i
21 zonës, në këtë rast për zonën operative të Drenicës.

22 PY. Pra, komandanti i zonës, i zonës së Drenicës, kishte
23 kompetencë ose autorizim që të arrestonte këta tre anëtarë të
24 Shtabit të Përgjithshëm, të paktën ky dokument këtë thotë, apo
25 jo, Dëshmitar?

1 PË. Ky thotë, ky dokument thotë, por nuk është as i nënshkrum
2 e as i dalun, nuk e di që është zbatu për arsye se kam taku
3 edhe z. Thaçi edhe z. Selimi, të nesërmen më duket, ose atë
4 ditë, nuk e di. Dhe jemi taku dhe e kemi sqaru këtë problem.

5 PY. Po e shpreh ndryshe pyetjen time. Rasti në vetvete,
6 pavarësisht nga fakti që ju e pranoni apo jo këtë dokument --

7 PË. E kam të kjartë. E kam të kjartë.

8 PY. -- por fakti që ka pas një bisedë, ka pas një diskutim,
9 sugjeron se ju besonit që komandanti i zonës së Drenicës
10 kishte kompetencën ose autoritetin që të arrestonte këta tre
11 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm, kjo është e saktë, apo jo,
12 Dëshmitar?

13 PË. Unë e kam kompetencën edhe për zonën operative të
14 Drenicës.

15 PY. Faleminderit.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Gjykatës, kërkoj që ky dokument
17 të pranohet në provë gjyqësore.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
19 kundërshtim?

20 Z. HALLING: [Përkthim] Po, kundërshtojmë. Nuk ka asnjë
21 informacion në këtë dokument që vërteton autenticitetin *prima*
22 *facie* të këtij dokumenti. Dëshmitari ka thënë disa herë që
23 është një dokument i cili nuk është i nënshkruar. Nuk dihet se
24 nga ka ardhur ky dokument, edhe dëshmitari vetëm thjesht është
25 në gjendje që të kujtojë një histori që është goxha e ndryshme

1 nga ngjarja që deklarohehet në këtë dokument.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, së pari
3 kjo është çështje argumenti. Së dyti, dokumenti është në
4 pajtim me faktet që dëshmitari dëshmoi dhe biseda, diskutime
5 që kanë ndodhur për arrestimin e këtyre tre individëve. Dhe jo
6 vetëm, por në pamje të parë, ky dokument i asaj kohe mbështet
7 diskutimet dhe bisedat të cilat janë bërë lidhur me këta tre
8 individë në atë periudhë kohe.

9 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nga e ka
11 origjinën ky dokument, nga është marrë?

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Këtë dokument ne e kemi marrë nga
13 dikush brenda UÇK-së, në një hetim, duhet të shikoj tamam
14 titullin, por është marrë nga një hetim.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do i caktojme
16 një numër provizor prove, MFI.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
18 të marrë numër 1D247.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni të shtoj gjithashtu si
20 argument që ky është një dokument i gjetur jo ndryshe nga
21 dokumentet e tjera të cilat janë marrë nga shtëpitë e
22 personave të tjerë dhe njësoj janë pranuar nga ky Trupi
23 Gjykses.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe sa i takon këtij komentit, të
25 nderuar Gjykatës, do ju kërkonim që të krahasonit ata me

1 dokumentet të cilat janë pranuar nga zona.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
3 vazhdoni më tej. Kemi caktuar një numër provizor prove për
4 momentin.

5 Z. MISETIC: [Përkthim]

6 PY. Dëshmitar, është e saktë, apo jo, që diskutimi lidhur me
7 lëshimin e këtij urdhër-arresti nuk u materializua asnjëherë
8 ose nuk hyri në fuqi, sepse ekzistonte frika që lëshimi i
9 këtij urdhri-arresti mund të çonte në derdhje gjaku?

10 PË. Jo, s'është e vërtetë.

11 PY. Atëherë pse nuk u lëshua ky urdhër?

12 PË. Për arsye se u takum ne shumë shpejt dhe e kemi sqaru
13 këtë çështje. Edhe sa e di unë, në takim nuk është marrë, nuk
14 është bisedu për arrestimin e tyre, por për ndalimi e tyre për
15 me u sqaru, në qoftë se roja ose në qoftë se -- edhe atëherë,
16 kanë pas edhe pseudonime të cilat ende nuk i kemi pas të
17 kjarta, se me pseudonime është kërku si z. Thaçi, si z.
18 Selimi, edhe si z. Veseli. Edhe sa di unë atëherë ka qenë në
19 pyetje vetëm për, për me u sqaru me z. Thaçi edhe me Selimi.
20 Për z. Veseli asnjëherë as nuk e di as që u diskutu në takim.

21 Por megjithatë, unë i pashë tre emra aty që të cilët m'u kanë
22 paraqit edhe para Prokurorisë, por edhe para juve. Dhe ky
23 dokument nuk besoj që ka dalë nga zona operative e Drenicës.

24 PY. Dëshmitar, do kalojmë tek një tjetër temë përpara se të
25 bëjmë pushimin e radhës. Sa i takon komunikatave, ju në provën

1 P2027, keni thënë, më konkretisht në faqen 2058, që nuk jeni
2 të informuar ose nuk keni dijeni lidhur me qëllimin e
3 nxjerrjes së komunikatave nga UÇK-ja. A është e saktë kjo,
4 Dëshmitar?

5 PË. Po, e saktë.

6 PY. Kjo do të thotë që ju nuk keni qenë asnjëherë i përfshirë
7 në hartimin apo në publikimin e komunikatave të UÇK-së?

8 PË. Të Shtabit të Përgjithshëm, asnjëherë.

9 PY. Kur thoni "të Shtabit të Përgjithshëm, asnjëherë", çfarë
10 do me thënë?

11 PË. Në komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm, që ka lëshu në
12 emër të Shtabit të Përgjithshëm, nuk kam qenë i përfshirë dhe
13 nuk kam qenë në dijeni.

14 PY. Në rregull.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do ju tregoj një dokument që
16 ka numrin 078552-01-TR, i Rishikuar, -ET, faqja 1. Numri për
17 versionin në shqip është po ashtu i njëjti.

18 PY. Është një transkript i një bisede që ju keni pasur në një
19 program televiziv në Kosovë.

20 Në qoftë se do të lexojmë atë çfarë është thënë në
21 sekondën 0:00:27, ju thoni si më poshtë:

22 "Komunikatat asnjëherë s'i kam dit kush i ka shkru kurrë,
23 edhe sot nuk e di kush i ka shkru."

24 A është e saktë edhe kjo sot, Dëshmitar?

25 PË. E saktë.

1 PY. Pastaj pyetja është:

2 "Gjatë luftës?

3 Ju thoni:

4 "Po, gjatë luftës. Edhe përpara ka pasur komunikata edhe
5 përpara se të fillonte lufta."

6 Pra, me sa e kuptoj unë, ajo çfarë keni thënë ju në këtë
7 program televiziv, është që ju nuk dini asgjë lidhur me
8 personat që kanë shkruajtur komunikatat, qofshin këto
9 komunikata të shkruara para luftës, apo gjatë luftës. A është
10 kështu, Dëshmitar?

11 PË. Po, është e saktë.

12 PY. Për pasojë, ju nuk e dini, i takon që ju nuk e dini se
13 kush e ka shkruar komunikatën 59 që ka të bëjë me -- Abedin
14 Rexhën, dhe Gani Gecin. Nuk e dini kush e ka shkruar këtë
15 komunikatë, kështu?

16 PË. Jo, nuk e di.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Gjykatës,
18 ju kërkoj që të pranohet në provë gjyqësore vetëm kjo faqe.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
20 kundërshtim?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim. Besojmë që
22 dokumenti është vetëm dy faqe, kështu që nuk e di, nuk ka
23 arsye që të mos kërkohet të pranohen të dyja faqet.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Po kërkoja që të pranohet vetëm
25 një faqe, por nuk e kisha parasysh që dokumenti ka dy faqe,

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic

Faqe 112

1 kështu që le të pranohen të dyja faqet.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
3 78552-01-TR, i rishikuar -ET, faqja 1 dhe 2 pranohet në prova
4 gjyqësore.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
6 i caktohet numri i provës 1D248. Ju lutem, më thoni se çfarë
7 klasifikimi duhet të bëj për këtë dokument.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të klasifikohet si publik
9 sepse është informacion i marrë nga një intervistë publike.
10 Dhe sa i takon dokumentit tjetër edhe dokumenti tjetër mund të
11 jetë publik.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
13 riklasifikojeni si dokument publik.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Ju lutem, paraqisni
15 provën P1745. [Mikrofoni çaktivizuar].

16 Dokumenti në shqip ka numrin SPOE00360459 deri në
17 00360498 në faqen SPOE00360474.

18 PY. Dëshmitar --

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Përpara se t'ju kërkoj që të
20 përqendrohej në faqe, do i kërkoja Sekretares të kalojmë më
21 poshtë.

22 PY. Ju lutem, hidhini një sy shpejt e shpejt, lexojeni me
23 mendje informacionin në këtë faqe, pastaj do kalojmë tek faqja
24 tjetër. Lexojeni dhe shihni në qoftë se ka ndonjë informacion
25 që ka të bëjë me komunikatat.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndërkohë që në anglisht faqja që
2 duhet të paraqitur është 6D00-0771. Një faqe më tej. Të
3 kalojmë në faqen tjetër. Deri te fundi i paragrafit të parë,
4 përpara se sa të jetë kjo pika e zezë. Jo, ju kërkoj ndjesë,
5 në fakt vazhdon edhe më poshtë ...

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ndoshta mund
7 të na ndihmojë avokati që ta lexojë në anglisht pjesën për të
8 cilën do të bëj pyetje.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt nuk ka asgjë për të
11 lexuar. Thjesht doja që të diskutoja që nuk bëhet fjalë fare,
12 nuk ka asnjë lloj diskutimi për komunikatat.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të na
14 tregoni, ju lutem, se çfarë pjese në dokumentin në anglisht po
15 lexoni?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] E gjithë faqja. Dhe dua që të them
17 që paragrafi 20 i dosjes paragjyqësore të ZPS-së në
18 poshtëshënimin 87 referon këto dy faqe. Dhe gjithashtu,
19 domethënë, bëhet fjalë për komunikatat. Thjesht doja të
20 parashtroja që në këtë pjesë të tekstit nuk flitet fare për
21 komunikatat.

22 PY. A kam të drejtë që nuk diskutohet fare, nuk flitet fare
23 për komunikatë në këto dy faqet që sapo lexuam, Dëshmitar?

24 PË. Po, është e saktë, se këto dy faqe nuk përmend [E
25 padëgjueshme].

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 114

1 PY. Faleminderit.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Kryegjykatës, vërej kohën, mendoj
3 që më duhen rreth 15 minuta të tjera.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
5 dhjetë minuta pushim, Dëshmitar, sikurse bëmë dhe dje. Mund të
6 largoheni nga salla. Bëni pushim prej dhjetë minutash, mos
7 flisni me askënd për dëshminë.

8 [Dëshmitar përfundon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
10 pushim për dhjetë minuta.

11 --- Pauza fillon në orën 15.32

12 --- Seanca rifillon në orën 15.43

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
14 uleni. Mund të sillni dëshmitarin në sallë.

15 Do të pranohet prova që kishte marrë numër provizor
16 1D247. Mund të hiqet numri provizor.

17 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Në rregull, do ta heqim
18 numrin provizor atëherë.

19 [Dëshmitari vijon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
21 z. Misetiç, fjala është për ju,

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

23 PY. Z. Selimi, kam edhe një grup të fundit me pyetjet që
24 lidhen me pyetjet që ju ka bërë Prokurori në fund të pyetjeve
25 të tij për procesin penal që është zhvilluar kundër jush në

1 Kosovë.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të doja që të shihnim
3 dokumentin 056965, ju lutem. Ndërsa shqipja është me numër
4 057003 -- jo, edhe një herë po ua jap numrin. Është 056953
5 deri në 057028. Faqja në anglisht është me numër 056965. Edhe
6 shqipja është në të njëjtin dokument. Është në PDF. Pra është
7 në faqen 057003.

8 PY. Z. Selimi, kjo është aktakuza e ngritur kundër jush.
9 Shohim te pika 1. Akuzat e Prokurorisë këtu ndër të tjera kanë
10 qenë edhe në cilësinë tuaj si pjesëtar i UÇK-së. Keni qenë një
11 person që ushtronte kontroll në qendrën e ndalimit të
12 Likovcit. A ju kujtohet që të ketë qenë kjo një nga akuzat
13 kundër jush?

14 PË. Ky ka pra, ka qenë një proces gjyqësor edhe dihet
15 përfundimi i këtij -- i këtij. Ka qenë po -- këto akuzat të
16 cilat janë bërë para --

17 PY. A është e vërtetë që qendra e ndalimit të Likovcit ruhej
18 nga policia ushtarake? Ose drejtohej nga policia ushtarake?
19 Operohej nga policia ushtarake?

20 PË. Në -- është, ka -- ka qenë edhe policia ushtarake në
21 Likovc dhe është ruajtur nga policia ushtarake objekti i zonës
22 operative të Drenicës.

23 PY. Po, por policia ushtarake ruante edhe qendrën e ndalimit,
24 apo jo? Kështu e keni kuptuar ju?

25 PË. Unë edhe atëherë e kam thanë, dhe tash po e them që s'ka

1 pas qendër ndalimi, por unë jam gjet fajtor për këtë çështje
2 dhe jam dënu për këtë çështje.

3 PY. A është e vërtetë që qëndrimi juaj është që ju nuk
4 drejtonit policinë ushtarake. Nuk ishit ju komandant i
5 policisë ushtarake. Saktë?

6 PË. Po, komandanti i policisë ushtarake ka qenë Sahit
7 Jashari.

8 PY. Po, dhe qëndrimi juaj lidhur me këto akuza është i tillë,
9 që z. Jashari i raportonte administratës së policisë ushtarake
10 pranë Shtabit të Përgjithshëm, apo jo? Kështu?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem sqaroni për cilën
12 periudhë kohore bëhet fjalë, kur ka ndodhur kjo?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë po e pyes thjesht për
14 qëndrimin e tij

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 Mirë, pasi të merrni përgjigje, pyetni -- pyeteni edhe
17 për periudhën kohore.

18 Z. MISETIC: [Përkthim]

19 PY. Pra, Dëshmitar, sipas jush, komanda e policisë ushtarake
20 ishte në administratën e policisë ushtarake dhe nuk ishit ju,
21 saktë? Si komandant zone?

22 PË. Isha komandant zone, dhe komandanti i policisë ushtarake
23 ka qenë Sahit Jashari.

24 PY. Sa kohë ka qenë Sahit Jashari komandant i policisë
25 ushtarake? Nga cila periudhë deri në cilën periudhë?

1 PË. Me formimin e brigadave, njëkohësisht kanë fillu edhe --
2 edhe formimi edhe i policisë ushtarake dhe rendin në zonën
3 operative të Drenicës, edhe Sahit Jashari ka qenë deri në --
4 deri sa kam qenë komandanti i zonës operative të Drenicës,
5 komandant i policisë ka qenë Sahit Jashari.

6 PY. Pra, më së paku nga mesi i shkurtit të vitit 1999,
7 kështu?

8 PË. Ëh, besoj që po, ose edhe më herët.

9 PY. Si e kuptoj unë atë që i keni thënë ju Prokurorisë në
10 paragrafin 17 të shënimit përgatitor nr. 1 është kështu,
11 fillimisht do t'ua lexoj:

12 "Shtabi i Përgjithshëm emëroi drejtorin e policisë
13 ushtarake dhe ideja ishte që policia ushtarake në secilën zonë
14 operative t'i raportonte këtij personi të vetëm dhe të mos i
15 raportonte komandantit të zonës."

16 A është kjo dëshmia juaj?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem të lexohet edhe pjesa e
18 dytë e këtij paragrafi, për të dhënë kontekstin e plotë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta bëni
20 ju, Prokuror, kur të keni pyetjet plotësuese, në qoftë se
21 është e nevojshme.

22 DËSHMITARI: Po, është komandanti i policisë ushtarake --
23 i ka jap llogari komandantit të zonës. Mirëpo është lëshu një
24 urdhnesë nga Shtabi i Përgjithshëm që të ridizajnohet dhe që
25 policia ushtarake do të jetë nën -- është një urdhnesë, është

1 lëshu në emër të Fatmir Limajt.

2 Z. MISETIC: [Përkthim]

3 PY. Po. Pra, unë po ju sugjeroj që pozicioni që keni ju
4 shpjegon në fakt, ju -- është në mbrojtjen tuaj. Pra ju po
5 thoni që ju nuk keni ushtruar kontroll ndaj asnjë ambienti
6 ndalimi, nëse ka ekzistuar ndonjë ambient i tillë. A është e
7 saktë?

8 PË. Mundesh me e përsërit edhe një herë. S'e kuptova qartë,
9 të lutem.

10 PY. Po. Në fakt do ta bëj më të thjeshtë pyetjen. Ju jeni
11 akuzuar për ushtrimin e kontrollit ndaj një qendre ndalimi që
12 pretendohet se ka ekzistuar në Likovc. Dhe unë po ju them që
13 qëndrimi juaj është ky që ju s'keni se si ta keni ushtruar
14 kontroll të tillë sepse policia ushtarake, sipas dëshmisë
15 suaj, ka qenë nën komandën e Fatmir Limajt, dhe nuk ka qenë
16 nën drejtimin tuaj. Saktë?

17 PË. Jo. Unë edhe në seancën gjyqësorë, nuk e kam pranuar edhe
18 asnjëherë nuk e kam -- mirëpo jam gjet fajtor. Sa i përket
19 policisë ushtarake, ka qenë nën kontrollin tim, nën komandën e
20 zonës operative të Drenicës. A kanë -- ma vonë më ka ardhur
21 një urdhër të organizimit të trajnimeve të pjesëtarëve të --
22 dhe në këtë urdhër më ka ardhur edhe për policinë ushtarake,
23 qëtë, në këtë të raportohet direkt në drejtorinë në policinë
24 ushtarake në Shtab, me emër të Fatmir Limajt. Ka ekzistuar një
25 urdhër.

1 PY. Shikoni aktakuzën në ekran, te fjalia poshtë pikës 1.

2 Thuhet që akuzat kundër jush lidhen me periudhën kohore

3 pranverë e vitit 1998 deri në muajt e parë të vitit 1999.

4 Fjalia e fundit. Pas riorganizimit që besoj se është kryer në

5 nëntor të vitit 1998, sipas jush, kush e drejtonte policinë

6 ushtarake, pra kush e drejtonte policinë ushtarake nga vitit

7 1998 deri në muajt e parë të vitit 1999, në Likovc?

8 PË. Në -- thash, komandant ka qenë Sahit Jashari dhe më ka

9 raportu mua si komandant zone. Dhe ka qenë nën urdhrat e mi.

10 PY. Atëherë unë s'po e kuptoj dëshminë tuaj në paragrafin 17

11 të shënimit përgatitor nr. 1. Nëse z. Jashari edhe në muajt e

12 parë të vitit 1999 ju raportonte ju personalisht, atëherë na e

13 shpjegoni --

14 PË. Jo në vitin 1999

15 PY. -- jo më lini ta -- ju lutem, ta përfundoj. Na e

16 shpjegoni këtë fjalinë që thuhet këtu. Ideja ishte që policia

17 ushtarake në secilën prej zonave operative t'i raportonte

18 këtij personi, dhe jo komandantit të zonës. Ky person ishte

19 Fatmir Limaj. Na e shpjegoni këtë mospërputhje.

20 PË. Po. Është -- tash nuk e di në cilin muaj ka ardhur një

21 urdhnesë e tillë, dhe kjo urdhnesë ka ardhur në emër të z.

22 Limaj, që të gjithë policia ushtarake e të gjitha zonave të

23 jetë nën kontrollin ose nën komandën e tij dhe t'i raportojnë

24 atij.

25 PY. Kërkoj ndjesë, s'po e kuptoj tani qëndrimin tuaj.

1 Nëse drejtoria e policisë ushtarake, le të themi është
2 krijuar rreth nëntorit të vitit 1998, dhe ne tani po flasim
3 për periudhën nga nëntori i vitit 1998 dhe muajt e parë të
4 vitit 1999. Në këtë periudhë kohore, sipas -- siç e kuptova
5 unë, ju thatë që policia ushtarake dhe z. Jashari ishin nën
6 komandën tuaj.

7 Edhe një herë tani: A kanë qenë nën komandën tuaj apo
8 kanë qenë nën komandën e Fatmir Limajt, në këtë periudhë
9 kohore?

10 PË. Edhe një herë po ta sqaroj edhe po them, në këtë periudhë
11 nuk e di muajin e saktë, ka qenë nën komandën time Zona
12 Operative e Drenicës dhe me komandant të policisë ushtarake,
13 Sahit Jasharin dhe kanë qenë nën komandën time. A nuk e di
14 kohën saktë, urdhnesën nuk e kam përpara, urdhnesën të cilën u
15 lëshu nga Limaj dhe është thënë decidivisht që të -- duhet të
16 raportohen vijës hierarkike të gjitha policitë e zonave, në
17 nivel të gjitha zonave, duhet t'i raportojnë në -- z. Limaj.
18 Nuk e di kohën kur, deri sa është lëshu ky urdhnesë, edhe sa
19 ka mujt me u zbatu, për arsye të kohës dhe e luftimeve. Por ka
20 ekzistuar një gjë e tillë.

21 PY. A ndodhi në ndonjë moment që policia ushtarake e zonës
22 suaj nuk ju raportonte më ju personalisht?

23 PË. Unë jo, por besoj që i ka raportuar edhe direkt edhe z.
24 Limaj, por nuk kam ndonjë rast që -- me i cek.

25 PY. Pra ju keni qenë komandanti i zonës operative deri në

1 mesin e shkurtit të vitit 1999. Pra, ju po thoni që urdhri i
2 z. Limaj është lëshuar përpara apo pasi u bëtë ju komandanti
3 PË. -- përpara

4 PY. -- i përgjithshëm i UÇK-së.

5 PË. Përpara, se kam qenë komandant zone.

6 PY. Ju besoni se e ka lesuar urdhrin po tani siç po e kuptoj
7 unë dëshminë tuaj, pavarësisht urdhrin të tij, z. Jashari
8 vijoji t'ju raportonte ju personalisht, deri sa u bëtë
9 komandanti i përgjithshëm i UÇK-së, saktë?

10 PË. Z. Jashari ka raportu, deri sa unë kam qenë komandant
11 zone, ka raportu edhe ka qenë nën komandën time.

12 PY. Faleminderit.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, kaq pyetje
14 kisha unë.

15 PY. Faleminderit, z. Selimi.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dixon,
17 fjala është për ju.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

19 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

20 Z. DIXON: [Përkthim]

21 PY. Mirëdita, z. Selimi, unë quhem Rodney Dixon. Do t'ju bëj
22 disa pyetje për pjesën e mbetur të ditës së sotme dhe nesër në
23 emër të klientit tim, z. Kadri Veseli.

24 Z. Selimi, dua të fillojmë me dëshminë që keni dhënë dje
25 lidhur me z. Rasim Kiqina. Ju bëri pyetje Prokuroria lidhur me

1 këtë person, dhe kjo është pasqyruar në faqen 77 të
2 transkriptimit provizor të ditës së djeshme. Ju thatë që:

3 "Ai ka qenë në sektorin e zbulim-kundërzbulimit dhe më
4 pas ka qenë anëtar i Brigadës 111."

5 Ju po ashtu thatë se ju keni qenë personi që emëruat në
6 këtë pozitë.

7 Më pas Prokuroria ju pyeti:

8 "A ka qenë oficer karriere?"

9 Dhe ju u përgjigjët dhe thatë:

10 "Ka qenë shoku im, dhe ai ishte oficer në zonë.

11 Ju kujtohet kjo pjesë e dëshmisë nga dita e djeshme?

12 PË. Po, e saktë.

13 PY. Më pas Prokurori ju pyeti a ka qenë ai pjesë ai e
14 njësitit të Sabit Gecit, që e keni diskutuar në deklaratën
15 tuaj. Ju u përgjigjët dhe thatë:

16 "Jo, Rasim Qikina [Sipas përkthimit] nuk ka qenë
17 asnjëherë anëtar. Ai dhe -- atë e emërova unë në një moment të
18 mëvonshëm në zonën operative të Drenicës."

19 Pra ju kujtohet që vijoji kështu dëshmia dje?

20 PË. Po.

21 PY. Që ta kemi të qartë dëshminë tuaj për këtë pikë, dhe më
22 pas do t'ju bëj edhe unë disa pyetje. Në shënimin përgatitor,
23 në faqen 13 për palët, nuk është në shqip kjo. Unë do ua lexoj
24 dhe më thoni nëse ju kujtohet edhe ju.

25 Ju keni thënë që ka qenë "një dëshmor që është vrarë pak

1 para luftës, pas pak -- pak para përfundimit të luftës. Ju e
2 emëruat atë në pozicionin. Kiqina nuk ka qenë pjesë e grupit
3 të Sabit Gecit, por ka qenë kryesisht në Brigadën 111 dhe ka
4 marrë pjesë në luftime. Ai ka qenë oficer karriere dhe pjesë e
5 një ekipi, bashkë me Xhemal Shaqirin, Shaban Dragaj dhe
6 Xhemajl Beqaj."

7 Kemajl, Kemajl Shaqiri. Kemajl Shaqiri. E shqiptova keq.

8 A ju kujtohet t'ia keni thënë këtë Prokurorisë dhe a
9 është e saktë kjo?

10 PË. Është e saktë përveç që kam thënë z. Kiqina jo oficer i
11 karrierës por ka -- ka punu me oficerët këta të tjerët e nuk e
12 di që ka qenë z. Kiqina oficer i karrierës, por që ka qenë një
13 nga oficerët më të suksesshëm. Ka qenë me -- me ofic -- i --
14 oficer, domethënë në zona për atje dhe Drenicës, në bazë të --
15 po jo oficer i karrierës. Oficer i karrierës ka qenë z.
16 Shaqiri, dhe të tej -- dhe të tjerë. Z. Draga dhe z. -- në
17 zonë - po ja harroj emrin. Tre oficerë karriere i kam pas në
18 zonë. Po është e saktë ajo që kam [E pakuptueshme]. Vetëm këtë
19 sqarim deshta.

20 PY. Po, faleminderit. Pra, z. Kiqina ka qenë në Kosovë gjatë
21 gjithë kohës, përpara se të fillonte lufta. Nuk ka qenë jashtë
22 Kosovës. Ai ka jetuar gjatë gjithë kohës atje, dhe është kyçur
23 në UÇK gjatë kohës që jetonte në Kosovë. Saktë?

24 PË. Po, e saktë.

25 PY. Sikurse thatë, ai vërtetë nuk ishte -- nuk ishte oficer

1 karriere, as nuk ishte i përgatitur, i formuar në zbulim e
2 kundërzbulim në kohën kur e emëruat ju, apo jo? S'kishte
3 ndonjë formim në këtë fushë, apo jo?

4 PË. Jo, në -- përveç këta tre oficerët që i kam pas karriere,
5 asnjë prej pjesëtarëve të tjerë nuk ka pas përgatitje
6 ushtarake ose oficerë të karrierës. Një ndër ta edhe z.
7 Kiqina.

8 PY. Po, nuk kishte ndonjë formim konkret ai në fushën e
9 zbulimit apo jo?

10 PË. Jo.

11 PY. Ju e emëruat z. Kiqina sepse siç thatë ju, ai ishte shoku
12 juaj. Ju e njihnit mirë dhe kishit besim te ai, apo jo.

13 PË. Po, saktë.

14 PY. Ky emërim nuk u bë prej ndonjë personi në Shtabin e
15 Përgjithshëm por ishte një emërim që e bëtë ju personalisht,
16 saktë?

17 PË. Po, saktë.

18 PY. Z. Kadri Veseli nuk ka qenë i përfshirë në emërimin e
19 Kiqina, apo jo?

20 PË. Jo, nuk ka qenë.

21 PY. Tani dua të sqarojmë së bashku, nëse ju kujtohet, e dimë
22 që ka kaluar shumë kohë, dhe do të duhet të kthesh kohën pas.

23 A ju kujtohet kur e keni emëruar në këtë pozitë? Në nivel
24 zone, domethënë?

25 PË. Nuk po më kujtohet, nuk e di.

1 PY. Mbase do të përpigem ta shohim nga pikëpamja kronologjike
2 bashkë. Sot ju bënë disa pyetje për ristrukturimin e UÇK-së në
3 nëntor të vitit 1998. Ju kujtohet që ju bënë për kështu?[të
4 periudhë kohore?

5 PË. Po.

6 PY. Kjo është periudha kur z. Bislam Zyrapit dhe të tjerë u
7 përfshinë në riorganizim të strukturave bazike që ekzistonin
8 në UÇK. A ju kujtohet kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Kjo ka ndodhur në nëntor të vitit 1998. A ju kujtohet që
11 ta keni emëruar në të njëjtën -- a ju kujtohet që në të
12 njëjtën periudhë keni filluar të emëroni edhe ju persona në
13 strukturën e zonës suaj, qoftë kjo në zbulim apo në pozita të
14 tjera brenda zonës suaj?

15 PË. Ka, ka mundësi që është e saktë, nuk -- e thashë nuk e di
16 saktësisht por besoj që është kjo periudhë.

17 PY. Përpara se ta merrte këtë pozitë z. Kiqina, që ja dhatë
18 ju, nuk ka pasur ndonjë strukturë zbulimi në zonën -- në zonën
19 tuaj që t'ju raportonte ju, saktë?

20 PË. Saktë.

21 PY. A është e vërtetë që pasi u emërua z. Kiqina, ai ju
22 raportonte ju si komandant zone?

23 PË. Po, saktë.

24 PY. A ka pasur ndonjë person që e ndihmonte z. Kiqinën apo
25 ishte i vetmi person që mbulonte fushën e zbulimit në zonën

1 tuaj?

2 PË. Përveç z. Kiqina nuk më kujtohet dikush tjetër.

3 PY. Po në brigadë, brigadat që po formoheshin në atë fazë, në
4 brigadat, për shembull Brigada 111 që e keni përmendur ju, ka
5 pasur ndonjë person që punonte me zbulimin?

6 PË. Jo, në këtë -- po nuk po më kujtohet që ka pasur. Në
7 nivel brigade nuk më kujtohet që ka pasur oficerë të zbulim
8 dhe kundërzbulimit.

9 PY. A është e vërtetë dhe ju keni thënë që z. Kiqina ka qenë
10 i përfshirë kryesisht në luftime. Bëhet fjalë për muajt maj,
11 qershor, korrik, gusht, shtator. A e është -- a po flasim për
12 këtë periudhë kohore me përafërsi?

13 PË. Po. Ai ka -- z. Kiqina ka qenë një luftëtar i
14 jashtëzakonshëm.

15 PY. Më përpara gjatë dëshmisë tuaj, ju keni thënë që ai është
16 përfshirë që prej fillimit në luftime. Këtu bëhet fjalë për
17 vitin 1998, apo jo? Këtë doja ta sqaroj edhe për procesverbal.
18 Dhe kjo ka ndodhur kryesisht në Brigadën 111, a është e saktë
19 kjo, Dëshmitar?

20 PË. Po, e saktë. E përveç Brigadës 111, ka marrë pjesë edhe
21 në luftime në mbështetje edhe në brigada të tjera.

22 PY. Në cilat brigada të tjera ka dhënë kontributin e tij ai?

23 PË. Kryesisht ku ka pas, kryesisht ku ka pas luftime, ka shku
24 vullnetar bashkë me pjesëtarë të tjerë për ndihmë, kryesisht
25 në Brigadën 113.

1 PY. Më vonë, besoj që kështu keni thënë që ju kujtohet, që ai
2 më pas pra, u emërua në postin e zbulim-kundërzbulimit,
3 domethënë diku rreth nëntorit. A vazhdoi ai që të funksiononte
4 në Brigadë dhe të luftonte, ndërkohë që ka qenë në postin e
5 zbulim-kundërzbulimit, pra kur merrej me zbulim-kundërzbulimin
6 në zonë, ndërkohë merrej edhe me luftime?

7 PË. Kur është kryesisht marrë me luftime dhe shumë pak me
8 rolin e tij.

9 PY. Kur thoni shumë pak në rolin e vet, e keni fjalën për
10 rolin që kishte në zbulim-kundërzbulim në nivel zone?

11 PË. Po, për arsye se kishte për detyrë sa më afër t'i afrohet
12 forcave armike dhe t'i zbulonte sa mjete kanë, sa teknologji,
13 sa armatim dhe sa janë afër pozicioneve tona, dhe lëvizjet në
14 përgjithësi. Por ai ishte shumë aktiv dhe shumë i -- merrte
15 pjesë direkt në [E pakuptueshme] e luftimeve.

16 PY. Roli i tij në zbulim-kundërzbulim edhe po të ketë qenë i
17 kufizuar, ka qenë për të mbledhur dëshmi ose informacion që
18 kishin të bënin -- që kishte të bënte me pozicionin e forcave
19 serbe dhe sa forca apo fuqi kishin forcat serbe, në kuptimin
20 që sa ushtarë kishin, sa armatime, e të tjerë. Këtë po thoni?
21 Kjo është dëshmia jua, Dëshmitar?

22 PË. Po, kjo është.

23 PY. Kur e merrte këtë informacion, ai këtë informacion ua
24 përcillte si komandant zone. A është e saktë kjo?

25 PË. Po, e saktë.

1 PY. Ai këtë informacion nuk ja kalonte ose nuk ja përcillte
2 askujt tjetër në Shtabin e Përgjithshëm?

3 PË. Jo, e ka kalu te shefi i Shtabit edhe shefi i operativës,
4 që me marrë masat ose me ditë proporcionet dhe mundësitë që do
5 t'i kena na kundër armikut. Por njëkohësisht edhe me mua e ka
6 diskut.

7 PY. Kur thoni shefi i Shtabit, e keni fjalën për shefin e
8 shtabit të zonës tuaj, zonë -- z. Shaqiri, apo jo?

9 PË. Po, e kam fjalën për shefin e shtabit të zonës, dhe
10 shefin e operativës.

11 PY. Po shefi i operativës në zonë kush ishte?

12 PË. Xhemajl Bejta, edhe ky oficer i karrierës.

13 PY. Personi i tretë që përmendët ishte Shaban Draga. Po
14 Shaban Draga çfarë pozicioni kishte në zonë?

15 PË. Edhe ky ka qenë me operativën dhe kryesisht ushtr --
16 merrej me trajnimin dhe për përgatitjen e oficerëve.

17 PY. Faleminderit. Z. Kiqina, me sa dini ju, këtë lloj
18 informacioni nuk është se e ka përcjellë ndonjëherë
19 drejtpërsëdrejti z. Kadri Veseli, me sa keni informacion ju? A
20 është e saktë kjo, Dëshmitar?

21 PË. Nuk kam informacion, nuk e -- nuk jemi -- nuk e di. Besoj
22 që --

23 PY. Jo, thjesht po ju pyes, me sa dini ju. Me aq sa dini ju,
24 ai i raportonte shtabit të -- shefit të shtabit dhe juve por
25 nuk i raportonte Kadri Veselit.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tha që nuk e
2 ka këtë informacion.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Po e pyes dëshmitarin se çfarë
5 informacioni kishte, e dinte apo s'e dinte.

6 PY. Unë po ju them këtë, që z. Kiqina nuk i ka raportuar
7 Kadri Veselit. Me sa ju kujtohet juve, a është e saktë kjo apo
8 jo, Dëshmitar?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Është koha ime unë kam udhëzime për
11 ta pyetur lidhur me këto pyetje nga klienti im.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet ta
13 pyesni një herë e të merrni përgjigjen e se e pyetët një herë
14 dhe e morët përgjigjen.

15 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë kam të
16 drejtën time për të paraqitur pozicionin tonë dëshmitarit.

17 PY. Do ta bëj ndryshe atëherë. Ju thatë që z. Kiqina i
18 raportonte shefit të Shtabit dhe juve. Po ai nuk i raportonte
19 askujt tjetër më lartë në hierarki, apo jo, Dëshmitar?

20 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtoj. U bë pyetja, e mori
21 përgjigjen.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigjuni
23 pyetjes, Dëshmitar. Ta kalojmë edhe këtë pyetje dhe të
24 vazhdojmë më tej.

25 DËSHMITARI: Z. Kiqina ka qenë në komandën time dhe më ka

1 raportu mu dhe zonës operative të Drenicës.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

3 PY. Z. Selimi, dua t'iu bëj disa pyetje që kanë të bëjnë me
4 atë çfarë ju kujtohet ju në periudhën në nëntor të vitit 1998
5 dhe procesin e ristrukturimit. A ju kujtohet ndonjë ndërveprim
6 gjatë asaj periudhe, si komandant zone, me z. Zyrapi për të
7 përditësuar ose për të përmirësuar strukturën e UÇK-së dhe për
8 ta bërë atë më të mirë, në mënyrë të tillë që UÇK-ja të
9 funksiononte në mënyrë më kohezive, në mënyrë më të mirë?

10 PË. Po, më kujtohet.

11 PY. A mund të na thoni në qoftë se ju kujtohet, se çfarë
12 natyre kanë pasur këto biseda, këto diskutime? Çfarë po
13 përpiqeshit ju të bënit gjatë kësaj kohe?

14 PË. Ka qenë kryesisht formimin e strukturave. Unë, ta zëmë,
15 për shembull, në brigadën në zonën time i kam pas dhe brigada,
16 po kam pas vetëm brigada pa batalione dhe pa kompani, e nivele
17 togu, dhe kjo ka qenë tuj u ba strukturimi ose riorganizimi i
18 strukturave në përgjegjësi në Zonën Operative të Drenicës. dhe
19 gjithashtu ka qenë në mbështetje të oficerëve në zonë.

20 PY. Kur thoni riorganizimi i zonës operative, për çfarë
21 ndryshimesh bëhet fjalë? Apo çfarë hapash të reja keni
22 prezantuar ju?

23 PË. Thashë për anës -- u mundova me ta shpjegu që të jetë sa
24 më e strukturime zona, për arsye se edhe të pajiset edhe me
25 informacione dhe me strukturë se si funksionon një brigadë apo

1 se si funksionon një batalion ose një kompani, dhe kështu. Dhe
2 trajnime të cilat që ne mund t'i -- të na lejojë koha ose të
3 kemi qasje që ne të jemi dhe t'i trajnojmë edhe oficerët në
4 këto nivele.

5 PY. A mund të na ndihmoni duke na thënë se deri në çfarë pike
6 mbërritët në këtë proces? E kuptoj që ky ishte synimi, por a
7 ka pasur pengesa të rënda, të vështira që i keni hasur për
8 arritjen e këtij objekti?

9 PË. Në zonën time çdo herë kam pas luftime, çdo herë kam pas
10 vështirësi të organizimit, çdo herë kam -- kam pas edhe humbje
11 të mëdha edhe në -- duke u nis nga komandantët e brigadave,
12 edhe asnjëherë nuk është mujt që t'i kam të tëra njësitë ose
13 t'i kam të [E pakuptueshme] strukturës që kam të përgatitur.

14 PY. Z. Selimi, a ju kujtohet që prej kësaj periudhe, e kemi
15 fjalën këtu më konkretisht nga nëntori i vitit 1998, që për
16 herë të parë në nivel të Shtabit të Përgjithshëm filluan që të
17 krijoheshin drejtoritë në zona të ndryshme, për fusha të
18 ndryshme, për shembull, drejtoria për informim, për zbulim-
19 kundërzbulim, dhe morën numra të ndryshëm, si për shembull,
20 G1, G2, G3. A ju kujtohet që kjo filloi që të ndodhte rreth
21 kësaj periudhe?

22 PË. Po, është e saktë. Po.

23 PY. A ju kujtohet që në këtë kohë, në këtë periudhë, sa i
24 takon zbulim-kundërzbulimit, z. Kadri Veseli u emërua në
25 drejtorinë e G2-shit, që të krijonte këtë drejtori për herë të

1 parë në nivel të Shtabit të Përgjithshëm?

2 PË. Po, më kujtohet.

3 PY. Deri në atë kohë ju nuk e dinit se çfarë pozicioni, çfarë
4 posti kishte z. Veseli, apo oj?

5 PË. Jo, nuk e kam ditë aq --

6 PY. Por më pas, drejt fundit të vitit 1998, kjo u bë më e
7 qartë me fillimin e themelimit të drejtorive. A është e saktë
8 kjo, Dëshmitar?

9 PË. Saktë, po.

10 PY. Është e drejtë, apo jo, që prej kësaj periudhe dhe në
11 vazhdim, domethënë në fund të vitit 1998, pas fillimit të
12 këtij ristrukturimi, ju nuk kishit marrëdhënie të
13 drejtpërdrejta me z. Veseli në rolin e vet si drejtues i G2-
14 shit?

15 PË. Jo, nuk kam pas kontakt, dhe me sa di unë, të paktën dhe
16 kështu një herë e kam taku ose dy herë -- e kam taku, gjatë
17 gjithë kësaj periudhe.

18 PY. Dhe në ato raste nuk është se keni pas ndonjë takim
19 formal, zyrtar me të, thjesht jeni shkëmbyer. Nuk është se
20 keni pas ndonjë takim real me të. Kështu?

21 PË. Jo, vetëm që e kam njoft dhe që e kam taku. Asnjëherë
22 s'kam pas bisedë rreth organizimit ose rreth -- metodat -- në
23 një rast e kam taku, kur në -- disa të plagosur dhe nuk më
24 kujto -- jo rreth bisedave ose nuk kam pas ndonjë bisedë të
25 tillë.

1 PY. Faleminderit. Do kalojmë në periudhën e vitit 1999 nesër,
2 por të përfundojmë me zhvillimet në vitin 1998 së pari.

3 Tani po flasim për nëntorin dhe dhjetorin e vitit 1998.
4 Në zonën tuaj, në këtë periudhë z. Kiqina po funksiononte si
5 nën luft -- ose jepte rolin e vet si sa i takon luftimeve në
6 nivel brigade edhe si person i zbulim-kundërzbulimit në zonën
7 tuaj?

8 PË. Po --

9 PY. Gjatë kësaj periudhe në zonë ju bënit takime të rregullta
10 apo ishin të vështira takimet e rregullta për shkak të
11 rrethanave në terren?

12 PË. Jo, takimet kanë qenë shumë të rralla dhe të vështira, në
13 nivel zone.

14 PY. Po. Si arrinit të komunikoni ju, apo komunikoni në
15 mënyrë sporadike dhe rastësore dhe të rrallë?

16 PË. E ke fjalën me z. Kiqina apo në përgjithësi me zonën?

17 PY. Në nivel të komandës së zonës, duke përfshirë edhe z.
18 Kiqina.

19 PË. E në zonë e kam pas vështirësi të ndryshme të komunikimit
20 për arsye të luftimeve të ndryshme, edhe komunikimin e kam
21 përdor me radiolidhje. Shpesh herë kanë -- nuk kanë
22 funksionuar dhe kjo ka qenë -- ose kontakte fizike.

23 PY. A keni marrë ndonjëherë raporte me shkrim nga z. Kiqina
24 në atë periudhë? Domethënë drejt fundit të vitit 1998?

25 PË. Me sa më kujtohet, me gojë kam marrë shumë, disa herë

1 forcat kur kanë lëviz. Por megjithatë, plan programi -- plan
2 operacional -- planin operacional është përgatitur nga
3 oficerët të cilët kanë qenë në zonë, por më kanë informu rreth
4 forcave policore ushtarake dhe lëvizjeve të trupave të kësaj
5 kohe.

6 PY. Ju na folët lidhur me oficerët e karrierës. A keni pasur
7 mundësi që të ofronit ndonjë trajnim, stërvitje, gjatë kësaj
8 periudhe, duke marrë parasysh vështirësitë me të cilat
9 haseshit?

10 PË. Ne një periudhë, kur kemi -- jemi mundu që t'i mbajmë
11 disa trajnime, nuk e di koha -- koha ka qenë pas ofensivës më
12 duket, shtatorit por -- ose dhe më vonë, por ne jemi mundu që
13 të mbajmë trajnime të niveleve të oficerëve. Disa kurse të
14 ndryshme.

15 PY. Kur thoni që "jemi mundu", a keni pasur mundësi që të
16 ofroni një kurs trajnimi, ndonjë stërvitje? E kam fjalën për
17 këta oficerët e karrierës. Deri në çfarë pike arritët?
18 Domethënë, thjesht keni -- keni pasur në plan apo keni
19 realizuar në terren ndonjë trajnim?

20 PË. Jo për oficerët e karrierës. Për oficerët e karrierës --
21 trajnim për pjesëtarët e tjerë. këta kanë qenë të trajnu dhe
22 të përgatitur.

23 PY. E kuptojmë. E kuptoj që ata ishin personat që e kanë
24 ofruar stërvitjen ose trajnimin, por sa realiste ishte ofrimi
25 i trajnimit në atë kohë? Domethënë, stërvitjet, kanë pasur

1 realisht mundësi realisht që t'i ofronin apo kanë qenë

2 thjeshtë plane?

3 PË. Kanë qenë plane. Ishte shumë e vështirë të realizohet për
4 arsye të luftimeve dhe të humbjeve të mëdha që të cilat i kemi
5 pas, si në zonën operative të Drenicës.

6 PY. Përmendët që z, Qikina [Sipas përkthimit] është vrarë pak
7 para përfundimit të luftës. Kur dhe ku është vrarë z. Qikina
8 [Sipas përkthimi], në qoftë se ju kujtohet?

9 PË. Është vrarë në -- duke kalu rrugën prej Drenicës në
10 Pashtrik dhe është vrarë në Arllat, thirret ai vend, afër
11 rrugës. Duke kalu rrugën u vra nga forcat bashkë me Ragip
12 Halilaj, nga forcat serbe.

13 PY. Kjo ka ndodhur në vitin 1999?

14 PË. Në vitin 1999, po.

15 PY. Ai vazhdoi që edhe të luftonte në brigadë dhe që të
16 kryente funksionet e oficerit të zbulim-kundërzbulimit deri në
17 momentin kur u vra. A është e saktë kjo?

18 PË. Besoj që është e saktë, po shumë pak e ka -- ka kryer
19 edhe këtë detyrë. Më shumë ka ndenjtur me ushtarë dhe ka marrë
20 pjesë në luftime në brigadën, kryesisht me Brigadën 111.

21 PY. Kur thua që "ai pak i ka kryer këto funksione", e keni
22 fjalën për funksionet e zbulim-kundërzbulimit apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Faleminderit.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, shikoj kohën.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Sylejman Selimi (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 136

1 Besoj që është momenti i përshtatshëm për të përfunduar këtu
2 për sot.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Përfunduar për sot, Dëshmitar. Do shihemi përsëri nesër
5 në orën 9.00. Do vazhdojmë më tej me pyetjet për ju nesër. Ju
6 lutem mos flisni me askënd për dëshminë përpara Trupit
7 Gjykues. Faleminderit që ishit me ne sot.

8 Z. Qerkini, faleminderit edhe juve.

9 DËSHMITARI: Faleminderit.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E mbylлим
12 deri nesër në orën 09.00.

13 --- Seanca mbyllet në orën 16.30

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25